RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR NË BASHKINË LIBOHOVË

Tiranë, më 2021

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 4

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 4

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 8

II. HYRJA 10

1. Objektivat e auditimit 10

2. Qëllimi i auditimit 10

3. Idetifikimi i çështjes 11

4. Përgjegjegjësitë e strukturave drejtuese 11

5. Përgjegjësitë e audituesve 11

6. Kriteret e vlerësimit 11

7. Standardet e auditimit 12

8. Metodologjia e auditimit 12

9. Dokumentimi i auditimit 14

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 14

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 14

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 16

A. Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor përkatës për periudhën 2019-2020 16

B. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të parashikuar opinion mbi pasqyrat financiare për vitet 2019-2020 40

C. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" për periudhën 2019-2020. .. 61

D. Të ndryshme të dala gjatë auditimit - Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. 96

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 103

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
DFB	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
DTTV	Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 871/1 Prot, datë 03.09.2021, ndryshuar me shkresën nr. 871/2, datë 27.09.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 07.09.2021 deri në datë 22.10.2021, në subjektin Bashkia Libohovë u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020.

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Libohovë si: planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, të ardhurat, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Libohovë 6 akt konstatime dhe 3 akt verifikime. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit nuk janë paraqitur observacione përkatëse nga Bashkia Libohovë, mungesa e të cilave ka lejuar grupin e auditimit vazhdimin e procedurës për hartimin e projekt raportit të auditimit. Mbi projekt raportin e auditimit, subjekti ka paraqitur kundërshtime dhe observacione, të cilat janë trajtuar në material nga grupi i auditimit me objektivitet dhe profesionalizim sipas çështjeve përkatëse.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese-2020", me fond limit 1,647,500 lekë pa Tvsh, me fitues BOE "T.-D & 6D P." Shpk me vlerë oferte 1,588,666 lekë,ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 1,588,666 lekë pa Tvsh.	E lartë	Bashkia Libohovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 1,588,666 lekë pa Tvsh.
2	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" u konstatua se dokumentacioni i analizes mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe procesverbali i mbajtur për këtë qëllim nuk janë në dosjen e NJP.	E lartë	Bashkia Libohovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos dokumentimin dhe mungesën e përllogaritjes së vlerës së kontratës, nga NJP bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet referuar fondit limit të Urdhërit të prokurimit prej 3,429,847.5 lekë.
3	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që është deklaruar në MFE për vitin 2019 dhe për vitin 2020 nuk përputhet me vlerën e detyrimeve referuar tabelave analitike që administron Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë.	E lartë	Kryetari i Bashkisë Libohovë të ngrejë një grup pune me qëllim analizimin, dhe regjistrimin e vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Libohovë, si dhe të hartojë dhe miratojë planin për likuidimin e tyre.
4	Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 8 subjekte të legalizuara me vlerë 269,996 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë.	E lartë	Sektori i Shërbimit Urban të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Inspektimit të Territorit mbi subjektet debitore për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në

			infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 8 subjekte të legalizuara me vlerë 269,996 lekë.
5	Detyrimi që subjektet fizik/juridik kanë ndaj Bashkisë Libohovë më 31.12.2020, është 6,138,150 lekë për 64 subjekte dhe 17, 065,243 lekë për 797 familje, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë në total 23,203,393 lekë.	E lartë	Sektori i Inspektimit të Territorit të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare apo vendosjen e barrës hipotekore për subjektet debitore, si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej 23,203,393 lekë nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.
6	Për llogaritë e AAJM, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, si: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia. Gjatë shqyrtimit të llogarisë analitike evidentohen mangësi në elementët e përmbajtjes së rregjistrave të aktiveve afatgjata jo materiale mbi përllogaritjen progresive të amortizimit individual për secilin aktiv të llogarisë 200 si llogaritë analitike 202, llog 212, llog 213, llog 214, llog 215 dhe llog 218".	E lartë	Titullari i Bashkisë Libohove dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa të menjëhershme: -Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. -Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 "Toka, troje terrene", 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", 212 "Ndërtime e konstruksione" 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe "215 "Mjete transporti", si dhe për ngritjen e komisioneve të posaçme për asgjësimin e aktiveve.
7	Gjatë kontrollit të përllogaritjes së amortizimit të akumuluar vjetor evidentohet së ky zë duhet ta ketë në vlerën 203,990 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivit paraqitet 216,350 lekë duke përdorur normë amortizimi 22% dhe jo 20%, pra janë ngarkuar padrejtësisht 12,360 lekë për vitin 2020 dhe për vitin 2019 janë ngarkuar padrejtësisht për shumën 8,045 lekë.	E lartë	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryej sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 218 Inventari ekonomik, respektivisht në vlerën 12,360 lekë për vitin 2020 dhe 8,045 lekë për vitin 2019.
8	Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Libohovë, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 11,116,761 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5 %, ose shumën 11,116,761 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Përfundimisht për vitin 2020 Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 6,629,601 lekë.	E lartë	Nga Bashkia Libohovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" për vlerën 6,629,601 lekë duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

9	Për llog 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqesore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 0 lekë. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Libohovë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2020, por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019 si dhe të likujduara në 2021 dhe me kompetencë të vitit 2020, e cila përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 4,161,050 lekë dhe detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 106,000 lekë.	E lartë	Titullari i Bashkisë Libohovë nëbashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruarnë llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" detyrimet për faturat e likujduara 4,161,050 lekë për vitin 2019 dhe 106,000 lekë për vitin 2020. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.
10	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019" dhe "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2020" rezulton se AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e OE që ka ftuar të marrin pjesë në këto procedura, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39, pika 4.	E lartë	Bashkia Libohovë të marrë masa që në rastin e zhvillimit të procedurave të llojit "Kërkesë për propozim" të argumentojë dhe dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.
11	Për procedurën e prokurimit publik me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" mbi administrimin e procesverbaleve të hartimit të DST me mungesën e prezencës së 2 anëtarëve të tjerë, është mbajtur AV nr.1 datë 07.10.2021. 1.Për fillimin e procedurave të prokurimit për objekt prokurimin "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë, titullari i autoritetit kontraktor znj Luiza Mandi ka miratuar Urdhërit nr.33, datë 26.02.2019 "Për krijimin e njësisë së prokurimit" dhe më pas ka miratuar Urdhër Prokurimit nr.40, datë 05.08.219 për kryerjen e procedurave të prokurimit në llojin e procedurës "E Hapur" me fond limit 30,916,666.7 lekë, financuar nga MBZHR dhe për vitin 2019 në vlerën 14,166,666.7 lekë. 2.Për të vazhduar procedurën e prokurimit publik sipas Ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të gjithë anëtarët e NJP nënshkruajnë Formularin e Deklarimit mbi kushtet e konfliktit të interesit dhe procedohet duke hartuar kriteret e kualifikimit shoqëruar me dokumentat standarde të tenderit në përputhje me nenin 57 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Mirëpo gjatë shqyrtimit nga grupi i auditimit të dosjes fizike të objektit të prokurimit të sipërcituar, u evidentuan mangësi të cilat konsistojnë në: - Mos vënien në dijeni, në ndonjë nga format e përcaktuara në Ligj nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, për caktimin si anëtarë të NJP të z.I. K. dhe z.K. K. për procedurën me objekt prokurimi "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulossi dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë; - Në kushtet e mësipërme të mos pasjes dijeni të dy anëtarët e NJP të sipërcituar nuk kanë nënshkruar Formularin e Deklarimit mbi kushtet e konfliktit të interesit dhe si e tillë në dosjen fizike gjendet vetëm Formulari i Deklarimit nënshkruar nga Kryetari i NJP z.J. R.. - Procesverbali i datës 07.08.2019 mbi hartimin e dokumentave standarte të procedurës së prokurimit, është mbajtuar vetëm me pjesëmarrjen e një anëtari të NJP, konkretisht vetëm z.J. R. në mungesë të pjesëmarrjes së dy anëtarëve të tjerë të NJP mbi përmbajtjen e këtij akti.	E lartë	Titullari i AK të marrë të gjitha masat e nevojshme që në të ardhmen ngritja e Njësisë së Prokurimit të bëhet jo vetëm në përputhje me kuadrin rregullativ, por të jetë realisht funksionale në tërësinë e saj, duke shmangur praktika ku dokumentet e prokurimit të përpilohen vetëm nga Përgjegjës i NJP, të tillë që anashkalojnë kontributin e specialistëve të fushave përkatëse në rolin e anëtarë të caktuar të NJP.

	- Lejimin e vazhdimit të procedurës së prokurimit nga Titullari i AK edhe me mangësitë e sipërcituara në kundërshtim më Ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 56 e nenit 57 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". - Mos anullimi i kësaj procedure prokurimi publik nga titullari i AK në kushtet kur DST është përgatitur jo nga NJP por vetëm nga pergjegjësi i saj, ka/mund sjellë hartimin e kritereve kualifikuese preferenciale, që çojnë në shmangien e OE nga pjesëmarrja në konkurim dhe përbën kundravajtje administrative.		
12	Projekti i Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" është realizuar dhe më pas dhuruar nga shoqeria "H.& S.11" shpk për Bashkinë Libohovë nëpërmjet nënshkrimit të Akt-Marrëveshje Dhurimi ndërmjet Bashkisë Libohovë dhe shoqërisë "H. & S. 11" shpk me objekt dhurimi projektin e "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë". Në këtë Akt-Marrëveshje Dhurimi mungojnë elementët thelbësorë si numër protokolli, data e nënshkrimit si dhe vlera e shërbimit të kryer. Për marrjen e këtij studimi, titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktivit dhe inventarizimin e tij në kartelat e aktivit, si e tillë mungon akti i marrjes në dorëzim të mallit i cili duhet të shoqëronte ank-dhurimin. Për këtë studim, mungojnë dokumentacioni shkresor i protokolluar mbi kërkesat e sektorit të fushëstë cilët të kenë konstatuar problematikën teknike si dhe korespodencat shkresore të titullarit të institucionit Bashkia Libohovë, mbi nevojën apo domosdoshmërinë e studimit për t'u kryer nga palë të treta, për të cilat bashkia nuk ka mundësinë të paguaj. Ky studim rezulton i pa rregjistruar në Pasqyrat Financiare të Bilancit për vitet 2019 dhe 2020 si dhe i paevidentuar në kartelat e aseteve "analitike e llogarisë 202". - Projekti i Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" është realizuar dhe më pas dhuruar nga shoqeria "Z.&C." shpk për Bashkinë Libohovë nëpërmjet nënshkrimit të Akt-Marrëveshje Dhurimi ndërmjet Bashkisë Libohovë dhe shoqërisë "Z.&C." shpk me objekt dhurimi projektin e "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë". Në këtë Akt-Marrëveshje Dhurimi mungojnë elementët thelbësorë si numër protokolli, data e nënshkrimit si dhe vlerae shërbimit të kryer. Për marrjen e këtij studimi, titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktivit dhe inventarizimin etij në kartelat e aktivit, si e tillë mungon akti i marrjes në dorëzim të mallit i cili duhet të shoqëronte ank-dhurimin. Për këtë studim, mungojnë dokumentacioni shkresor i protokolluar mbi kërkesat e sektorit të fushës të cilët të kenë konstatuar problematikën teknike si dhekorespodencat shkresore të titullarit të institucionit Bashkia Libohovë, mbi nevojën apo domosdoshmërinë e studimit për t'u kryer nga palë tëtreta, për të cilat bashkia nuk ka mundësinë të paguaj. Ky studim rezulton i pa rregjistruar në Pasqyrat Financiare të Bilancit për vitet 2020 dhe 2021 si dhe i paevidentuar në kartelat e aseteve "analitike e llogarisë 202".	E lartë	Titullari i Bashkisë Lbohovë në cilësinë e NA si dhe NZ të verifikojnë dhe plotësojnë praktikën dokumentare për marrjen në dorëzim të Projektit të Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit: "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" të dhuruar nga shoqeria "H.&S. 11" shpk; "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" të dhuruar nga shoqeria"Z. &C."shpk, si dhe të procedojnë me rregjistrimin e tyre në librat kontabël.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

a-Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Libohovë

Grupi i auditimit auditoi pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë, për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar[1], me rezervë[2]

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200, Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar. Këto të dhëna nuk paraqesin drejtë pozitën financiare të Bashkisë Libohovë në datën 31 Dhjetor 2020, referuar ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, pasi janë përgatitur në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Baza për opinionin e modifikuar, me rezervë:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Libohovë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 është 24,359,085 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2020 (materialiteti 24,359,085lekë), dhe ka gabime materiale jo të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, përveç rasteve të anomalive dhe mospërputhjeve individuale, fakt ky që përbën bazën e opinionit të modifikuar (ISA-705; ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinionin me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i rasteve:

Rastet e mospërputhshmërisë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 Dhjetor 2020 paraqitet në si më poshtë:

Janë rregjistruar në librat e kontabilitetit pa krijuar regjistrin e saktë të aktiveve të njësisë, si dhe pa u mbështetur në dokumentacion justifikues si ai i titullit të pronësisë këto llogari :

-Llogaria. 210 "Toka, Troje, Terrene" është në vlerën 0 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme.

-Llogaria 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet e pandryshuar prej 0 lekë dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme.

[1] Opinion i modifikuar jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar.

[2] Një opinion me "rezervë", jepet në rastet kur:

-audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;

-audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

-Llogaria e aktivit 212 " Ndërtesa dhe konstruksione 299,205,950 lekë.
Sistemi i gjendjes kontabël si shkak i gabimeve në llogaritjen e amortizimit për llogarinë 218 'Inventar Ekonomik' në vlerën 12,360 lekë për vitin 2020 dhe 8,045 lekë për vitin 2019.
Mbivlerësim i lloarisë 466 ' Kreditore për mjete nën ruajtje' për vlerën 11,116,761 lekë.
Nënvlerësim i llogarisë 467 " Kreditorë të ndryshëm' për vlerën 4,267,050 lekë;

b-Nga auditimi mbi përputhshmërinë

Opinion i modifikuar të kundërt[3].

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Libohovë të kuadrit rregullator për fushën e prokurimeve publike, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, aktivitetet dhe informacioni nuk përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, referuar kjo LPP dhe VKM në zbatim të saj, Kodi i procedurave administrative, pra evidentohen anomali të përhapura dhe thelbësore me procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar dhe të kundërt. Grupi i auditimit ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Nga auditimi i **5** procedurave, janë konstatuar devijime të akteve ligjore/nënligjore të LPP konkretisht si:
- Kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Dokumentat Standarte të Tenderit hartohen pa praninë e specialistëve të fushës dhe me mangësi numër anëtarësh.
- Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që është deklaruar në MFE për vitin 2019 dhe për vitin 2020 nuk përputhet me vlerën e detyrimeve referuar tabelave analitike që administron Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin "*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare"* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Libohovë.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

[3] Një "Opinion të kundërt", jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një niveli lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 871/1 Prot, datë 03.09.2021, ndryshuar me shkresën nr. 871/2, datë 27.09.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 07.09.2021 deri në datë 22.10.2021, në subjektin Bashkia Libohovë u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. M.B – Përgjegjëse Grupi

2. E.V – Anëtare

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Libohovë ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[4];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Libohovë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2019 - 2020, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

[4]Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

3. Idetifikimi i çështjes

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi janë:

Pika A. Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor përkatës për periudhën 2019-2020.

Pika B. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të parashikuar opinion mbi pasqyrat financiare për vitet 2019-2020.

Pika C. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" për periudhën 2019-2020.

Pika D. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

4. Përgjegjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Libohovë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Libohovë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Libohovë. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2018", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 99/2018, datë 03.12.2018"Për buxhetin e vitit 2019", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019"Për buxhetin e vitit 2020";

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 40/2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi plotësues nr. 2 datë 19.1.2019 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019",
- Udhëzimi MFE nr. 1 datë 17.1.2019 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019"
- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020"
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
- Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël**"**; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak Libohovë, etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Libohovë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye

me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.
(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.
4. Kontrolli i vlerësimit.
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. Konfirmim nga të tretët.
Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
7. Intervistimi
U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Libohovë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.
8. Raporte dhe Informacione
U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.
9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.
U zhvilluan pyetësorë me strukturat e Bashkisë Libohovë për të vlerësuar sistemet e kontrollit të brendshëm.
Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit
Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[5].
Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të

[5] ISSAI 1315

gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[6].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin "Bashkia Libohovë", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *(materiale por jo të përhapura)*, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime sipas 3-E në fushën e prokurimeve.
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e

[6] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Libohovë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes Vendore",* Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Libohovë.

Profili i Bashkisë Libohovë: Zona Gjeografike: Libohova kufizohet në veri me bashkinë Këlcyrë, në lindje me Bashkinë Përmet, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Gjirokastër. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Libohovës.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.667 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 7.158 banorë. Libohova shtrihet në një sipërfaqe prej 248.24 km2 me një densitet prej 28.83 banorë/km2.

Të dhëna të tjera: Bashkia Libohovë ka qenë që prej vitit 1914 nënprefekturë. Zona që përfshihet në bashkinë e re është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulti dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura ndërkombëtarisht.

Bashkia e re e Libohovës ka nevojë për investime në infrastrukturë, ekonomi, turizëm, bujqësi e blegtori, pasi është një nga zonat më të rëndësishme për numrin e bagëtive të imta dhe sipërfaqes bujqësore. Libohova mban rekord në Shqipëri për shumëllojshmërinë e bimëve medicinale . Pozicioni gjeografik e bën Libohovën një qendër potenciale, duke u bashkuar me zonat e tjera përreth si komunën Qendër- Libohovë apo komunën Zagorie. Ajo mund të ofrojë një shërbim më të mirë si qendër bashkie, duke shfrytëzuar potencialet hidrike, bujqësore, blegtorale dhe turistike të të gjithë zonës.

Pozicioni gjeografik kufitar, pjesëmarrja aktive në projektin IPA për zhvillimin e zonave ndërkufitare, projektet e përbashkëta për eko-turizmin me bashkinë e Zagorit, Greqi, do të sillin një hop cilësor për këtë zonë, duke përfituar nga shkëmbimi ekonomik dhe social –kulturor.

Misioni: Bashkia Libohovë ka si mision të saj, të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. Si njësi e nivelit bazë, ajo do të ketë si mision garantimin e vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Vizioni: Bashkia Libohovë synon mbështetjen e përmirësimit të shërbimeve publike dhe sociale, dërmarrjen e reformave administrative dhe të menaxhimit për funksionet specifike, financimin dhe

zbatimin e projekteve në fushën e arsimit, kulturës dhe sporteve si dhe rritjen e komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve drejt një qeverisjeje lokale me të përgjegjshme dhe transparente.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

A. Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor përkatës për periudhën 2019-2020.

Programimi i PBA për periudhën 2019-2020.

Titulli i gjetjes 1: Mos hartim i PBA-së sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Bashkia Libohovë për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe 2020-2022 nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Situata: Treguesit për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Libohovë për periudhën 2019-2020 janë miratuar me VKB-të:

- VKB nr. 59, datë 23.10.2018 "Për miratimin e PBA-së për periudhën 2019-2021" (që përfshin si vit të parë buxhetor vitin 2019), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 2463/1 Prot, datë 02.11.2018.
- VKB nr. 48, datë 24.12.2019 "Për miratimin e PBA-së për periudhën 2020-2022" (që përfshin si vit të parë buxhetor vitin 2020), konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1/80 Prot, datë 29.01.2020, dërguar në MFE me shkresën nr. 427 Prot, datë 23.01.2020;

Nga auditimi i hartimit të PBA-së rezulton se:

- Për miratimin e programeve buxhetore Bashkia Libohovë ka ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik me Urdhrin nr. 40, datë 06.03.209 dhe Urdhrin nr. 39, datë 04.03.2020, por nuk janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve;
- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33;
- Nuk janë miratuar nga Këshilli Bashkiak, tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, pika 6 "*...tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm miratohen jo më vonë se data 15 mars*";
- Kryetari i Bashkisë nuk ka miratuar Udhëzimin për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 35;
- Kryetari Bashkisë nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 36, pika 5.
- Për hartimin e PBA-së nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Libohovë. Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nuk disponon asnjë dokumentacion lidhur me dëgjesa publike për konsultimin e buxheteve afatmesme me komunitetin dhe grupet e interesit në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 5, pika ç.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, 35 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Ndikimi/Efekti: Bashkia Libohovë në hartimin e buxhetit afatmesëm nuk merr në konsideratë nevojat e komunitetit, të cilit i shërben.
Shkaku: Strukturat e Bashkisë Libohovë nuk kanë zbatuar detyrimet e tyre gjatë procesit të hartimit të buxhetit afatmesëm.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha hapave dhe procedurave në hartimin e buxhetit afatmesëm të bashkisë si dhe të dokumentojë të gjithë procesin e ndjekur.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. L.M Kryetare e Bashkisë Libohovë, znj. E.C me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. E.R, znj. J.M dhe znj. B.P me detyrë specialistë në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Programimi i buxhetit vjetor për vitin 2019 - 2020. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak.
Treguesit për buxhetin vjetor të Bashkisë Libohovë, për periudhën 2019-2020 janë miratuar me VKB-të:
- VKB nr. 1, datë 18.01.2019 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2019", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 187/1 Prot, datë 31.01.2019;
- VKB nr. 120, datë 23.12.2019 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2020", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1814/1 Prot, datë 09.01.2020;

Për vitet 2019-2020 në Bashkinë Libohovë buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 13 programeve, përkatësisht: Aparati, Arsimi bazë, Arsimi i mesëm, Gjelbërimi, Kultura, Ujësjellësi, Rrugët e Brendshme, Emergjencat Civile, Administrimi i Pyjeve, Kullim-Ujitje, Rrugët rurale, Mbrojtja nga zjarri, Kanalizime.
Bashkia Libohovë **nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë një kopje** të buxheteve vjetore në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 41, pika 6.

Tabela nr. A/1: Pasqyra e planit të buxhetit krahasuar me PBA për periudhën 2019-2020.
(000/lekë)

Nr.	Emërtimi	Plani i Buxhetit 2019	Plani i vitit 2019 në PBA	Diferenca	Plani i Buxhetit 2020	Plani i vitit 2020 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600, 601)	55,046	61,201	6,155	78,506	77,653	853
2	Shpenzime korrente (602,604,606,609)	18,454	44,770	26,316	34,677	34,291	386
3	Shpenzime investimi (230/231)	11,006	38,051	27,045	28,853	26,277	2,576
Totali		**84,506**	**144,022**	**59,516**	**142,036**	**138,221**	**3,815**

Burimi: Bashkia Libohovë

Buxheti i vitit 2019, është miratuar me VKB nr. 1, datë 18.01.2019 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2019", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 187/1 Prot, datë 31.01.2019. Për vitin 2019, Bashkia Libohovë e ka miratuar buxhetin **jashtë afateve ligjore** të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 32, Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore

"...Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 31 dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor". Për vitin 2019 buxheti është planifikuar në vlerën 84,506 lekë nga të ardhurat vendore, nga të ardhurat e trashëguara nga grandi i pakushtëzuar dhe nga grandi i kushtëzuar. Shpenzimet janë planifikuar të balancuara me të ardhurat.

Tabela nr. A/2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019

Planifikimi i të ardhurave 2019		**Planifikimi i shpenzimeve 2019**	
Burimi i të ardhurave	**Vlera në 000/ lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Vlera në 000/ lekë**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2019	12,869	Art. 600 Paga	47,396
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2019	0	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7,650
Total të ardhurat e veta	**12,869**	Art. 602 Shpenzime operative	17,154
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	40,113	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë Art. 604 Transferime korrente të brendshme	1,300
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.)	31,524		
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2019		Art. 230-231 Investime	11,006
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2019		Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit	**71,637**		
Totali të Ardhurave	**84,506**	**Totali Shpenzimeve**	**84,506**

Burimi: Bashkia Libohovë

Buxheti i vitit 2020 është miratuar me VKB nr. 120, datë 23.12.2019 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohovë për vitin 2020", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1814/1 Prot, datë 09.01.2020. Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2020 janë planifikuar të balancuara në vlerën 142,036 lekë, sipas tabelës në vijim.

Tabela nr. A/3: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020

Planifikimi i të ardhurave 2020		**Planifikimi i shpenzimeve 2020**	
Burimi i të ardhurave	**Vlera në 000/ lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Vlera në 000/ lekë**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2020	11,359	Art. 600 Paga	67,464
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2020	6,458	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	11,042
Total të ardhurat e veta	**17,817**	Art. 602 Shpenzime operative	30,827
Të ardhura të trashëguara nga grandi i pakushtëzuar	74,583	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë Art. 604 Transferime korrente të brendshme	3,850

Të ardhura të trashëguara nga grandi i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.)	32,637		
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2020 (të tjera)	17,000	Art. 230-231 Investime	28,853
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2020		Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit	**124,219**		
Totali të Ardhurave	**142,036**	**Totali Shpenzimeve**	**142,036**

Burimi: Bashkia Libohovë

Gjatë vitit 2019 buxheti ka pësuar disa ndryshime si vijon:

- VKB nr. 39, datë 21.03.2019, "Për disa ndryshime në buxhetin fillestar", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 474/1 Prot, datë 03.04.2019;
- VKB nr. 52, datë 21.05.2019, "Për disa ndryshime në buxhetin fillestar", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 50/1 Prot, datë 29.05.2019;
- VKB nr. 91, datë 13.09.2019, "Për disa ndryshime në buxhetin fillestar", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1241/1 Prot, datë 19.09.2019;
- VKB nr. 99, datë 25.10.2019, "Për disa ndryshime në buxhetin fillestar", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1550/1 Prot, datë 30.10.2019;
- VKB nr. 101, datë 15.11.2019, "Për një shtesë në buxhetin fillestar", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 1664/1, Prot, datë 02.02.2019;
- Ndryshime si rezultat i akordimit të transfertës së kushtëzuar për funksionin e gjendjes civile, për ndihmën sociale, për mbulimin e shpenzimeve të zgjedhjeve dhe për financimin e dy objekteve të investimeve, si më poshtë:

- Për Gjendjen Civile është akorduar fondi:

a. Për shpenzime personeli në vlerën 1,038 mijë lekë, sipas shkresës 301/4 Prot, datë 23.01.2019 dhe nr. 8107/10 Prot, datë 20.11.2019;
b. Për shpenzime operative në vlerën 24 mijë lekë;

- Për Ndihmën Ekonomike dhe Paaftësinë është akorduar vlera gjithsej prej 23,190 mijë lekë sipas shkresave nr. 280 Prot, datë 27.02.2019, nr. 269 Prot, datë 26.04.2019, nr. 862 Prot, datë 25.06.2019, nr. 1128/2 Prot, datë 28.08.2019, nr. 1507 Prot, datë 08.11.2019.

- Për mbulimin e shpenzimeve për zgjedhjet është akorduar fondi :

a. Për shpenzime operative në vlerën 62 mijë lekë, sipas shkresës nr. 12297 Prot, datë 26.06.2019;
b. Për pagesën e anëtarëve të komisioneve në vlerën 623 mijë lekë, sipas shkresës nr. 14039 Prot, datë 30.07.2019;

- Për financimin e objekteve të investimeve është akorduar fondi:

a. Për "Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" në vlerën 17,000 mijë lekë, sipas shkresës nr. 9491 Prot, datë 12.12.2019;
b. Për "Rikonstruksion dhe ndërtim palestre në shkollën 9-vjeçare Avni Rustemi, Libohovë" në vlerën 35,181 mijë lekë, sipas shkresës nr. 2656/1 Prot, datë 21.03.2019.

Tabela nr. A/4: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2019

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2019				**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2019**			
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë, miratuar me VKB ose sipas shkesave të Ministrive të linjës**	**Vlera në 000/lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë miratuar me VKB ose sipas shkresave të Ministrive të linjës**	**Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)**
	1	**2**	**1+2**		**3**	**4**	**3+4**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2019	12,869	0	12,869	Art. 600 Paga	47,396	16,468	63,864
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2019	0	10,318	10318	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shënd.	7,650	2,689	10,339
Total të ardhurat e veta	**12,869**	**10,318**	**23,187**	Art. 602 Shpenzime operative	17,154	12,252	29,406
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	0	10,853	10,853	Art. 604 Transferime korrente te brendshme+	100	2,049	2,149
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	0	21,840	21,840	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	200	23,190	23,390
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2019	40,113	0	40,113	Art. 230-231 Investime	11,006	63,987	74,993
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2019	31,524	130	31654	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	1,000	-376	624
Të ardhura nga transfertat e kushtëzuara	0	77,118	77,118				
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	**71,637**		**18,1578**				
Totali i të Ardhurave	**84,506**		**204,765**	**Totali i Shpenzimeve**	**84,506**	**120,259**	**204,765**

Burimi: Bashkia Libohovë

Ndryshimet në planin e të ardhurave nga buxheti fillestar i miratuar për vitin 2020, janë bërë me:

- VKB nr. 09, datë 25.02.2020, "Për disa ndryshime në buxhetin fillestar", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 235/1 Prot, datë 06.03.2020;
- VKB nr. 41, datë 28.08.2020, "Për disa ndryshime në buxhetin fillestar", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 835/2 Prot, datë 04.09.2020;
- Akordimi i transfertës së kushtëzuar për funksionin e gjendjes civile, për ndihmën sociale, për mbulimin e shpenzimeve të zgjedhjeve, shpërblimin e lindjeve dhe për financimin e dy objekteve të investimeve, si më poshtë:
- Për Gjendjen Civile është akorduar fondi:

a. Për shpenzime personeli në vlerën 1,045 mijë lekë, sipas shkresës nr. 144/6 Prot, datë 24.02.2020 ;
b. Për shpenzime operative në vlerën 24 mijë lekë, sipas shkresës nr. 7285/2 Prot, datë 22.10.2020 ;

- Për Ndihmën Ekonomike dhe Paaftësinë është akorduar vlera gjithsej prej 29,174 mijë lekë sipas shkresës nr. 432 Prot, datë 09.03.2020, nr. 661/2 Prot, datë 13.05.2020, nr. 1101 Prot, datë 20.07.2020, nr. 1257/1 Prot, datë 31.08.2020, nr. 1648/2 Prot, datë 09.11.2020.
- Për mbulimin e shpenzimeve për zgjedhjet është akorduar fondi prej 25 mijë lekë sipas shkresës nr. 7489/7 Prot, datë 05.11.2020
- Për shpenzimet e shpërblimit të lindjeve në vlerën 75 mijë lekë sipas shkresës nr. 8190/2 Prot, datë 01.12.2020.
- Për financimin e objekteve të investimeve është akorduar fondi:

a. Për "Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" në vlerën 19,334 mijë lekë, sipas shkresës nr. 5047 Prot, datë 03.07.2020;
b. Për "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" në vlerën 62,640 mijë lekë, sipas shkresës nr. 4939 Prot, datë 14.02.2020.

Tabela nr. A/ 5: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2020

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2020				**Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2020**			
Burimi i të ardhurave	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë, miratuar me VKB, ose sipas shkresave të Ministrive të linjës**	**Vlera në 000/lekë**	**Emërtimi i zërave**	**Buxheti fillestar, miratuar me VKB**	**Buxheti shtesë miratuar me VKB**	**Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)**
	1	**2**	**1+2**		**3**	**4**	**3+4**
Të ardhura të planifikuara për vitin 2020	11,359		11,359	Art. 600 Paga	67,464	355	67,819
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2020	6,458	369	6,827	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shënd.	11,042	147	11,189

Total të ardhurat e veta	**17,817**	**369**	**18,186**	Art. 602 Shpenzime operative	30,827	915	31,742
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	10,844	-38	10,806	Art. 604 Transferime korrente te brendshme	1,600	0	1,600
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	22,382	-730	21,652	Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	250	29,274	29,524
Transferta e pakushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2020	41,356	0	41,356	Art. 230-231 Investime	28,853	65,372	94,225
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2020	32,637	0	32,637	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	2,000	-1145	855
Të ardhura nga transfertat e kushtëzuara	17,000	95,293	112,317				
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	**124,219**	**94,525**	**218,768**				
Totali i të ardhurave	**142,036**		**236,954**	**Totali i Shpenzimeve**	**142,036**		**236,954**

Burimi: Bashkia Libohovë

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura. Përdorimi i të ardhurave.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019

Për vitin 2019 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **204,765** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **163,554** mijë lekë, ose në masën 80%. Zërat që kanë vlerën më të ulët të realizimit janë zëri shpenzime operative dhe paga, përkatësisht realizuar në masën 74% secili, paraqitur në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr.A/6: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Libohovë, për vitin 2019, në mijë lekë						
Nr.	**Përshkrimi i shpenzimeve**	**Plani 2019**	**Fakti 2019**	**Realizimi në %**	**Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta**	**Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti**
	Bashkia pa njësitë vartëse					
1	Art. 600 Paga	63,243	46,794	74%	5,667	41,127
2	Art. 601Sig. shoqërore &shënd	10,338	7,947	77%	1,215	6,733
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	29,343	18,442	63%	1,767	16,674
4	Art. 604 Transferime korrente te brendshme	2,773	2,050	74%		349

5	Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë (PAK)	23,390	23,334	100%	152	23,182
6	Art.230-231 Investime	74,993	64,302	86%	1,701	60,212
7	Të tjera	685	685	100%	4,090	685
	TOTAL viti 2019	**204,765**	**163,554**	**80%**	**14,592**	**148,962**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Realizimi i shpenzimeve të personelit në masën 74% dhe 77% ka ardhur si pasojë e fondeve të akorduara për këtë qëllim për funksionet e deleguara, të cilat kanë qenë më të larta se nevojat e personelit të punësuar. Këto fonde janë trashëguar vit pas viti, duke sjellë rritje të planit të shpenzimeve.
Realizimi i shpenzimeve operative gjithsej në masën 63% ka ardhur kryesisht si pasojë e vendosjes së një sekuestroje në llogarinë në Thesar prej muajit janar 2019. Sekuestroja është vendosur në vlerën 16,437,212 lekë, për Vendimin nr. 3948, datë 07.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë "Dëmshpërblim për aksident në punë me pasojë vdekjen", duke pezulluar zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe pagesave deri më 21.10.2019 datë në të cilën është lidhur marrëveshja për likuidim me këste vjetore të detyrimit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020
Për vitin 2020 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën 236,954 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 200,541 mijë lekë, ose në masën 85%, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr.A/7: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2020

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Libohovë, për vitin 2020, në mijë lekë						
Nr.	**Përshkrimi i shpenzimeve**	**Plani 2020**	**Fakti 2020**	**Realizimi në %**	**Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta**	**Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti**
	Bashkia pa njësitë vartëse					
1	Art. 600 Paga	67,818	48,809	72%	3,028	45,781
2	Art. 601Sig. shoqërore &shënd	11,189	8,119	73%	685	7,434
3	Art. 602 Shpenzime operative	31,742	25,844	81%	3,289	22,555
4	Art. 604 Transferta korrente te brendshme	2,454	1,500	61%	1,500	0
5	Art. 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	29,424	29,290	100%	225	29,065
6	Art. 230-231 Investime	94,224	86,904	92%	2,837	84,067
7	Të tjera	100	75	75%	0	75
	TOTAL viti 2020	**236,954**	**200,541**	**85%**	**11,564**	**188,977**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Në tabelat e mësipërme mund të vërehet se realizimi i zërit investime ka pësuar një rritje nga viti 2019 në vitin 2020, nga 86% në 92%.

Tabela nr.A/ 8: Përqindja e secilit zë të shpenzimeve faktike në shpenzimet totale për vitet 2019-2020

Nr.	Zërat	Viti 2019		Viti 2020	
		Vlera në % e secilit zë shpenzimi kundrejt shpenzimet totale,(përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK)	Vlera në % e secilit zë shpenzimi kundrejt shpenzimet totale (pa llogaritur ndihmën ekonomike dhe PAK)	Vlera në % e secilit zë shpenzimi kundrejt shpenzimet totale,(përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK)	Vlera në % e secilit zë shpenzimi kundrejt shpenzimet totale (pa llogaritur ndihmën ekonomike dhe PAK)
1	Artikulli - 600 Paga	28.6 %	33.4%	24.3%	28.5%
2	Artikulli - 601Sig. shoqërore &shënd	5%	5.7%	4%	4.7%
3	Artikulli - 602 Shpenzime Operative	11.3%	13.2%	13%	15%
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	1.3%	1.5%	0.7%	0.9%
5	Artikulli - 606 Ndihma Ek. dhe PAK	14.3%	-	14.6%	
6	Artikulli – 230 & 231 Investime	39.3%	46%	43.3%	50.7%

Përpunoi: Grupi i auditimit

Bashkia Libohovë nuk planifikon të ardhura për mbulimin e shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe PAK (e cila zë 14.3% të buxhetit faktik vjetor në vitin 2019 dhe 14.6% në vitin 2020), por vetëm administron këtë proces në lidhje me plotësimin e kritereve nga përfituesit dhe hartimin e listave. Duke marrë parasysh këtë fakt, duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK, konstatohet se shpenzimet totale janë: në vitin 2019 - 140,220 mijë lekë, (163,554 – 23,334 = 140,220) dhe në vitin 2020 - 171,251 mijë lekë (200,541 - 29,290 = 171,251). Bazuar në buxhetin faktik vjetor pa përfshirë ndihmën ekonomike dhe PAK, peshën specifike më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë:

- Për vitin 2019 zëri "paga dhe sigurime shoqërore" (600,601) përbën 39.1% të totalit të shpenzimeve, "investimet" përbëjnë 46% dhe "shpenzimet operative" përbëjnë 13.2%;
- Për vitin 2020 zëri "investime" përbën 50.7% të shpenzimeve, zëri "paga dhe sigurime shoqërore" (600,601) përbën 33.2% të totalit të shpenzimeve dhe "shpenzimet operative" përbëjnë 15%.

Përdorimi i të ardhurave

Viti 2019

Në totalin e shpenzimeve të kryera për vitin 2019 (në vlerën 140,220 mijë lekë, pra pa llogaritur vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK), shpenzimet të cilat janë mbuluar nga të ardhurat e veta janë në vlerën 14,592 mijë lekë, ose në masën 10.4% (14,592/140,220*100).

Viti 2020

Në totalin e shpenzimeve të kryera për vitin 2020 (në vlerën 171,251 mijë lekë, pra pa llogaritur vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK), shpenzimet të cilat janë mbuluar nga të ardhurat e veta janë në vlerën 11,564 mijë lekë, ose në masën 6.8% (11,564 /171,251 *100).

Raportet e monitorimit mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor.

Titulli i gjetjes 2: Mos hartimi i raporteve periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit të Bashkisë Libohovë.

Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë për periudhën nën auditim 2019-2020, nuk ka hartuar raportet periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48.

Situata: Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 44 Raporti vjetor, "*Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës*", rezulton se **për vitin 2019** Raporti i Monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Libohovë është miratuar me VKB nr. 11, datë 25.02.2020 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 692 Prot, datë 15.04.2020. **Për vitin 2020** Raporti i Monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Libohovë është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 427 Prot, datë 23.03.2021.

Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë si për vitin 2019 ashtu edhe për vitin 2020, nuk ka hartuar raportet periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor, "*Nëpunësit autorizues të njësive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katër mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit... Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të njësisë përkatëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave*".

Kriteri: Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48.

Ndikimi: Mungesa e monitorimit periodik të zbatimit të buxhetit vjetor sjell që Bashkia Libohovë të mos ketë informacion të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e programeve buxhetore të zhvillimit.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Libohovë nuk kanë zbatuar detyrimet e tyre lidhur me procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë të marrë masa për të dokumentuar procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, të hartojë raportet periodike të monitorimit dhe ti dërgojë ato në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. E.C me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. E.R, znj. J.M dhe znj. B.P me detyrë specialistë në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara.

Titulli i gjetjes 3: Bashkia Libohovë nuk ka të regjistruar saktë vlerën totale të detyrimeve të prapambetura.

Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që është deklaruar në MFE për vitin 2019 me vlerë 29,705,001 lekë dhe për vitin 2020 me vlerë 8,031,744 nuk përputhet me vlerën e detyrimeve referuar tabelave analitike që administron Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë.

Situata: Për vitin 2018, me shkresë nr. 135 Prot, datë 30.01.2019 Bashkia Libohovë ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrimet e prapambetura në vlerën 10,715,650 lekë për zërin "Vendime Gjyqësore".

Detyrimet e prapambetura viti 2019

Bashkia Libohovë ka raportuar periodikisht në MFE mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për vitin 2019[7]. Referuar shkresës nr. 182 Prot, datë 30.01.2020, mbi krijimin dhe likuidimin e detyrime për vitin 2019, rezulton se vlera totale e detyrimeve të raportuara në MFE është 29,705,001 lekë, e paraqitur sipas zërave në tabelën në vijim, ku "Vendimet gjyqësore" përbëjnë 77% të detyrimeve totale.

Tabela nr.A/9: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Libohovë raportimi në MFE, 30.01.2020

Nr.	Emërtimi i detyrimit sipas natyrës	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2019
1	Investime	6,589,203
2	Mallra dhe Shërbime	62,936
3	Vendime gjyqësore	23,052,862
Totali		**29,705,001**

Burimi: Bashkia Libohovë

Për vitin 2019, vlera e detyrimeve të prapambetura sipas thesarit dhe e paraqitur në bilanc, llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", është 21,380,342 lekë.

Referuar tabelave analitike që administron Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar detyrimet e prapambetura më 31.12.2019 janë në vlerën 47,033,495 lekë.

Detyrimet e prapambetura të vitit 2020

Bashkia Libohovë ka raportuar periodikisht në MFE mbi ecurinë e detyrimeve të prapambetura për vitin 2020[8]. Me shkresë nr. 307 Prot, datë 01.03.2021, ka raportuar detyrimet e prapambetura për vitin 2020 në vlerën 8,031,744 lekë, ku vlerën më të madhe të detyrimeve e zë zëri "Shpenzime kapitale", në masën 93% .

Tabela nr.A/10: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Libohovë raportimi në MFE, 01.03.2021

Nr.	Emërtimi i detyrimit sipas natyrës	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2020
1	Shpenzime kapitale	7,446,255
2	Mallra dhe Shërbime	233,889
3	Të tjera	351,600
Totali		**8,031,744**

Burimi: Bashkia Libohovë

[7]Shkresa nr, 562 Prot, datë 18.04.2019, shkresa nr. 574/1 Prot, datë 02.07.2019, shkresa nr. 1521 Prot, datë 03.10.2019, shkresa nr. 182 Prot, datë 30.01.2020.

[8] Shkresa nr. 502 Prot, datë 14.04.2020, shkresa nr. 994 Prot, datë 07.07.2020, shkresa nr. 1430 Prot, datë 06.10.2020, shkresa nr. 307 Prot, datë 01.03.2021.

Për vitin 2020, vlera e detyrimeve të prapambetura për zërat mallra dhe shërbime dhe investime sipas thesarit dhe e paraqitur në bilanc llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", është 8,031,744 lekë. Në tabelat analitike vlera e detyrimeve të prapambetura është 28,264,769 lekë.
Nga analizimi i të dhënave të paraqitura më sipër rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që është deklaruar në MFE për vitin 2019 nuk përputhet me vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc, nuk përputhet me vlerën e detyrimeve sipas akt rakordimeve me thesarin si dhe nuk përputhet me vlerën në tabelat analitike që administron Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë. Kjo mospërputhje e vlerave vjen si rezultat se në raportimet që bëhen në MFE nuk përfshihen detyrimet që kanë mungesë dokumentacioni, kontrata të nënshkruara dhe të pafaturuara, detyrimet nga ish komunat për të cilat gjithashtu mungon dokumentacioni.
Edhe për vitin 2020, vlera e detyrimeve të prapambetura që është deklaruar në MFE nuk përputhet me vlerën e detyrimeve të prapambetura që paraqitet në listat analitike. Në detyrimet e prapambetura të deklaruara në MFE nuk përfshihen detyrimet e prapambetura që lindin nga vendimet gjyqësore për të cilat ka marrëveshje apo vendim për likuidim me këste, (Vendim nr. 20-2014-686/368, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për likuidimin me këste të detyrimit ndaj z. F. R. dhe akt marrëveshja nr. 27 Prot, datë 21.10.2019).
Informacion më i detajuar rreth detyrimeve të prapambetura sipas listave analitike që disponon Sektori i Financës paraqitet në Anekset nr. 1 dhe 2.
Nga auditimi rezulton se Bashkia Libohovë nuk ka një plan/grafik të miratuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me përjashtim të vendimeve gjyqësore.

Lidhur me vendimet gjyqësore për largime nga puna, rezulton të jetë vetëm një vendim i cili është likuiduar në vitin 2020 sipas tabelës më poshtë.

Tabela nr.A/11: Vendimet gjyqësore për largimet nga puna për vitin 2020

Nr.	Emër mbiemër i paditësit	Pozicioni i punës së paditësit	Objekti padisë	Data e largimit nga puna të punonjësit	Nr. dhe data vendimit të Gj. Apelit	Vlera në lekë e dëmshpërblimit, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit	Pagesa e kryer gjatë vitit 2020
1	Fisnik Ruci	Magazinier	Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna	03.10.2016	Nr. 936, datë 12.11.2020	756,000	756,000
Shuma totale						756,000	756,000

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52.
Uudhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"
Ndikimi: Mos rregjistrimi i vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura dhe mos likuidimi i tyre në kohë ndikon në vlerësimin e situatës financiare të Bashkisë Libohovë.
Shkaku: Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nuk ka regjistruar të gjitha faturat e pa likuiduara dhe nuk ka likuiduar rregullisht faturat e regjistruara.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë të ngrejë një grup pune me qëllim analizimin, dhe regjistrimin e vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Libohovë, si dhe të hartojë dhe miratojë planin për likuidimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. L.M Kryetare e Bashkisë Libohovë, znj. E.C me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar deri më datë 09.04.2021, z. E.R, J.M dhe B.P me detyrë specialistë në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/17, datë 01.12.2021 nga znj. J.M dhe observacion nr. 1069/19 Prot, datë 02.12.2021 nga znj. B.P me detyrë specialiste në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. lidhur me mos hartimin e PBA-së sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, mos hartimi i raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit si dhe mos likuidimit të faturave të prapambetura, është detyrë e Përgjegjëses së Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë pasi përmbushja e detyrave funksionale është detyrë e secilit punonjës të Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid 2019.

Në zbatim të përcaktimeve të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19", strukturat shtetërore duhet të ofrojnë asistencë në banesë ndaj shtresave në nevojë në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19. Ofrimi i asistencës konsiston në dërgimin e produkteve ushqimore e jo ushqimore minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mësipërme, për llogari të tyre.[9] Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2020 nga Bashkia Libohovë në kuadër të masave të marra për të përballuar situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 janë shpenzuar fonde në vlerën 455,179 lekë, sikurse paraqiten të detajuara në tabelën në vijim.

Tabela nr. A/12: Detajimi i fondeve të shpenzuara në kuadër të masave të marra gjatë pandemisë

Nr.	Datë	Llog. Analitike	Përshkrimi Llogarisë	Shuma	Detaje
123	01.04.2020	6021	Materiale dhe shërbime speciale	43,180	Blerje e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore për familjet në nevoje sipas faturës nr. 01, datë 31.03.2020, në zbatim të VKB nr. 17, datë 25.03.2020
124	01.04.2020	6021	Materiale dhe shërbime speciale	21,000	Blerje e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore për familjet në nevoje sipas faturës nr. 73, datë 01.04.2020, në zbatim të VKB nr. 17, datë 25.03.2020
189	04.06.2020	6022	Shërbime nga të tretët	96,000	Shërbimi i dezinfektimit, deratizimit dhe dezinsektimit të institucioneve publike sipas

[9] VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19", pika 1 dhe 2.

					faturës nr. 131, datë 24.03.2020, në zbatim të VKB nr. 17, datë 25.03.2020
200	18.06.2020	6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	294,999	Blerje klor për dezinfektim ambientesh sipas faturës nr. 03, datë 16.04.2020, në zbatim të VKB nr. 14, datë 25.03.2020
			TOTALI	**455,179**	

Burimi: Bashkia Libohovë

Burimi i krijimit të të ardhurave , vlerësimi i mbledhjes së tyre dhe borxhi tatimor

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Viti 2019

Për vitin 2019 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Libohovë është miratuar me VKB-në nr. 74, datë 20.12.2018 për "Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në territorin e Bashkisë Libohovë për vitin 2019", i ndryshuar.

Viti 2020

Për vitin 2020 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Libohovë është miratuar me VKB-në nr. 116, datë 23.12.2019 për "Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në territorin e Bashkisë Libohovë për vitin 2020".

Tabela nr.A/13: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Libohovë, për vitet 2019–2020

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2019 (mijë lekë)			Viti 2020 (mijë lekë)		
		Plan	**Fakt**	**%**	**Plan**	**Fakt**	**%**
1	Taksë mbi ndërtesat	**1,953**	**1,804.2**	92.4	**1,953**	**1,465.8**	75
	a)Taksë mbi ndërtesat nga banesa	1,249	984.6	78.8	1,249	86.6	6.9
	b)Taksë mbi ndërtesat nga biznesi	704	819.6	116.4	704	600.3	85
2	Taksë mbi tokën buqësore	**2,000**	**1,947.3**	97.4	**2,000**	**1,779.2**	89
3	T/B/V 7002100		**57.4**			**58.2**	
4	Taksë mbi ndërtimet	**2,000**	**1,086.3**	54.3	**2,000**	**993.1**	50
	a) Taksë e ndikimit në inf. nga legalizimet	400	-	-	400	130	32.5
	b)Taksë e ndërtimit të ri	1,600	1,086.3	67.9	1,600	863	53.9
5	Taksë Regj. Automjeti	**1,200**	**2,031.1**	169.3	**1,200**	**2,309**	192
6	Taksë trualli	**395**	**293.9**	74.4	**395**	**264.5**	67
	a)Takse trualli banese	155	123.8	79.9	155	94.4	61
	b) Takse trualli biznese	240	170.1	70.9	240	170.1	71
7	Takse tonazhi	-	**23.8**	-	--	**0.7**	-
8	Tatim/Thjesht	-	**133.6**	-	-	**14.1**	-
9	Tarifë ndriçimi rrugor	**325.2**	**288.4**	88.7	**325**	**245.7**	76
	a)Tarifë ndriçimi rrugor familjar	279.6	232.6	83.2	279	199.5	72
	b)Tarifë ndriçimi rrugor biznese	45.6	55.7	122.2	45	46.2	96
10	Tarifë pastrimi	**811.3**	**764.6**	94.2	**811**	**678.5**	84

	a)Tarifë pastrimi familjare	429.2	310.4	72.3	429	271.7	63
	b)Tarifë pastrimi biznesi	382.1	454.2	118.9	382	406.8	106
11	Leje veprimtarie	-	**143**	-	-	**93**	-
12	Tarifë parkingu	**80**	**4.5**	5.6	**80**	-	-
13	Kullotat	**2,600**	**868.5**	217.1	**850**	**772.6**	91
14	Shitja e produkteve heterogjene	**150**	**210.1**	140.1	**150**	**210**	140
15	Qiratë nga ndërtesa	**25**	**24**	96	**25**	**24**	96
16	Shërbimet	**40**	**33.5**	83.8	**40**	**15.3**	38
17	Tarifë për ujitje	**200**	**19.8**	9.9	**200**	**2**	1
18	Zënia e hapësirës publike	**20**	**42.3**	211.5	**20**	**96**	480
19	T.V për lejen e shitjes së karburanteve	-	**200**	-	**-**	**200**	-
20	Të ardhura personale	-	-	-	-	**566.6**	-
21	Kamata	-	**215.7**	-	-	**128.7**	-
22	Qira nga toka bujqësore	-	**79.7**	-	-	**102.2**	-
23	Të ardhura nga qira për troje	**670**	**805**	120.1	**670**	**670**	100
24	Të tjera jo tatimore	**400**	**11.2**	2.8	**400**	**72.3**	18
SHUMA		**12,870**	**11,088**	**86%**	**11,119**	**10,762**	**96.8%**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Libohovë paraqitet si vijon:

- *Për vitin 2019* të ardhurat janë realizuar në masën 86%, nga 12,870 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 11,088 mijë lekë (minus 1,782 mijë lekë).
- *Për vitin 2020* të ardhurat janë realizuar në masën 97%, nga 11.119 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 10,762 mijë lekë (minus 357 mijë lekë).

Nga analizimi i mëtejshëm i tabelës nr. A/13 mund të themi se për vitin 2019, 8 zëra janë realizuar në masën ose mbi 100%, 4 zëra janë realizuar në masën ose mbi 90%, 8 zëra janë realizuar në masën ose mbi 70% 2 zëra janë relaizuar në masën 50% dhe 3 zëra janë realizuar nën masën 30%. Për vitin 2020, 5 zëra janë realizuar në masën ose mbi 100%, 3 zëra janë realizuar në masën ose mbi 90%, 7 zëra janë realizuar në masën ose mbi 70% dhe 5 zëra janë realizuar në masën ose mbi 50% dhe 5 zëra janë realizuar nën masën 50%.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Titulli i gjetjes 4: Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve)

Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë **8 subjekte** të legalizuara me vlerë **269,996 lekë**, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë.

Situata: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , neni 9, pika 3/c[10]

[10] Ligjinr. 95/2018 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c "për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e

dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5[11].
Në Bashkinë Libohovë struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me çertifikatën e pronësisë është Sektori i Shërbimit Urban.
Bazuar në shkresat që ASHK dërgon në Bashkinë Libohovë, për vitin *2019* janë legalizuar gjithsej 17 objekte për të cilat Sektori i Shërbimit Urban ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 411,346 lekë. Kanë paguar detyrimin 15 qytetarë në vlerën 332,436 lekë. Janë **debitorë 2 qytetarë në vlerën 78,910 lekë.** Për vitin *2020* janë legalizuar 10 objekte me detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë 347,031 lekë. Kanë paguar detyrimin 4 qytetarë në vlerën 155,945 lekë. Janë **debitorë 6 qytetarë në vlerën 191,086 lekë**.

Tabela nr.A/14: Lista e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, 2019-2020

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Vendndodhja	Detyrimi/Taksa Ndik.Inf. 0.5% (lekë)
Viti 2019			
1	Drini Ramiz Muxhaj	Bulo	29,989
2	Ferdi Mehdi Pasho	Libohovë	48,921
Totali			**78,910**
Viti 2020			
1	Dhimitër Muharem Napoloni	Nepravishtë	27,265
2	Subi Bashkim Cavani	Nepravishtë	16,307
3	Naftjar Jakup Vedra	Libohovë	49,182
4	Hysni Avni Beqari	Nepravishtë	32,614
5	Luan Diftir Hoxha	Nepravishtë	17,449
6	Bejtash Demo Cobani	Nepravishtë	48,269
Totali			**191,086**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër rezulton se, **për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 8 subjekte të legalizuara me vlerë 269,996 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Libohovë.**
Në zbatim të detyrimeve të ligjit 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me ligjin nr. 95/2018, neni 9, pika 3/c[12] deri në muajin gusht 2020 individët që kishin përfituar lejen e legalizimit nuk mund ta merrnin atë pa vërtetuar pagesën e taksave pranë bashkisë. Ky detyrim ligjor është shfuqizuar me Ligjin nr. 98/2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin

ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi".

[11] VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: "Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi".

[12] Ligji nr. 95/2018 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c "Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi". Ligji nr. 98/2020 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", fjalia e dytë shfuqizohet".

nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", dhe nga muaji gusht 2020 ASHK mund të lëshojë lejen e legalizimit edhe pa paguar taksat vendore. Shkresat që dërgon ASHK në Bashkinë Libohovë administrohen nga Sektori i Shërbimit Urban i cili llogarit taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet. Për qytetarët që paguajnë, ky sektor njofton Sektorin e Inspektimit të Territorit i cili rregjistron të ardhurat që vijnë nga kjo taksë.

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c".

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Libohovë, nga mos arkëtimi i vlerës prej **269,996 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e maseve nga Sektori i Shërbimit Urban në bashkëpunim me Sektorin e Inspektimit të Territorit ndaj subjekteve që kanë përfituar certifikatën e pronësisë dhe nuk kanë paguar detyrimin e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi: Sektori i Shërbimit Urban të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Inspektimit të Territorit mbi subjektet debitore për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për **8 subjekte** të legalizuara me **vlerë 269,996 lekë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. F.M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Urban dhe z. Xh.S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Territorit.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Libohovë kryhet në programin Excel. Sektori i Inspektimit të Territorit gjithashtu kryen edhe rregjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Libohovë:

Tabela nr.A/15: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Libohovë, 2019-2020

Lloji i biznesit	Numri në fillim të vitit		Regjistrime të reja		Mbyllur aktivitetin gjatë vitit		Numri në fund të vitit	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Biznes i vogël	60	58	0	1	2	0	58	59
Biznes i madh	8	6	0	0	2	0	6	6
Totali	**68**	**64**	**0**	**1**	**4**	**0**	**64**	**65**

Burimi: Bashkia Libohovë

Sikurse mund të vërehet edhe në tabelën më sipër në periudhën 2019-2020 numri i bizneseve në Bashkinë Libohovë pothuajse nuk ka ndryshuar, është regjistruar një biznes i ri gjatë vitit 2019 dhe janë mbyllur 4 biznese gjatë vitit 2020.

Menaxhimi i borxhit

Titulli i gjetjes 5: Debitorët për taksat dhe tarifat vendore 2019-2020 dhe masat e marra nga Bashkia Libohovë për të arkëtuar detyrimet.

Detyrimi që subjektet fizik/juridik kanë ndaj Bashkisë Libohovë më 31.12.2020, është **6,138,150 lekë për 64 subjekte** dhe **17,065,243 lekë për 797 familje,** vlerë kjo që sjell **të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Libohovë në total **23,203,393 lekë**.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi realizimin e të ardhurave u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për çdo vit, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore.

Për periudhën 2019-2020 rezulton se borxhi tatimor i subjekteve përbëhet nga taksa e ndërtesës dhe e truallit dhe tarifat e pastrimit dhe ndriçimit. Më datë 31.12.2020 Bashkia Libohovë ka 64 subjekte debitore me vlerë totale të borxhit tatimor **6,138,150 lekë,** (informacion më i detajuar rreth subjekteve debitore, paraqitet në Aneksin nr.3).

Tabela nr. A/16: Përmbledhëse e Subjekteve Debitorë sipas llojeve të taksave/tarifave dhe viteve

Nr.	Emërtimet	Biznesi i Madh		Biznes i Vogël		Shuma	
		2019	2020	2019	2020	2019	2020
1	Taksë Ndërtese	74,925		12,979	39,402	87,904	39,402
2	Tarifë Pastrimi	25,000		18,750	22,500	43,750	22,500
3	Tarifë Ndriçimi	720		2,700	3,960	3,420	3,960
4	Taksë Trualli	43,200				43,200	
5	Detyrime të mbartura	165,473		5,875,862		6,041,335	
	SHUMA	**309,318**		**5,910,291**	**65,862**	***6,219,609***	**65,862**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Taksat dhe tarifat familjare

Në Bashkinë Libohovë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifat e pastrimit dhe të ndriçimit. Në tabelat në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur detyrimet e familjeve sipas taksave dhe tarifave.

Tabela nr.A/17: Familjet debitore në Bashkinë Libohovë për vitin 2019-2020

Nr.	NJA	Detyrimi për taksat dhe tarifat familjare - 2019									
		Tokë		Ndërtesa		Truall		Ndriçim		Pastrim	
		Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera
1	Libohovë	679	834,750	498	636,474	537	108,949	496	119,040	497	248,500
2	NjA Qendër	612	866,469	575	403,149	550	23,436	415	99,600	422	126,600
3	NjA Zagori	339	319,484	385	323,571	385	16,784	130	31,200		
	Totali	**1630**	**2,020,703**	**1458**	**1,363,194**	**1472**	**149,169**	**1041**	**249,840**	**919**	**375,100**
Detyrimi për taksat dhe tarifat familjare - 2020											

1	Libohovë	687	833,908	505	639,388	560	106,705	473	113,520	474	237,000
2	NjA Qendër	612	865,696	575	449,819	550	31,666	394	94,560	399	119,700
3	NjA Zagori	339	319,484	370	316,303	370	16,779	129	30,960		
	Totali	**1,638**	**2,019,088**	**1,450**	**1,405,510**	**1,480**	**155,150**	**996**	**239,040**	**873**	**356,700**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumenteve që administron Sektori i Inspektimit të Territorit sikurse mund të vërehet edhe në tabelën e mësipërme numri i familjeve debitore në Bashkinë Libohovë pothuajse nuk ka pësuar ndryshim nga viti 2019 në vitin 2020. Përkatësisht në 31.12.2020 kemi 1638 familje debitore për taksën e tokës me vlerë 2,019,088 lekë, 1450 familje debitore për taksën e ndërtesës me vlerë 1,405,510 lekë, 1480 familje debitore për taksën e truallit në vlerë 155,150 lekë, 996 familje debitore për tarifën e ndriçimit në vlerën 239,040 lekë dhe 873 familje debitore për tarifën e pastrimit në vlerën 356,700 lekë. Për taksën e tokës numri më i lartë i familjeve debitore është në NJA Libohovë, përkatësisht 687 familje, për taksën e ndërtesës është në NJA Qendër 575 familje, për taksën e truallit në NJA Libohovë, për tarifën e ndriçimit dhe të pastrimit në NJA Libohovë 474 familje.
Në Bashkinë Libohovë për periudhën nën auditim gjendja e debitorëve progresiv rezulton si më poshtë:

Tabela nr.A/18: Përmbledhje e familjeve dhe subjekteve debitore në Bashkinë Libohovë për periudhën 2019-2020

Lloji	2019		2020	
	numri	vlera	numri	vlera
Familje	762	15,693,004	797	17,065,243
Biznes i vogël	59	5,946,712	63	5,838,557
Biznes i Madh	1	299,593	1	299,593
Totali	**822**	**21,939,309**	**861**	**23,203,393**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Nga të dhënat e përpunuara dhe të paraqitura në tabelën nr. 9 numri i familje debitore më 31.12.2020 është 797 me vlerë të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore 17,065,23 lekë.
Borxhi tatimor është në total **23,203,393 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë**, nga të cilat 17, 065,243 lekë janë detyrime nga familjet dhe 6,138,150 lekë janë detyrime nga bizneset.

Masat për uljen e borxhit
Sektori i Inspektimit të Territorit në Bashkinë Libohovë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:[13]
1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Inspektimit të Territorit lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë

[13] Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 89,90,91,93.

bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019 dhe 2020.
Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2019, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar. Përkatësisht:

- Shkresa nr. 1269 prot, datë 21.08.2019, drejtuar 9 bankave te nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 33 subjekteve debitore ndaj bashkisë për taksat dhe tarifat vendore;
- Shkresa nr. 1271 prot, datë 21.08.2019 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Gjirokastër;
- Shkresa nr. 1270 prot, datë 21.08.2019 drejtuar ASHK-së Gjirokastër;
- Shkresa nr. 1219 prot, datë 26.08.2020, drejtuar 9 bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare për 32 subjektet debitorë që nuk kanë paguar taksat dhe tarifat vendore ndaj bashkisë;
- Shkresa nr. 1211 prot, datë 26.08.2020 drejtuar DRTRRGJ mbi vendosjen e barrës hipotekore për 32 subjektet debitore për taksat dhe tarifat vendore;
- Shkresa nr. 1212 prot, datë 26.08.2020 drejtuar ASHK-së Gjirokastër për 32 subjekte debitore.

Për vitin 2019 si rezultat i masave të marra për uljen e borxhit tatimor kanë paguar detyrimet 8 subjekte me vlerë 170,043 lekë, për vitin 2020, 3 subjekte me vlerë 68,315 lekë, ndërsa pagesat kanë vijuar edhe në vitin 2021 ku kanë paguar 3 subjekte në vlerën 125,798 lekë. Në total efekti i masave të marra për uljen e borxhit tatimor është 364,156 lekë, sipas tabelës në vijim.

Tabela nr.A/19: Efektet e masave të marra për uljen e borxhit tatimor

Nr.	Emë Mbiemër	Nr. faturës	Data	Vlera
1	Hektor Shehu	946	01.11.2019	12,897
2	Loni Bilibashi	364	21.05.2019	11,873
3	Vladimir Telo	987	07.11.2019	33,494
4	Viktor Caro	214	04.04.2019	21,284
5	Kostandin Memo	1	03.01.2019	7,033
6	Fatmir Velaj	D/TH	24.06.2019	49,025
7	Florika Mero	1013	08.11.2019	3,084
8	Kristaq Memo	197	02.04.2019	31,353
	Shuma			**170,043**
1	Myrteza Kokoshi	147	27.03.2020	26,925
2	Dorina Bejleri	465	01.09.2020	12,500
3	Hava Peca	610/666/755	16.10/05.11/14.12.2020	28,890
	Shuma			**68,315**
1	Hava Peca	40/66/128/134/379	22.01/04.02/04.03/11/.03/11.06	86,685
2	Hyso Veseli	294	21.05.2021	32,587
3	Mantho Memo	647	13.09.2021	6,525
	Shuma			**125,798**

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Libohovë, në vlerën **23,203,393 lekë.**
Shkaku: Mos zbatimi i akteve ligjore e nënligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga debitorët.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Sektori i Inspektimit të Territorit të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare apo vendosjen e barrës hipotekore për subjektet debitore,

si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej **23,203,393 lekë** nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Në territorin e Bashkisë Libohovë për periudhën objekt auditimi ka ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë vetëm 1 subjekt. Nga auditimi i dosjes përkatëse që administron Sektori i Inspektimit të Territorit rezulton se subjekti "Libohova Shpk" është pajisur me autorizim 5 vjeçar me afat 10.01.2019-09.01.2024 për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar [14]. Lidhur me pagesën që subjekti duhet të bëjë për pajisjen me autorizimin përkatës[15] bashkia për të lehtësuar subjektin ka nënshkruar marrëveshje për pagesën me këste të autorizimit bazuar në ligjin 9920 datë 19.05.2008, nenet 77, 77 dhe rezulton se subjekti ka paguar rregullisht këstet çdo vit.

Asetet e dhëna me qira

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira nga Bashkia Libohovë bëhet bazuar në kadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Bashkia Libohovë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi[16] për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur kontrata sezonale për dhënien me qira të kullotave apo kontrata për dhënien me qira të aseteve të tjera. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 6 muaj për kontratat e kullotave deri në 99 vjet për tokën bujqësore për mbjelljen e kulturave drufrutore. Kontratat janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor,

[14]Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 " Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe *autorizimet përkatëse*, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Neni 20-Autorizimet pika 2. "Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje". VKM nr. 344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj"

[15]VKM nr. 344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika 10 "Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera".

[16] Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

për kullota etj. Grupi i auditimit auditoi të gjitha kontratat lidhur me zbatimin e detyrimeve të qiramarrëseve për pagesën e kontratës dhe në mënyrë më të detajuar kemi si më poshtë vijon:

1. Kontrata nr. 1674 rep. 244/2 kol datë 03.06.2014 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik Vodafone Sha, me sipërfaqe – 200m^2, me afat 9 vjeçar dhe me vlerë vjetore 150,000 lekë. Nga auditimi rezulton se Vodafone Sha ka paguar detyrimet e kontratës së qirasë për periudhën 2019-2020.
2. Kontrata nr. 459/1 prot datë 01.04.2017 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik Albtelecom Sha, me sipërfaqe – 200m^2, me afat 9 vjeçar dhe me vlerë vjetore 220,000 lekë. Nga auditimi rezulton se Albtelecom Sha ka paguar detyrimet e kontratës së qirasë për periudhën 2019-2020.
3. Kontrata nr. 269 prot datë 02.03.2016 për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor në pronësi të bashkisë, personit juridik Telecom Albania, me sipërfaqe – 200m^2, me afat 9 vjeçar dhe me vlerë vjetore 300,000 lekë. Nga auditimi rezulton se Telecom Albania ka paguar detyrimet e kontratës së qirasë për periudhën 2019-2020.
4. Kontrata nr. 841 Prot, datë 11.06.2020 për dhënie në përdorim të aseteve të bashkisë me sipërfaqe 40m^2 me afat 1 vjeçar. Nga auditimi rezulton se qiramarrësi ka paguar detyrimet e qirasë ndaj bashkisë.
5. Kontratat për dhënien me qira të kullotave lidhen nga Bashkia Libohovë kryesisht me afate disa mujore. Në vitin 2019 Bashkia Libohovë ka lidhur 24 kontrata me vlerë totale 365,090 lekë ndërsa në vitin 2020 ka lidhur po ashtu 24 kontrata me vlerë totale 371,390 lekë. Për vitin 2019 rezulton se dhënia me qira e sipërfaqeve kullosore është bërë me VKB nr. 28 datë 21.03.2019 "Për miratimin e listës së fondit kullosor që do të jepet me qira për vitin 2019". Ky vendim nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me argumentimin "*Vendimi bie në kundërshtim me VKM-në nr. 443, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", ka mospërputhje midis numrit të ngastrave dhe sipërfaqes në ha sipas VKM-së sipër cituar dhe tabelës së paraqitur nga Bashkia Libohovë"*.[17] Në vijim Bashkia Libohovë ka vazhduar me procesin e dhënies me qira të ngastrave kullosore pa marrë konfirmimin nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër. Për dhënien me qira të kullotave për vitin 2019 Bashkia Libohovë ka vepruar në kundështim me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 13, pika 2 "*Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj*", si dhe ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2/a "*çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijeni nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit*". Ndërsa për vitin 2020 lidhja e kontratave është bërë pas miratimit në Këshillin Bashkiak të ngastrave që do të jepen me qira për vitin 2020[18], të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën 461/1 Prot, datë 15.05.2020. Nga auditimi rezulton se qiramarrësit e paguajnë detyrimin në momentin e lidhjes së kontratës si rezultat nuk ka debitorë lidhur me kontratat e qirave për kullotat.

Titulli i gjetjes 6: Mos zbatimi i kushteve të kontratës për sipërfaqen e marrë me qira për kultivimin e drufrutorëve.

[17] Shkresa nr. 474/1 Prot, datë 03.04.20199, Prefekti i Qarkut Gjirokastër.
[18] VKB nr. 26, datë 29.04.2020 "Për miratimin e listës të Fondit Kullosor që do të jepet me qira për vitin 2020"

Nga auditimi i regjistrit të pagesave për 11 kontratat që Bashkia Libohovë ka lidhur për dhënien me qira të tokës bujqësore për të kultivuar drufrutorë rezulton se qiramarrësi me kontratë nr. 1581, datë 02.01.2020 nuk ka paguar detyrimin e qirasë për vitin 2020 me vlerë **105,000 lekë**.
Situata: Për dhënien me qira të tokës bujqësore për të kultivuar kultura drufrutore, Bashkia Libohovë ndër vite ka të lidhura 11 kontrata me subjekte të ndryshme. Nga auditimi i regjistrit të pagesave rezulton se 10 qiramarrës kanë paguar rregullisht detyrimet e qirasë ndaj bashkisë ndërsa qiramarrësi A. K. nuk ka paguar detyrimin prej **105,000 lekë** për vitin 2020.

Tabela nr. A/20: Kontatat e lidhura nga Bashkia Libohovë për dhënien me qira të tokës bujqësore

Nr.	Emër, Mbiemër	Nj.Administrative	Nr. Kontratës	Sip. ha	Data e lidhjes së kontratës	Afati i dhënies me qira(vjet)	Vlera e Kontratës
1	E.D	Zagorie		13.29	23.10.2017	99	79,740
2	V.S	Zagorie	1677	1.4	21.11.2018	30	8,400
3	K.K	Zagorie		3.6401	21.01.2019	99	21,840
4	J.Z	Zagorie	699	3.7402	07.05.2019	99	22,440
5	A.K	Zagorie	1581	17.4937	02.01.2020	99	105,000
6	A.K	Zagorie	104	0.9798	27.01.2020	99	5,820
7	S.P	Zagorie	180	7.5800	13.02.2020	99	45,480
8	V.V	Qendër Libohovë	292	1.78775	31.07.2020	99	10,723
9	M.T	Qendër Libohovë		0.44	10.11.2020	99	2,460
10	P.M	Qendër Libohovë		2	07.12.2020	99	12,000
11	S.i	Qendër Libohovë		0.155	29.12.2020	99	930

Burimi: Bashkia Libohovë, përpunoi grupi i auditimit

Kriteret: Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.
VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", e ndryshuar.
VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".
Kontrata 1581, datë 02.01.2020.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Libohovë nga mos arkëtimi i detyrimit të qirasë në vlerën 105,000 lekë.
Shkaku: Sektori i Inspektimit të Territorit dhe Sektori i Shërbimeve Bujqësore nuk kanë ndjekur zbatimin e kushteve të kontratës.
Rëndësia: I ulët
Rekomandimi: Sektori i Inspektimit të Territorit dhe Sektori i Shërbimeve Bujqësore të marrin masa për zbatimin e kushteve të kontatës së qirasë me qëllim pagesën e detyrimit nga qiramarrësi A. K. në vlerën 105,000 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. Xh.S me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Territorit, z. F.Z, z. E.T, z. Ll.M me detyrë Specilistë në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/16, datë 06.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë

13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z. Xh.S me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Territorit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:
1. ...lidhur me marrjen e masave për të bërë të mundur arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e reja është përgjegjësi e Sektorit të Shërbimit Urban.
2.mbi kontratat e lidhura nga Bashkia Libohovë për dhënien me qira të sipërfaqeve bujqësore, detyrimi që duhet të paguajë qiramarrësi A. K. për sipërfaqen e marrë me qira në vlerën 105,000 lekë fillon në datën 13.09.2021 referuar proces verbalit të marrjes në dorëzim të sipërfaqes së përcaktuar në kontratë mbajtur më datë 13.09.2021 midis përfaqësuesve të BashkisëLibohovë z. F.Z, z. Ll.M dhe z. K.K dhe qiramarrësit A.K.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Sektori i Inspektimit të Territorit në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Urban duhet të marrin masa për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 269,996 lekë për 8 subjekte të legalizuara.
2. Sqarimet e subjektit pranohen pasi janë të mbështetura në dokumentacionin përkatës të sjellë me anë të observacioneve dhe janë reflektuar në raportin e auditimit. Përkatësisht qiramarrësi A. K. nuk është debitor për vitin 2020.

Mbi gjobat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit

Titulli i gjetjes 7: Mos ngritje e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.
Situata: Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga[19]:
a)Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore përkatëse;
b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.[20] Nga auditimi i organizimit strukturor të Bashkisë Libohovë rezulton se struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nuk është ngritur.
Në mungesë të një strukture specifike, Bashkia Libohovë me urdhër të titullarit çdo vit krijon Komisionin e Inspektimit të Territorit. Për viti 2019, Komisioni është ngritur me urdhër nr. 20, datë 29.01.2019 "Për krijimin e Komisionit të Inspektimit të Territorit" dhe për vitin 2020 është ngritur me urdhrin nr. 82, datë 3.05.2020. Urdhrat përkatës bashkëlidhur kanë edhe detyrat kryesore që duhet të kryejnë që janë detyrat që përcakton kuadri ligjor për strukturën e Inspektoratit Vendor. Për periudhën nën auditim rezulton se në vitin 2019, është konstatuar
ndërtimi i disa objekteve në fushën e Çajupit nga z. P. K. i cili ka kontratë me Bashkinë Libohovë për marrje me qira të sipërfaqes kullosore me kontratë nr. 1 Prot, datë 17.04.2018. Lidhurme këtë konstatim Bashkia Libohovë ka njoftuar Agjencinë e Zonave të Mbrojtura Gjirokastër me

[19] Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar,, neni 3.
[20] Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 4.

shkresën nr. 560 Prot, datë 18.04.2019. AZM Gjirokastër është përgjigjur me shkresën nr. 475/1 Prot, datë 13.05.2019 se, "z. *K. ka depozituar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkesëpër agroturizëm me shkresën 5973 Prot, datë 1.07.2018 dhe deri në marrjen e një përgjigje zyrtarenuk mund të merret asnjë vendim*".

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 3.

Ndikimi: Nuk kryhet kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Shkaku: Bashkia Libohovë nuk ka zbatuar detyrimet ligjore për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë në shqyrtim të gjitha mundësitë për të ngritur strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorin në Bashkinë Libohovë me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

B. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të parashikuar opinion mbi pasqyrat financiare për vitet 2019-2020.

Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazohen në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj"; Udhëzimin e MF nr. 26,datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006, dhe Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", etj., Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike; Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënnjësisë.

Për auditimin e veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike të periudhave raportuese ushtrimore 2019 dhe 2020 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

-Dokumentacioni i veprimeve me bankë për vitin 2019 dhe vitin 2020;

-Dokumentacioni i veprimeve me arkë për vitin 2019 dhe vitin 2020;

Mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabile" pjesa e parë "Rregulla të përgjithshme" kapitulli i parë "Mbajtja e kontabilitetit" dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre", ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj"dhe dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2020 janë hartuar dhe depozituar më datën 19.03.2021 në Degën e Thesarit Gjirokastër, brenda afatit ligjor.

Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.
Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.
Audituesit shtetëror do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Objektivat e auditimit: Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:
- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
- Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.
- Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si: transaksionet, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Libohovë, është realizuar në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, dhe ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare
Në fund të periudhës ushtrimore 2020 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme",
Formati 1 – Pasqyra e Pozicionit Financiar

Formati 2 – Pasqyra e Performancës Financiare
Formati 3 – Pasqyra e Flukseve Monetare (Cash Floë)
Formati 4 – Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/ Fondet Neto
Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese
Formati 6 – Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit
Formati 7/a – Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike
Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto
Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.
Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.
a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.
b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet **= 971,921,875 lekë.**

	Viti 2020	Viti 2019
AKTIVET	1,051,270,698	995,763,408
PASIVET(DETYRIMET)	79,348,823	106,564,894
AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	971,921,875	889,198,513

Burimi: Bashkia Libohovë

1.1 Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2020 paraqiten në vlerën **133,306,027 lekë** dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 44,394,557 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 12,647,664 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 68,232,062 lekë dhe "Të tjera aktive afatshkurtra" në shumën 8,031,744 lekë.

Tab nr.B/1 Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti i 2019	Diferenca 2020-2019
531	Mjete monetare ne arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	44,394,557	60,743,594	-16,349,037
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera			
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi	-	-	-
	TOTALI	**44,394,557**	**60,743,594**	**-16,349,037**

Burimi: Bashkia Libohovë

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën **44,394,557** lekë, përbëhet nga:

- Llog 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në shumën 11,116,761 lekë;
- Llog 85 "Rezultati i veprimtrisë ushtrimore" në shumën 33,277,796 lekë;

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Tab nr.B/2 Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
31	Materiale	104,783	44,901	59,882
32	Objekte inventari Inventar i imët	12,542,881	10,395,841	2,147,040
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjione për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	Totali	**12,647,664**	**10,440,742**	**2,206,922**

Burimi: Bashkia Libohovë

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Libohovë në 31.12.2020 paraqitet në vlerën **12,647,664 lekë** dhe përbëhet nga:

- Llogaria kontabël 31 për shumën 104,783 lekë;
- Llogaria kontabel 32 për shumën 12,542,881 lekë;
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,206,922 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 në shumën 2,206,922 lekë.

- **Llogaria 312 "Materiale"** ka vlerën 104,783 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2020	44,901
Hyrjet në magazinë gjatë vitit	6,975,569
Dalje nga magazina gjatë vitit	6,915,687
Gjendja në 31.12.2020	**104,783**

Burimi: Bashkia Libohovë

- **Llogaria 327 "Objekte inventari"** ka vlerën 12,542,881 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	10,395,841
Hyrje gjatë vitit 2020	3,236,220
Dalje gjatë vitit 2020	1,089,180
Gjendja në 31.12.2020	**12,542,881**

Burimi: Bashkia Libohovë

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Libohovë ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit Nr. 141 datë

23.12.2020 për "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik dhe vlerësimit për vitin 2020" dhe Nr. 142 datë 23.12.2020 për "Për ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2020", ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve.
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Tab nr.B/3 Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
466	Kreditorë për mjete në ruajtje			
468	Debitorë te ndryshëm	35,194,686	33,423,800	1,770,886
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	33,037,376	51,683,012	-18,645,636
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)	0	0	
	Totali	**68,232,062**	**85,106,812**	**-16,874,750**
	Të tjera aktive afatshkurtra	**0**	**0**	
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	8,031,744	21,380,342	-13,348,598
	Totali	**8,031,744**	**21,380,342**	**-13,348,598**

Burimi: Bashkia Libohovë

- **Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"** në fund të vitit 2020 është në vlerën 35,194,686 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepricën e vitit 2019 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 35,194,686 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	33,423,800
Shtesa gjatë vitit 2020 debitoret e taksave	1,779,886
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	9,000
Gjendja në 31.12.2020	35,194,686

Burimi: Bashkia Libohovë

Gjatë evidentimit të llogarive analitike janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2019 dhe 2020 debitorët për taksat dhe tarifat vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Libohovë, janë evidentuar detyrimet për vitet 2019 dhe 2020, detyrime të cilat paraqitet si më poshtë vijon:

Debitore Bashkia Libohovë dhe NJA	Gjendja 31.12.2019	Gjendja 31.12.2020
Debitore Biznes i Madh	299,593	299,593
Debitore Biznes i Vogel	5,946,712	5,838,557

Debitore nga Taksa e tokes bujqesore	8,569,166	8,726,276
Debitore nga Taksat e familjes	7,123,838	8,174,769
Totali	21,939,309	23,039,195

Burimi:Bashkia Libohovë

Ky veprim është kryer në përputhje me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" ku citohet:
"Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:
- Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.
- Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.

Të drejtat. Funksionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohen (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).
Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).
Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë:
a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:
- **Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit**);
- Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);
- **Kreditohet klasa 7 me analiza**;
- Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).

b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:
- Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;
- Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.

c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:
- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;
- Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)"

- **Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)",** në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 33,037,376 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 33,037,376 lekë. Vlera prej 33,037,376 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	51,683,012
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	18,645,636
Gjendja në 31.12.2020	**33,037,376**

Burimi: Bashkia Libohovë

Në mënyrë analitike paraqitet:

401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	50,808
42	Detyrime ndaj personelit	3,367,782

431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	177,654
435	Sigurime Shoqerore	1,038,103
436	Sigurime Shendetsore	138,260
437,438,	Organizma te tjere shteterore	0
467	Kreditore te ndryshem	28,264,769
TOTALI		**33,037,376**

Burimi: Bashkia Libohovë

- **Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"** në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 8,031,744 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	21,380,342
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	7,819,344
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	21,167,942
Gjendja në 31.12.2020	**8,031,744**

Burimi: Bashkia Libohovë

Vlera e kësaj llogarie në shumën **8,031,744 lekë,** përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2020 ka patur një pakësim të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyrë detyrimeve.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Shenzime gjyqësore	150,000
Shpenzime operative	448,648
Shpenzime për investime	12,749,950
Totali	**13,348,598**

Burimi: Bashkia Libohovë

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo invetime të kryera por të pafinancuara".
Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t'u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

1.2 Aktivet afatgjata

Mbi Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)
Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale" në vlerën prej **6,607,370 lekë** përbëhen nga:
- Llog.202 "Studime dhe kërkime", në vlerën 6,607,370 lekë.
  Sipas llogarisë analitike (Tabela nr.B/4) vlera e kësaj llogarie është 6,654,870 lekë.
  (-47,500) lekë.
  Diferenca 47,500 lekë (6,654,870- 6,607,370) është vlera e amortizimit të AAJM.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	6,627,810

Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	175,200
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	148,140
Gjendja në 31.12.2020 (D)	**6,654,870**

Burimi: Bashkia Libohovë

Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën neto 6,607,370 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 "*Studime e kërkime*" e cila është dhënë në mënyrë analitike si mëposhtë. Nga verifikimi i të dhënave analitike të llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", konstatohet se vlera e studimeve dhe projektimeve i përkasin objekteve ende të papërfunduara, duke siguruar vlerësimin real të llogarisë 202 dhe AAJM. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara".

Tab nr.B/4 Analitikisht llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" paraqitet si më poshtë;

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vl.Kontabël	Viti i ndërtimit
1	Studim Projektimi (Rik. I murit te jashtem Zyrave Njeisa Zagorie	Copë	1	16,000	2015
2	VNM Rikonstruksion Rruga Autostrada-Fshati Bulo	Copë	1	35,600	2016
3	Pr "Rik Shkolles Nepravishte"	Copë	1	100,000	
4	Pr "Rik Rruges Nepravishte"	Copë	1	100,000	
5	Pr "Rik Se Qendres se Fsh Nep"	Copë	1	398,000	
6	Pr "Gjelberim Shk Nep"	Copë	1	22,200	
7	Pr "Gjelberim Lab Poshtme"	Copë	1	22,200	
8	Oponencë teknike për objektin " Rikonstruksion I rrjetit të ujësjellësit Libohovë".	Copë	1	262,325	2019
9	Vlere Tjeter	Copë	1	5,645,745	
10	Hartim projekti "Rikonstruksioni I ujesjellesit Suhe"	Copë	1	52,800	2021
	Totali			6,654,870	

Burimi:Bashkia Libohovë

Titulli i gjetjes 8: Mungesa e një regjistri kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale

Situata : Për llogaritë e AAJM, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të detajohet me të dhëna në mënyrë analitike, si: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia. Mungesa e inventarizimit të të gjithë AAJM vë në pah mangësi në elementët e përmbajtjes së disa rregjistrave të aktiveve afatgjata jo materiale mbi përllogaritjen progresive të amortizimit individual për secilin aktiv të llogarisë 200 si llogaritë analitike 202, llog 212, llog 213, llog 214, llog 215 dhe llog 218".

Kriteri: UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36. Ligji nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe103

Ndikimi/Efekti: Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë inventarizimin e përvitshëm të tyre, sjell mos pasqyrim të saktë të këtyre vlerave, si rrjedhojë e

mungesës së informacionit në mënyrë analitike, për secilin aset si pasojë e mungesës së një regjistri kontabël.
Shkaku: Mosnjohje e legjislacionit dhe moszbatim i udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohove dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:
-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 "Toka, troje terrene", 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", 212 "Ndërtime e konstruksione" 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe "215 "Mjete transporti", si dhe për ngritjen e komisioneve të posaçme për asgjësimin e aktiveve.

Për këtë klasifikim mban përgjegjësi Titullari i Bashkisë Libohovë dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, znj. E.Ç.

Mbi Aktive afatgjata financiare

Testet substanciale
Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2019 dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 76,399,726 lekë Ky seksion i bilancit kontabël 2019 dhe 2020 është paraqitur në vlerën 76,399,726 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**76,399,726**	**76,399,726**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie	0	0
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	**76,399,726**	**76,399,726**

Burimi:Bashkia Libohovë

Bashkia Libohovë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesmarrëse me 100% të Ujësjellës Kanalizime Libohovë Sh.a me NUIS përkatëse K43522601F.
Vlera aksionare që Bashkia Libohovë zotëron në Ujësjellës Kanalizime Libohovë Sh.a prej 76,399,726 lekë, e cila është shoqëri aksionere me objekt "Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit/eve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit,largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura,shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre"
Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesmarrjë të Bashkisë Libohovë në "Ujësjellës Kanalizime Libohovë Sh.a " paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në **llogarinë 26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta"** në zbatim të urdhrit e

ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitett\it nr.28 "Investime në Pjesmarrje" pika 35 ku citohet **"**Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investorit në përputhje me paragrafet 37-42 te SNK 27 e cila thotë:

Kur përgatiten pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht dhe në sipërmarrjet që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten ose:

(a) me kosto, ose

(b) në përputhje me SNK 39.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **76,399,726 lekë** dhe investori është Bashkia Libohovë

Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

- **Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale",** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2020, paraqiten në shumën 774,609,262 lekë. Në vitin paraardhës 2019, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 735,111,881 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 39,497,381 lekë.

Tab nr.B/5 Paraqitja në Bilanc e llogarisë 21

Nr	Llogaria	Emërtimi	Gjendje më 31.12.2019	Shtesa 2020	Pakësime 2020	Gjendje më 31.12.2020
1	210	Toka,troje,Terene	-	-	-	-
2	211	Pyje,Kullota Plantacione	-	-	-	-
3	212	Ndertime e Konstruksione	263,990,671	2,329,785	-	266,320,456
4	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	444,469,642	36,363,996	-	480,833,638
5	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	8,193,893	-	-	8,193,893
6	215	Mjete transporti	5,033,933	-	-	5,033,933
7	216	Rezerva shtetrore	-	-	-	-
8	217	Kafshe pune e prodhimi	-	-	-	-
9	218	Inventar ekonomik	13,423,742	803,600	-	14,227,342
10	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	-	-	-	-
11	28	Caktime	-	-	-	-
		TOTALI	**735,111,881**	**39,497,381**	**-**	**774,609,262**

Burimi: Bashkia Dropull

Titulli i gjetjes 9: Mbi kontabilizimin e Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.

Situata: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020 rezultoi se llogaria. 210 "Toka, Troje, Terrene" është në vlerën 0 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik. Llogaria 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet e pandryshuar prej 0 lekë dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme , për të cilën nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik. Llogaria e aktivit 212 " Ndërtesa dhe konstruksione" cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë Libohovë, në fund të vitit 2019 rezulton me një kosto historike 296,753,545 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike 299,205,950 lekë, llogari këto për të cilat rregjistrimi në kontabilitet është bërë pa dokumentacion justifikes. Ky fenomen ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.

Lista me kosto historike e ndërtesave paraqitet në aneksin nr.4;

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", ku cilësohet:
"1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtrin të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.
2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen".
VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive".
Ndikimi/Efekti: Mungesa e titujve të pronësisë për pasqyrimin e aktiveve në Pasqyrat financiare, sjellë rregjistrim pa dokumentacion justifikues të rezultatit financiar.
Shkaku: Mungesa e inventarizimit dhe regjistrimit në ASHK të pasurive të njësisë vendore, si toka, troje,terrene, pyje, kullota, plantacione, ka sjellë mos pasqyrimin në pasqyrat financiare të njësisë vendore për vitin 2019 dhe 2020, duke bërë që këto pasqyra të mos paraqesin vlerën e saktë të këtyre aseteve të njësisë vendore.
Nga ballafaqimi problematikës gjatë procesit të auditimit në terren, ndërmjet evdientimit të objekteve ndërtesa e kontratusione që pasqyronte DPZHT me ato që pasqyronte në kontabilitet nga Drejtoria e Finacës ka rezultuar se nuk janë ndërmarrë procedura të mëtejshme për rivlerësim për shkak të kostos që kërkon kryerja e këtij shërbimi.
Rëndësia: e lartë
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimit të aseteve të marr masa për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat "Toka, Troje, Terrene,Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Specialisti i buxhetit dhe menaxhimit të Aseteve znj J.M dhe znj. BP.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/17, datë 01.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. J.M, me detyrë specialiste në sektorin e financës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
Detyrat funksionale të punonjëses znj. J. Me. në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar lidhen me veprimet me pagat, sigurimet, PAK, kontabilizimi i shpenzimevedhe ndjekja e zbatimit të buxhetit.

<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
Pretendimi i subjektit pranohet pasi është i bazuar në dokumentacionin/shkresës nr.111 Prot, datë 27.09.2016 "Caktimi i detyrave të specialistit të Finances znj.JM", të sjellë me anë të observacioneve nga Përgjegjësi i zyrës së Financës.

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Libohovë më datë 31.12.2020 në shumën 11,021,440 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm është njësoj në vlerën 11,021,440 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	11,021,440
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
Gjendja në 31.12.2020 (D)	**11,021,440**

Burimi: Bashkia Libohovë

Tab nr.B/6 Llogaria analitike 215 e bilancit

Nr	Emertimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera kontabël
1	Autoveture Benz Mercedez	copë	1	1,188,000	1,188,000
2	Autoveture Hunday Terracan	copë	1	778,800	778,800
3	Autoveture Audi A6	copë	1	997,300	997,300
4	Autoveture Benz	copë	1	720,000	720,000
5	Traktor T-28	copë	1	167,100	167,100
6	Rimorkio Metalike	copë	1	111,000	111,000
7	Motokultivator komplet	copë	1	86,100	86,100
8	Rimorkio motokultivatori	copë	1	37,140	37,140
9	Kamion TIP 814	copë	1	1,728,000	1,728,000
10	ŴolkŴagen (Azile)	copë	1	1,440,000	1,440,000
11	Iveko Magerus ëJMBIEG8MO411275	copë	1	3,768,000	3,768,000
	TOTALI				**11,021,440**

Burimi: Bashkia Libohovë

- **Llogaria kontabël 218 "Iventar ekonomik"** përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njesitë administrative, institucionet e Bashkisë Libohovë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Libohovë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2020 paraqitet në vlerën 14,227,342 lekë dhe kosto historike 24,846,422 lekë. Krahasuar me vitin 2019 llogaria 218 "Iventari ekonomik" është rritur për vlerën 1,019,950 lekë, nga vlera 13,423,742 lekë dhe kosto historike 23,826,472 lekë. Ky veprim ka ardhur si rezultat i shtesave me pagesë për blerje të pajisjeve kompjuterike dhe shtesave pa pagesë për pajisje të dhuruara gjatë vitit 2020.

Levizjet Llog. 218 "Inventar ekonomik" për vitin 2020, vlera	
Çelje me 01.01.2020	23,826,472
Blerje me pagesë (D)	1,019,950
Dalje (K)	0
Amortizimi i vitit i akumuluar 2020	10,619,080
Gjendja me 31.12.2020 (D) Teprica Neto	14,227,342

Burimi: Bashkia Libohovë

Titulli i gjetjes 10: Mbi sistemimin e normave të amortizimit të llogarisë 218 "Inventar ekonomik"

Situata: Gjatë kontrollit të përllogaritjes së amortizimit të akumuluar vjetor evidentohet se ky zë duhet ta ketë në vlerën 203,990 lekë ndërsa sipas amortizimit në kontabilitet dhe analizës në regjistrin e aktivit paraqitet 216,350 lekë duke përdorur normë amortizimi 22% dhe jo 20%, pra janë ngarkuar padrejtësisht **12,360 lekë** për vitin 2020 dhe për vitin 2019 janë ngarkuar padrejtësisht për shumën **8,045 lekë.**

Kriteri: UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet " Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara".

Ndikim/Efekti: Mbivlerësim i llogarisë të amortizimit dhe nënvlerësim i llog 218

Shkaku: Neglizhim i legjislacionit

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryej sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 218 Inventari ekonomik, respektivisht në vlerën 12,360 lekë për vitin 2020 dhe 8,045 lekë për vitin 2019.

Për këtë veprim mban përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, znj. E.Ç

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/18, datë 02.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. E.Ç me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

Ju bëj me dije se në llogarinë 218 "Inventar ekonomik" më 31.12.2020 në vlerën prej 24,846,422 lekë përfshihen edhe pajisjet kompjuterike, për të cilat norma e amortizimit është në masën 25% referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Në këtë mënyrë, vlera e rritur e amortizimit të akumuluar më 31.12.2020 prej 12,360 lekë, si dhe vlera prej 8,045 lekë më 31.12.2019 i përkasin llogaritjeve sipas normave të përcaktuara në pikën 36 të këtij Udhëzimi.

<u>Oëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

Mbi bazë grupimi zëri i amortizimit për pajisjet kompjuterike përllogaritet veçmas, ndërkohë që panvarësisht përfshirjes në llog 218, kjo e fundit finalisht vlerësohet në terma të amortizimit vetëm me normën 20 %. Si e tillë pretendimi juaj nuk pranohet.

- **Llogaria 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Libohovë në fund të vitit 2020, paraqitet në vlerën 204,686,954.1 lekë. Krahasuar me vitin 2019 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej (2,252,865) lekë, shtesa e cila ka ardhur si rezultat:

Tab nr.B/7 Pasqyra statistikore nr. 7.b "Akivet afatgjata me vlerë neto"

Nr. Rrjesht	Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		ksimet gjate vi		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike		Kosto Historike		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	6,627,810	47,500	6,580,310	175,200	0	148,140	0	6,654,870	47,500	6,607,370
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	6,627,810	47,500	6,580,310	175,200		148,140		6,654,870	47,500	6,607,370
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	937,498,470	202,386,589	735,111,881	41,750,246	2,252,865	0	0	979,248,716	204,639,454	774,609,262
6	210	Toka,troje,Terene			0					0	0	0
7	211	Pyje,Kullota Plantacione			0					0	0	0
8	212	Ndertime e Konstruksione	296,753,545	32,762,874	263,990,671	2,452,405	122,620			299,205,950	32,885,494	266,320,456
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	593,464,368	148994726	444,469,642	38,277,891	1,913,895			631,742,259	150,908,621	480,833,638
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	12,432,645	4238752	8,193,893					12,432,645	4,238,752	8,193,893
11	215	Mjete transporti	11,021,440	5987507	5,033,933					11,021,440	5,987,507	5,033,933
12	216	Rezerva shtetrore			0					0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi			0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	23,826,472	10402730	13,423,742	1,019,950	216,350			24,846,422	10,619,080	14,227,342
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0					0	0	0
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		TO TA L I (I + II)	944,126,280	202,434,089	741,692,191	41,925,446	2,252,865	148,140	0	985,903,586	204,686,954	781,216,632

Burimi: Bashkia Libohovë

Duke përjashtuar vetëm deformimin mbi llogaritjen e amortizimit për vitin 2019 dhe 2020 të llog 2018 "Inventar Ekonomik" respektivisht për shumën 12,360 lekë për vitin 2020 dhe 8,045 lekë për vitin 2019, përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Libohovë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Mbi Investimet

- **Llogaria 230 dhe 231"Investime**" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2020, paraqiten në vlerën 60,348,313 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 60,348,313 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0
2	Aktive Aftagjata materiale	60,348,313
3	**Totali**	**60,348,313**

Burimi: Bashkia Libohovë

Për investimet e kryera gjatë vitit 2020, është debituar llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4 në shumën 86,903,115 lekë. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata". Në mëyra analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në aneks.

1.3 PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

- **Llogaritë e klasës 4,** në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Libohovë më 31.12.2020, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2020	Viti 2019	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	50,808	536,936	-486,128
42	Detyrime ndaj personelit	3,367,782	3,321,038	46,744
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	177,654	169,976	7,678
435	Sigurime Shoqerore	1,038,103	1,022,552	15,551
436	Sigurime Shendetsore	138,260	135,950	2,310
437,438,	Organizma te tjere shteterore	0	0	0
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	11,116,761	21,458,082	-10,341,321
467	Kreditore te ndryshem	28,264,769	46,496,560.34	-18,231,791.34
4341	Operacione me shtetin(detyrime	35,194,686	33,423,800	1,770,886
	Gjendja më fund të periudhës	44,154,137	73,141,094.34	-28,986,957.34

Burimi: Bashkia Libohovë

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to",** në fund të vitit 2020 është në vlerën 50,808 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Libohovë më 31.12.2020. Lëvizja e llogarise 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"	
Celje e vitit 2020	536,936
Shtesa (K)	50,808
Pakësime (D)	536,936
Gjendja në 31.12.2020 (K)	**50,808**

Burimi: Bashkia Libohovë

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën **50,808** lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

- **Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit",** sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Libohovë, paraqitet në vlerën 3,367,782 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t'u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

- **Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa",** paraqitet në vlerën 177,654 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për periudhat e kaluara si dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2020 të cilat do të paguhen në periudhën pasardhëse.

- **Llogaria 435, "Sigurime shoqërore"** dhe **llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2020 si dhe detyrimet e viteve të kaluara përkatësisht në vlerat 1,038,103 lekë dhe 1,022,552 lekë.

Titulli i gjetjes 11: Mbivlerësim i llogarisë 466 Kreditore për mjete nën ruajtje

- **Situata :** Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Libohovë, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 11,116,761 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 11,116,761 lekë.

Llog. 466 "Kredirorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2020	**21,458,082**
Shtesa	4,487,160
Pakësime	14,828,481
Gjendja në 31.12.2020	**11,116,761**

Burimi: Bashkia Libohovë

Kjo shumë është e njëjtë me terpicën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520.
Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit.
Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe janë të trashëguara dhe janë të objekteve të përfunduar, për të cilën është mbajtur kjo garanci dhe është marrë në dorëzim, sipas vitit përkatës, paraqiten si më poshtë:

ANALITIKUT TË LLOGARISË 466 KREDITORE PER MJETE NE RUAJTJE			
Nr	**Objekti**	**Subjekti**	**Vlera**
1	**Gjendje me 01.01.2020**		**21,458,082**
2	**Kreditime gjate 2020**		**4,487,160**
	Rikonstruksion I ujesjellesit te fshatit Bulo	C. SHPK	24,000
	Rikonstruksion I vatrave te kultres Zagorie	F. SHPK	46,827
	Rikonstruksion I rrjetit te jashtemte ujesjellesit Libohove dhe Suhe	6D – P. SHPK	57,527
	Sistemim I kanalizimeve te ujerave te zeza te fshatit Drino	C. SHPK	29,518
	Rikonstruksion I hyrjes se godines se Bashkise	A. L.	25,800
	Rikonstruksion I rrjetit te ujesjellesit te qytetit Libohove	ED K.	2,983,406
	Rikonstruksion i rrjetit të ndriçimit publik në lagjet Hoxhallarë dhe Çuprel, Libohovë	C. SHPK	24,600
	Rehabilitimi I skemes ujitese te Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushe Nepravishte	2T	965,463
	Mirembajtje e kanaleve kulluese	C. SHPK	121,890
	Rikonstruksion I murit mbajtes te shkolles 9-vjecare Labove e Poshtme	C. SHPK	35,113
	Rikonstruksion I murit te varrezave Libohove	T-D SHPK	36,016
	Pullat e gjendjes civile		137,000
3	**Debitime gjate 2020**		**14,828,481**
	Rikualifikimi urban I qendres se qytetit Libohove	A. K.	5,600,723
	Rikonstruksioni I qendres se fshatit Sheper	T-D SHPK	92,316
	Blerje automjet dhe pajisje zjarrfikese	S. 32	188,400
	Likuidim pjesor i "Rikonstruksion dhe ndertim palestre ne shkollen 9-vjecare'Avni Rustemi', Libohove"	E. C.	2,930,845
	Rehabilitim si dhe rikonstruksion I rruges 'Kthesa e Laboves - Labove e Kryqit'	G.P.G C.	5,874,197
	Pullat e gjendjes civile		142,000
4	**Gjendje me 31.12.2020**		**11,116,761**

Burimi: Bashkia Libohovë

Përfundimisht për vitin 2020 Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 11,116,761 lekë, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.
Kriteri: Ligjin nr. 28/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10" ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" seksioni "Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 " Kreditorë për mjete në ruajtje".
Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", gjendje kjo e mbi vlerësuar për 11,116,761 lekë
Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara", Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare".
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga Bashkia Libohovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" për vlerën 11,116,761 lekë duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
- Nëse subjektet nuk janë të interesuar për tërheqjen e këtyre shumave, vlerat e mbetura të kalojnë si e ardhur Bashkisë Libohovë.

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, znj. E.Ç.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/18, datë 02.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. E.Ç me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
Lidhur me gjetjen e mësipërme, sqaroj se në vlerën prej 11,116,761 lekë të kontabilizuar më 31.12.2020 në llogarinë 466 përfshihet edhe vlera e kredituar gjatë vitit ushtrimor 2020 prej 4,487,160 lekë, për objekte të cilat nuk kanë përfunduar afatin e garancisë së punimeve prej 1 vit. Diferenca tjetër në këtë vlerë rezulton të jetë e mbartur nga bilancet e ish komunave për të cilat nuk u gjet informacion gjatë procesit të bashkimit të njësive.

<u>Oëndrimi i Grupit të auditimit:</u>
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Pretendimi juaj mbi vlerën e saktë të garancive të përfunduara si shkak i marrjes në dorrëzim të objekteve dhe përfundimit të kontratës merrët në konsideratë për vlerën 6,629,601 lekë dhe pasqyrohet në Raportin e Auditimit.
2. Mbi gjendjen nga ish Komunat është detyrë e strukturës të njoftoj subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë.

Titulli i gjetjes 12: Mbi Llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm"

Situata: Për llog 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e palikuiduara, vendime gjyqësore, investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 28,264,769 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2020	46,496,560.34
Shtesa gjatë vitit 2020 (d)	7.728.106
Pakësime gjatë vitit 2020 (k)	25.959.897.34
Gjendja në 31.12.2020	**28,264,769**

Burimi: Bashkia Libohovë

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Libohovë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2020, por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019 dhe të likujduara në 2021, por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020, si mëposhtë:

Faturat e paregjistruara për vitin 2019

INVOICE_ID	PERSHKRIMI_FATURES	EC_ACCOUNT	EC_ACCOUNT_DESCRIPTION	PROJECT_DESCRIPTION	FURNITORI	SHUMA	DATA_FURNITORIT	DATA_URDHER_SHPENZIMIT
4444410	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Mbikëqyrje dhe kolaudim projekt	ARENA MK	370,869	10-Dec-19	10-DEC-2020
4334210	2116001 Bashkia Libo	2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Mbikëqyrje dhe kolaudim projekt	Asim Çako	43,183	05-Nov-19	03-AUG-2020
4456827	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Supervizim-kolaudime	"DRICONS"	14,760	09-Jan-17	17-DEC-2020
4380319	2116001 Bashkia Libo	2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Mbikëqyrje dhe kolaudim projekt	STUDIO REA-G	10,560	01-Dec-19	24-SEP-2020
4431304	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Rikonstruksion i rrjetit të ndriçim	COGREN	492,000	20-Dec-19	26-NOV-2020
4193908	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Mbikëqyrje dhe kolaudim projekt	STUDIO REA-G	25,312	31-Oct-19	05-FEB-2020
4193926	2116001 Bashkia Libo	2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Rikonstruksioni i ujësjellësit tëfsh	COGREN	480,000	13-Nov-19	05-FEB-2020
4431366	2116001 Bashkia Libo	2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Mbikëqyrje dhe kolaudim projekt	STUDIO REA-G	9,139	29-Dec-19	26-NOV-2020
4456790	2116001 Bashkia Libo	2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Supervizim-kolaudime	"DRICONS"	25,440	09-Jan-17	17-DEC-2020
4193882	2116001 Bashkia Libo	2312104	Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa soc	Rikonstruksion I vatrave te kult	FLONJA	936,556	02-Dec-19	05-FEB-2020
4380296	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Mbikëqyrje dhe kolaudim projekt	ANTONETA CAKO	3,798	16-Nov-19	24-SEP-2020
4193900	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm	6D - PLAN	1,150,550	31-Oct-19	05-FEB-2020
4198473	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Sistemim i kanalizimeve të ujërav	COGREN	590,363	14-Oct-19	11-FEB-2020
4456804	2116001 Bashkia Libo	2312103	Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shk	Supervizim-kolaudime	"DRICONS"	8,520	09-Jan-17	17-DEC-2020
						4,161,050		

Burimi : Sistemi SIFQ

Faturat e paregjistruara për vitin 2020

INVOICE_I	PERSHKRIMI_FATU	EC_ACCOUNT	EC_ACCOUNT_DESCRIPTION	PROJECT_DESCRIPTION	FURNITORI	SHUMA	DATA_FURNITORIT	DATA_URDHER_SHPENZIMIT	GL_DATE	DATA_REGJISTRIMIT	DATA_EKZEKUTIMIT
4525692	2116001 Bashkia Libo	2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksio	Supervizim-kolaudime	GAQE MEÇI	106,000	20-May-19	18-Mar-21	18-Mar-21	18/03/2021	19/03/2021
						106,000					

Burimi : Sistemi SIFQ

Kriteri: Ligji 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, Ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhër nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare".

Ndikimi/Efekti: Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" të detyrimeve për faturat e likujduara në 2020, por me kompetencë vitin 2019, si dhe të likujduara në 2021 dhe me kompetencë të vitit 2020, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me **4,161,050 lekë** dhe detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me **106,000 lekë**.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara", Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare", ku përcaktohet qartë së detyrimet njihen në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Titullari i Bashkisë Libohovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" detyrimet për faturat e likujduara **4,161,050 lekë** për vitin 2019 dhe **106,000 lekë** për vitin 2020. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, znj. EÇ.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/18, datë 02.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. E.Ç. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
Lidhur me gjetjen e mësipërme, referuar listave analitike të kreditorëve, të cilat gjenden bashkëlidhur Pasqyrave Financiare të viteve 2019 dhe 2020, rezulton të jenë evidentuar të gjitha faturat e palikuidura deri më 31.12.2019 dhe deri më 31.12.2020, të cilat janë likuiduar në vitin pasardhës. Konkretisht, faturat të cilat i përkasin vitit 2019 dhe janë likuiduar gjatë vitit 2020, si materiali në observacion ...

<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Pretendimi juaj nuk qëndron pasi nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2020, por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019 dhe të likujduara në 2021, por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020, pagesa të cilat mund të jenë raportuar në vazhdimësi nga ju, por për periudhën specifike nuk janë njohur si të tilla.

- **Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit",** paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 33,277,796 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Libohovë trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

2. <u>Pasqyra e Performancës financiare (F2)</u>
-Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Libohovë më datë 31.12.2020 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Gjirokastër, konkretisht:

Tab nr.B/8 Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Dif
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	10,762,182	Akt rakordimi me Degën e Thesarit	10,762,182	0
Granti nga buxheti	104,336,032	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	104,336,032	0
Financim i pritshëm nga buxheti	33,037,376	Sipas llogarisë 7206	33,037,376	0
Totali të ardhurave	**148,135,590**	**Totali të ardhura**	**148,135,590**	

Burimi: Bashkia Libohovë

Tab nr.B/9 Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2019	Detyrime të vitit 2020	Sipas Pasyrës së Performancës
600	48,808,106			48,808,106
601	8,119,788			8,119,788
602	25,844,631	25,434,191	20,438,093	25,844,631
604	1,499,745			1,499,745
606	29,365,226			29,365,226
63				-2,206,922
Totali	**113,637,496**			**111,430,574**

Burimi: Bashkia Libohovë

-Diferenca në shumën 2,206,922 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca e vlerës prej 2,206,922 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 “shpenzimet” dhe klasës 7 “të ardhurat”, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	10,762,182	10,762,182	0
II	Shpenzime	111,430,574	113,637,496	2,206,922
III	Rezultati i vitit ushtrimor	33,277,796		
IV	**Rezultati i vitit ushtrimor**	33,277,796		

Burimi: Bashkia Libohovë

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **33,277,796** lekë, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

3. Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2020.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	-17,464,953	1,762,396
II	Veprimtaritë e investimeve	3,566,925	-5,861,007

III	Transferta e të tjera	-2,451,009	-96,280
IV	Teperica në fillim të vitit ushtrimor	60,743,594	64,938,485
V	**Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor**	**44,394,557**	**60,743,594**

Burimi: Bashkia Libohovë

-Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2020, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **44,394,557** lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën **44,394,557** lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare".

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Referenc	E M Ë R T I M I	Fonde bazë dhe Grante Kapitale	Fonde të tjera të veta	Rezultatet e Mbartura Teprioc/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Teprioc/Deficit	GJITHËSEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
101	**I.AKTIVET NETO/FONDET NETO**	**806,902,897**				**806,902,897**
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	**82,295,616**	**10,160,054**	**39,285,512**	**33,277,796**	**165,018,978**
	1.NGA BURIME TE BRENDSHME	**82,295,616**	**10,160,054**	**39,285,512**	**33,277,796**	**165,018,978**
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)		**10,160,054**			**10,160,054**
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)					
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	43,010,104		39,285,512		**82,295,616**
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	39,285,512			33,277,796	**72,563,308**
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)					
1015	Nga nxjerrjet jashteperdorimit dhe demtimet(-)					
	TOTALI	**889,198,513**	**10,160,054**	**39,285,512**	**33,277,796**	**971,921,875**

Burimi: Bashkia Libohovë

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **971,921,875 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.
-Vlera prej 82,723,362 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".
-Vlera prej 33,277,796 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85 dhe llog. 12.
-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **971,921,875 lekë** kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".
Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

C. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" për periudhën 2019-2020.

Referuar raportit të auditimit më të fundit zhvilluar nga KLSH dhe Vendim të Kryetarit të Kontrolli të Lartë të Shtetit Nr.82, datë 25.09.2019 grupi i auditimit ka shqyrtuar prokurimet e zhvilluara 6-mujorin e parë të vitit 2019 dhe është shprehur me opinion mbi këto procedura. Si e tillë, për të realizuar saktësisht programin aktual të auditimit nr.871/1 datë 03.09.2021 janë shqyrtuar për auditim procedurat e prokurimit të zhvilluara 6-mujorin e dytë të vitit 2019 dhe ato të vitit 2020. Në formë tabelarë si mëposhtë, po pasqyrojmë rastet e prcedurave të prokurimit të zhvilluara si dhe pesha financiare e procedurave të përzgjedhura për auditim.

Periudha	Lloji i procedurave	Fondi Limit	Nr. i procedurave	Vlera e kontratës
Viti 2019	Kërkesë Për Propozim	11,872,179.33	5	8,067,691.00
	Blerje Të Vogla	8,496,500.24	32	6,912,421.14
	Blerje E Hapur	30,916,666.70	1	30,260,737.50
	Totali	51,285,346.27	38	45,240,849.64
	Të Paauditurara Për Periudhën	46,037,643.07		
	Të Perzgjedhura Për Auditim	32,995,999.70	2	32,292,237.50
	Në % fondi i prokurimeve të audituara	**72%**		
Viti 2020	Kërkesë Për Propozim	11,419,980.16	6	7,000,449.00
	Blerje Të Vogla	7,056,600.58	29	5,768,028.67
	Blerje E Madhe	264,733,113.60	1	263,946,164.00
	Negocim Pa Shpallje	250,000.00	1	245,833.00
	Totali	283,459,694.34	38	276,960,474.67
	Të Perzgjedhura Për Auditim	269,810,461.10	3	268,518,167.00
	Në % fondi i prokrimeve të audituara	**95.2%**		

1) Auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në procedurën e prokurimit: "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019".

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "<u>Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë</u>", REF-34742-09-02-2019</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 41 prot, datë 28.08.2019
Njësia e prokurimit, Urdhër nr. 33, datë 26.02.2019:
1.J.R
2.K.K
3.I.K</td><td rowspan="2">3. Urdhër i brendshëm për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.
Specifikimet teknike janë hartuar nga NJP
Llogaritja e fondit limit është bërë nga shoqëria projektuese "I.-18" Shpk</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, Urdhër nr. 32, datë 26.02.2019 me përbërje:
1.B.P
2. F.M
3. E.L</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Kërkesë për propozim"</td></tr>
</table>

5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,079,333 lekë pa tvsh	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** Shoqëria "C." shpk mevlerë oferte 2,031,500 lekë pa Tvsh	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 47,833 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit 16.09.2019	**9. Burimi Financimit nga** Buxheti i Bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** 1. OE "C." shpk me vlerë oferte 2,031,500 lekë pa tvsh; 2.OE "S." Shpk me ofertë ekonomike 1,569,660 lekë pa tvsh; 3.OE "N. 86" Shpk me ofertë ekonomike 1,704,350 lekë pa tvsh; 4.OE "M." Shpk me ofertë ekonomike 1,818,740 lekë pa tvsh.
11. Ankimime Pranë AK-Po 1. OE "M." Shpk më datë 25.09.2019; 2. OE "S." Shpk datë 26.09.2019; **Ankimime pranë KPP**-Po	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Po	**13. Përgjigje Ankesës** nga KKP Po
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata me nr. 2009 Prot, datë 10.12.2019 midis Bashkisë Libohovë dhe Operatorit Ekonomik "C." Shpk, me vlerë kontrate 2,437,800 lekë me Tvsh, me afat 7 javë.	**Zbatimi i kontratës:**	

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.
Nga auditimi i dosjes fizike të prokurimit si dhe në sistemin elektronik për procedurën **"**Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019**"** rezulton se: Titullari i Autoritetit Kontraktor në fillim të vitit 2019 ka ngritur Njësinë e Prokurimit me Urdhrin nr. 33, datë 26.02.2019, e përbërë nga: z. J. R., z. K. K. dhe z. I. K.. Për procedurën eprokurimit "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese për vitin 2019", titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin eProkurimit nr. 41, datë 28.08.2019, i konfirmuar nga Dega e Thesarit, ku ngarkohet NJP të kryejëprokurimin e fondit limit me vlerë 2,079,333 lekë pa tvsh. Llogaritja e fondit limit është bërë ngashoqëria projektuese "I.-18" Shpk, e cila ka llogaritur fondin limit në vlerën 2,079,333 lekë patvsh, i përbërë nga 3 zëra (prerje bimësh të vogla 147,900 lekë, prerje e sistemim pemësh 4,209lekë, gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3 1,927,224). Nga auditimi i hartimit të fondit limitsipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje mepërcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë15.07.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe tëAnalizave Teknike të tyre", i ndryshuar. Grafiku i punimeve është 25 ditë pune.

Titulli i gjetjes 13: Shkelje e përcaktimeve të ligjit të prokurimit publik lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019"

Situata: Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019", rezulton se formulari i deklarimit të kushteve të konfliktit të interesit (*shtojca nr.1"Formular Deklarimi"*) është firmosur vetëm nga Kryetari i NJP, z. J.R dhe **nuk është firmosur nga anëtarët z. I.K dhe z. K.K,** veprime këto në kundërshtim me

përcaktimet e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 56, "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*".
Proces verbali për agrumentimin e kritereve për kualifikim për realizimin e prokurimit publik është mbajtur më datë 02.09.2019 nga anëtarët e NJP për hartimin e dokumentave të procedurës së tenderimit (shtojca nr.11). **Proces verbali është firmosur vetëm nga 1 (një) anëtar i NJP**, përkatësisht Kryetari i NJP z. J. R, dhe **nuk është firmosur nga 2 (dy) anëtarët e tjerë**
z. I.K dhe z. K.K. **Dokumentat e Tenderit janë hartuar dhe janë firmosur vetëm nga 1 (një) anëtar i NJP**, përkatësisht Kryetari i NJP z. J.R, dhe **nuk janë firmosur nga 2 (dy) anëtarët e tjerë** z. I.K dhe z. K.K.
Veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 1, "*Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit*".
Nga auditimi i dosjes së prokurimit dhe nga komunikimi me anëtarët e Njësisë së Prokurimit z. I.K dhe z. K.K, rezultoi se dy anëtarët e NJP nuk kanë marrë dijeni në ndonjë nga format e përcaktuara në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" lidhur me nxjerrjen e Urdhrit të Prokurimit nr. 41, datë 28.08.2019 për prokurimin e fondit limit me vlerë 2,079,333 lekë pa tvsh. Mbi këtë konstatim nga grupi i auditimit është mbajtur akt verifikimi nr. 2 datë 19.10.2021 me anëtarët e NJP z. I.K dhe z. K.K.
Konstatohet se, Titullari i AK ka lejuar vazhdimin e procedurës së prokurimit edhe me mangësitë e sipërcituara (mos firmosje e formularit të deklarimit të kushteve të konfliktit të interesit, mos firmosje e Proces verbalit për agrumentimin e kritereve dhe mos firmosje e DT nga dy anëtarët e NJP) në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 56 e nenit 57 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Kriteret: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenet 56, 57, 61, pika 1. Ligj nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 9, 10, 13 pika 2, 18, 21 pika 2 dhe neni 22 pika 4.
Urdhër i MFE nr. 108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit".
Ndikimi: Procedura është zhvilluar një shkejle të përcaktimeve të ligjit për PP.
Shkaku: Përgjegjësi i NJP ka vijuar i vetëm procedurën e prokurimit edhe pse asnjëri nga anëtarët e NJP nuk kanë marrë pjesë në këtë procedurë. Titullari i AK nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me faktin që NJP ka funksionuar vetëm me një anëtar.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Titullari i AK të marrë të gjitha masat e nevojshme që në të ardhmen ngritja e Njësisë së Prokurimit të bëhet jo vetëm në përputhje me kuadrin rregullativ, por të jetë realisht funksionale në tërësinë e saj, duke shmangur praktika ku dokumentet e prokurimit të përpilohen vetëm nga Përgjegjës i NJP, të tillë që anashkalojnë kontributin e specialistëve të fushave përkatëse në rolin e anëtarë të caktuar të NJP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. L.M dhe* Përgjegjësi *i Njësisë së Prokurimit z. J.R.

Titulli i gjetjes 14: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e procesit të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që ftohen të marrin pjesë në procedurat e prokurimit "Kërkesë për propozim".

Situata: Për procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019", në sistemin elektronik janë ftuar që të marrin pjesë pesë OE: Studio R- G, 6D – P., K., O. dhe C.. Nga verifikimi i Ekstraktit Historik në QKB rezulton se operatorët e ftuar kanë objekt të aktivitetit të tyre punime në fushën e ndërtimit.

Njoftimi i procedurës së prokurimit është botuar në buletinin e APP-së nr. 36, datë 09.09.2019. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019" rezulton se AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e OE që ka ftuar të marrin pjesë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39, pika 4, "*Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë*".

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39, pika 4.

Ndikimi: Mungesë e transparencës në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që janë ftuar të marrin pjesë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor për përzgjedhjen e OE që ftohen në procedurat e prokurimit.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që në rastin e zhvillimit të procedurave të llojit "Kërkesë për propozim" të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Njësisë së Prokurimit z. J.R.

Titulli i gjetjes 15: Mos zbatim i përcaktimeve të ligjit për PP në hartimin e DT.

Situata: Nga auditimi i procesit të hartimit të kritereve të përcaktuara për vlerësimin e operatorëve ekonomikë për procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019", në proces verbalin e datës 02.09.2019 nga anëtarët e NJP për hartimin e dokumentave të procedurës së tenderimit (shtojca nr.11) krahasuar me kriteret e vendosura në DT rezultojnë disa mospërputhje si më poshtë:

Në proces verbal kërkohen *licenca profesionale* lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të llojit:

Kategoria NP-1 Punime gërmimi në tokë

Kategoria NP-7 A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi vaditje

Kategoria NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime

Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike

Në DT kërkohen licencat:

Kategoria NP-1 A, Punime gërmimi në tokë.

Kategoria NP-7 A, Ujesjellesa,gazsjellësa,vajsjellësa,vepra kullimi e vaditje

Kategoria NP-12 A, Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Kategoria NS-1 A,Punime për prishjen e ndërtimeve.

Kategoria NS-18 A, Punime topogjeodezike

Në DT është shtuar licenca e kategorisë NS-1 A dhe licenca e kategorisë NP-9 është zëvendësuar me licencën e kategorisë Kategoria NP-12 A

Në Proces verbal kërkohen *certifikatat ISO*:

- ISO 9001:2008 ose 2015 mbi"Sistemet e menaxhimit cilësisë",
- ISO 14001:2004 ose 2015mbi "Sistemet e menaxhimit ambjentit"

Në DT kërkohen certifikatat ISO:

- ISO 9001:2008 ose 2015 mbi"Sistemet e menaxhimit cilësisë",
- ISO 14001:2004 ose 2015mbi "Sistemet e menaxhimit ambjentit"
- BS OHSAS 18001:2007 mbi "Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë"

Në DT është shtuar certifikata BS OHSAS 18001:2007.

Në proces verbal kërkohen *mjetet:*

a) Eskavator 2 copë
b) Kamion mbi 18 ton 2 copë
c) Gjenerator 1 copë
d) Motosharrë 2 copë

Në DT kërkohen mjetet:

a) Eskavator 1 copë
b) Kamion 2 copë
c) Fadromë 1 copë

Në DT nga 2 (dy) ekskavator kërkohet 1(një), nuk kërkohet gjenerator dhe motosharrë por kërkohet 1 (një) fadromë.

Në proces verbal *numri i punonjësve* që duhet të ketë OE është jo më pak se 25 punonjës, dhe specifikisht:

a) 1 Ing. Ndërtimi ose Hidroteknik
b) 1 Ing. Gjeodet
c) 1 Teknik Ndërtimi

Në DT kërkohet:

Numri mesatar vjetor i punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2019-Korrik 2019 duhet të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) , specifikisht

a) 1 Ing. Gjeodet
b) 1 Ing. Mjedisi
c) 1 Mjek

Në DT është shtuar Mjeku dhe Ing. i Mjedisit dhe është hequr Ing. Ndërtimit/Hidroteknik dhe Tekniku i Ndërtimit.

Për sa më sipër NJP ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 10 "Dokumentet Standarde të Tenderit".

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 10.

Ndikimi: NJP nuk i ka të qarta kërkesat që duhet të plotësojë OE që të shpallet fitues.

Shkaku: Mos zbatim i përcaktimeve të ligjit për PP nga Kryetari i NJP në hartimin e DT.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Libohovë në çdo rast të hartimit të dokumenteve të tenderit të përcaktojë qartë kriteret e veçanta dhe specifikimet teknike që duhet të plotësojnë Operatorët Ekonomikë për t'u kualifikuar dhe në çdo rast të ndryshimit të tyre të hartojë shtojcën përkatëse shoqëruese të Dokumenteve të Tenderit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Njësisë së Prokurimit z. J.R.

Titulli i gjetjes 16: Mbi përcaktimin dhe argumentimin e kritereve kualifikuese nga Njësia e Prokurimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019", në pikën 2.3 të DT "Kapaciteti teknik", nënpika 2.3.7 kërkohet që OE*"duhet të ketë në stafin e vetë 1 Mjek të Përgjithshëm, për vërtëtimin e këtij kriteri duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë pune individuale, Licencë, Diplomë (Në rast të ofertimit nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, të gjithë anëtarët e BOE duhet të plotësojnë këtë kërkesë)".*

- Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", ***shfuqizohet.*** *Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Sa më sipër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë një mjek në stafin e saj, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".* Sa më sipër trajtuar, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar.

Kriteri: VKM nr.914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 61, pika 2.

Ndikimi: Përcaktimi jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe kritereve të panevojshme, ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore, nënligjore dhe DST nga ana e NJP.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP), për çdo rast në përcaktimin e kritereve kualifikuese, duhet të argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Njësisë së Prokurimit z. J.R.

Auditimi i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

Komisioni i Vlerësimit të ofertave është ngritur me urdhër nr. 32, datë 26.02.2019, me përbërje: **znj. B.P., z. F.M dhe znj. E.L**.

Të gjithë anëtarët e KVO-së kanë nënshkruar shtojcën nr. 2 "Formularin e deklarimit" më datë 16.09.2019.

KVO ka mbajtur proces verbalin e hapjes së ofertave më datë 16.09.2019, ku konstatohet se për procedurën "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese" kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë:

1. OE "C." Shpk me ofertë ekonomike 2,031,500 lekë pa tvsh;
2. OE "S." Shpk me ofertë ekonomike 1,569,660 lekë pa tvsh;
3. OE "N. 86" Shpk me ofertë ekonomike 1,704,350 lekë pa tvsh;
4. OE "M." Shpk me ofertë ekonomike 1,818,740 lekë pa tvsh.

Pas hapjes së ofertave Bashkia Libohovë i ka kërkuar informacion Bashkisë Dropull me shkresën nr. 1401 Prot, datë 17.09.2019, lidhur me mjetet e deklaruara nga OE "M." Shpk, pasi ky operator ka lidhur një kontratë me Bashkinë Dropull me objekt "Pastrim i kanalit vaditës Dervician-Goranxi...". Bashkia Dropull ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1972 Prot, datë 18.09.2019, duke i dërguar Bashkisë Libohovë Shtojcën nr. 9 "Mbi disponimin e makinerive" nga OE "M.".
Më datë 24.09.2019, KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të ofertave si më poshtë:
Dy anëtaret e KVO-së znj. B.P dhe znj. E.L kanë skualifikuar OE:

1. "S." Shpk me ofertë ekonomike 1,569,660 lekë pa tvsh, pasi rezulton se nuk ka ngarkuar Ekstraktin e Thjeshtë të Regjistrit Tregtar, Ing. e Mjedisit E.A, nga libreza e punës figuron e punësuar në OSHE dhe nuk ka datë largimi nga OSHE apo datë fillimi në subjektin "S." Shpk. Për mjetin e paraqitur AA461NI, mungojnë fotot që janë kërkuar në DST;
2. "N. 86" Shpk me ofertë ekonomike 1,704,350 lekë pa tvsh, pasi mjetet e deklaruara janëtë angazhuara në kontratën e lidhur me Bashkinë Libohovë me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të brendshme";
3. "M." Shpk me ofertë ekonomike 1,818,740 lekë pa tvsh, pasi mjeti i deklaruar si fadromë në dokumentacionin e zhdoganimit rezulton të jetë traktor me zinxhirë, mjetet e deklaruara në këtë procedurë (AA736CU, SR774IB) janë të angazhuara në një kontratë qëOE ka me Bashkinë Dropull.

Është kualifikuar Operatori Ekonomik "C." Shpk me Nipt J.....K me ofertë ekonomike2,031,500 lekë pa tvsh.
Anëtari i KVO-së z. F.M ka kualifikuar të gjithë OE që kanë marrë pjesë:

1. OE "C." Shpk me ofertë ekonomike 2,031,500 lekë pa tvsh;
2. OE "S." Shpk me ofertë ekonomike 1,569,660 lekë pa tvsh;
3. OE "N. 86" Shpk me ofertë ekonomike 1,704,350 lekë pa tvsh;
4. OE "M." Shpk me ofertë ekonomike 1,818,740 lekë pa tvsh.

Trajtimi i ankesave
Lidhur me skualifikimin janë ankuar dy Operatorë Ekonomik:

- OE "M." Shpk më datë 25.09.2019

Sipas pikës 2.3.8 të DT, OE duhet të paraqesë:

a. Eskavator 1 copë
b. Kamionë 2 copë
c. Fadromë 1 copë

1. *KVO e ka skualifikuar OE për mjetin Fadromë i cili nuk plotëson kriteret teknike. OE sqaron se Fadroma me zinxhirë në deklaratën doganore është përshkruar që është e pajisur me kovë shtytëse dhe ngarkuese kjo e vërtetuar edhe me foto.*
2. *Lidhur me mjetet AA736CU, SR774IB dhe AA537NG që sipas KVO-së janë të angazhuara në kontratën e nënshkruar me Bashkinë Dropull, OE sqaron se nuk ka kontratë në proces me Bashkinë Dropull bazuar kjo në Njoftimin e përfundimit të kontratës në Bashkinë Dropull më nr. 665 Prot, datë 17.09.2019 dhe punime tnë objekt kanë përfunduar më 15.09.2019. Punimet kanë përfunduar përpara datës së hapjes së tenderit, dorëzimit të ofertave datë 16.09.2019. Referuar grafikut të punimeve në Bashkinë Dropull punimet e parashikuara të realizoheshin nga makineritë në fjalë kanë përfunduar përpara datës 10.09.2019. Automjeti me targa AA537NG për të cilin shprehet KVO nuk është i deklaruar si automjet i OE.*

Pas marrjes së ankesës Titullari i AK ka nxjerrë Urdhërin nr. 106, datë 25.09.2019 për pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës së OE "M." Shpk. Për trajtimin e ankesës titullari i AK ka ngritur KSHA me Urdhër nr. 107, datë 5.09.2019 "Për ngritjene Komisionit të Shyrtimit të Ankesave" për procedurën me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese" i përbërë nga z. G.C, Z. F.Z dhe z. E.T. KSHA me proces verbalin nr. 1449/1 Prot, datë30.09.2019, ka argumentuar se ankesa e OE "M." Shpk nuk qëndron për të njëjtat argumenteqë ka dhënë edhe KVO. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KSHA i ka dërguar Titullarit të AK raportin e shqyrtimit të ankesës me nr. 1449/2 Prot, datë 30.09.2019. Raporti është miratuar nga Titullari i AK me shkresën nr. 1449/3 Prot, datë 30.09.2019. Në vijim KSHA ka marrë vendimin që ankesa e OE "M." shpk, nuk qëndron, shkresa nr. 1449/4 Prot, datë 30.09.2019,dhe me shkresën nr. 1449/5 Prot, datë 30.09.2019 i ka kthyer përgjigje OE "M." Shpk.

- OE "S." Shpk datë 26.09.2019:

I skualifikaur nga KVO me arsyen: *se nuk ka ngarkuar Ekstraktin e thjeshtë të regjistrit tregtar dhe Ing. e Mjedisit E.A, nga libreza e punes figuron e punësuar në OSHE dhe nuk ka datë largimi nga OSHE apo datë fillimi në subjektin S. Shpk. Për mjetin e paraqitur mungojnë fotot që janë kërkuar në DST.*

Pretendimet e OE: *në dokumentacionin e ngarkuar në SPE është ngarkuar Ekstrakti i Thjeshtë i Regjistrit Tregtar; të dhënat mbi Ing. e Mjedisit janë të paraqitura në Kontratën e punës që është nënshkruar me "S." Shpk; listëpagesa dhe urdhër pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore të çdo muaji që është e shoqëruar me vërtetimin e DPT Fier vërteton që subjekti nuk kadetyrime; mungesa e fotove të mjetit AA461 NI nuk përbën kriter skualifikues pasi dokumentacioniteknik i mjetit është i plotë.*

KSHA ka mbajtur proces verbal nr. 1474/1 Prot, datë 02.10.20219, për shqyrtimin e ankesës së OE "S.", Shpk, dhe ka vendosur që ankesa nuk qëndron. Me shkresën nr. 1474/2 Prot, datë 02.10.2019 raporti i shqyrtimit të ankesës i dërgohet Titullarit të AK, i cili e miraton raportin me shkresën nr. 474/3 Prot, datë 02.10.2019. KSHA ka marrë Vendimin nr. 1474/4 Prot, datë 02.10.2019, mbi ankesën e OE "S." Shpk, duke argumetuar që ankesa e OE nuk qëndron. Me shkresën nr. 1474/5 Prot, datë 02.10.2019, i është kthyer përgjigje OE "S." Shpk.

- Ankesa e OE "M." Shpk, drejtuar KPP-së.

OE "M.", Shpk i është drejtuar edhe KPP-së për skualifikimin nga KVO më datë 08.10.2019.KPP me Vendimin nr. 1591/1 Prot, datë 10.10.2019 ka vendosur të marrë në shqyrtim ankesën e OE "M." Shpk, pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjes së vendimit përfundimtar nga KPP.

Me shkresën nr. 1579/1 Prot, datë 17.10.2019, Bashkia Libohovë i ka kthyer përgjigje KPP dhe i dërgon dokumentacionin përkatës brenda afateve (ka marrë dijeni më datë 14.10.2019).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës me Vendim nr. 757/2019, KPP vendosi: *"OE "M. Shpk" me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se disponon pajisjen e kërkuar fadromë me zinxhirë, si rezultat pretendimi i OE ankimues nuk qëndron. Lidhur me pretendimet e tjera të palësankimuese KPP gjykon se për aq kohë sa pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi OE nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP-së do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nukdo të ndryshonte gjendjen juridike të OE"*

Raporti përmbledhës për procedurën "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese", është miratuar më datë 10.12.2019, ku anëtarët e KVO-së znj. B.P dhe znj. E.L kanë skualifikuar OE:

1. "S." Shpk me ofertë ekonomike 1,569,660 lekë pa tvsh;
2. "N. 86" Shpk me ofertë ekonomike 1,704,350 lekë pa tvsh;
3. "M." Shpk me ofertë ekonomike 1,818,740 lekë pa tvsh.

dhe kanë kualifikuar Operatorin Ekonomik "C." Shpk me Nipt J.....K me ofertë ekonomike 2,031,500 lekë pa tvsh.

Anëtari i KVO-së z. F.M ka kualifikuar të gjithë OE që kanë marrë pjesë:

1. OE "C." Shpk me ofertë ekonomike 2,031,500 lekë pa tvsh;
2. OE "S." Shpk me ofertë ekonomike 1,569,660 lekë pa tvsh;
3. OE "N. 86" Shpk me ofertë ekonomike 1,704,350 lekë pa tvsh;
4. OE "M." Shpk me ofertë ekonomike 1,818,740 lekë pa tvsh.

Raporti përmbledhës është firmosur vetëm nga 2 (dy) anëtarët e KVO-së znj. B.P dhe znj. E.L dhe nuk është firmosur nga anëtari z. F.M.

Lidhja e kontratës

Me OE fitues është lidhur kontrata nr. 2009 Prot, datë 10.12.2019. Vlera e kontratës është 2,437,800 lekë me Tvsh. Kontrata nuk cakton datën e fillimit të punimeve por cakton datën e përfundimit të punimeve që është 7 javë (35 ditë pune) nga data e lidhjes së kontratës (10.12.2019). Grafiku i punimeve i hartuar nga shoqëria projektuese "I.-18" Shpk është 25 ditë pune.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Titullari i Autoritetit Kontraktor znj. L.M dhe anëtari i Njësisë së Prokurimit z. J.R.

2.) Auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në procedurën e prokurimit: "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2020".

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "<u>Mirëmbajtje e kanaleve kulluese-2020, Bashkia Libohovë</u>", REF-71923-09-15-2020</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 11 prot, datë 14.09.2020
Njësia e prokurimit, Urdhër nr. 22, datë 02.02.2020:
1.J.R
2.G.C
3.K.R</td><td rowspan="2">3. Urdhër i brendshëm për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.
Specifikimet teknike janë hartuar nga NJP
Llogaritja e fondit limit është bërë nga shoqëria projektuese "M.A.K Studio" Shpk</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, Urdhër nr. 107, datë 24.08.2020 me përbërje:
1.B.P
2. K.T
3. E.L</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Kërkesë për propozim"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa tvsh)
1,647,500 lekë pa tvsh</td><td>6. Oferta fituese (pa tvsh)
BOE "T-D & 6D P." Shpkme vlerë oferte 1,588,666 lekë pa tvsh</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
58,834 lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
29.09.2020</td><td>9. Burimi Financimit nga
Buxheti i Bashkisë</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
1. OE "C." shpk me vlerë oferte 1,640,500 lekë pa tvsh;
2.BOE "T-D & 6D P." Shpk meofertë ekonomike 1,588,666 lekë pa tvsh.</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
Pranë AK-Jo</td><td>12. Përgjigje Ankesës
-</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga KKP
-</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës
Është lidhur kontrata me nr. 1551 Prot, datë 27.10.2020 midis Bashkisë Libohovë dhe Operatorit Ekonomik "T.-D" Shpk, me vlerë kontrate</td><td colspan="2">Zbatimi i kontratës:</td></tr>
</table>

1,588,666 lekë pa Tvsh, me afat 30 ditë.	

Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike dhe realizimi i procedurës.

Titulli i gjetjes 17: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e procesit të përzgjedhjen së operatorëve ekonomikë që ftohen të marrin pjesë në procedurat e prokurimit "Kërkesë për propozim".

Situata: Llogaritja e fondit limit është bërë nga shoqëria projektuese "M.A.K Studio" Shpk, e cila ka llogaritur fondin limit në vlerën 1,647,500 lekë pa tvsh, i përbërë nga 3 zëra (prerje bimësh të vogla 95,066 lekë, prerje e sistemim pemësh 1,794 lekë, gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3 1,550,640). Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre", i ndryshuar. Grafiku i punimeve 30 ditë pune.

Titullari i AK në fillim të vitit 2020 ka ngritur Njësinë e Prokurimit me Urdhrin nr. 22, datë 02.02.2020, e përbërë nga: z. J. R., z. G. C. dhe z.K. R.

Për procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese për vitin 2020", titullari i AK ka nxjerrë Urdhrin e Prokurimit nr. 11, datë 14.09.2020 ku ngarkohet NJP të kryejë prokurimin e fondit limit me vlerë 1,647,500 lekë pa tvsh.

NJP ka firmosur formularin e deklarimit të kushteve të konfliktit të interesit (shtojca nr.1) më datë 15.09.2020. Proces verbali për agrumentimin e kritereve për kualifikim për realizimin e prokurimit publik është mbajtur më datë 15.09.2019 nga anëtarët e NJP për hartimin e dokumentave të procedurës së tenderimit (shtojca nr.11). Proces verbali është firmosur nga NJP. Janë hartuar Dokumentat e Tenderit dhe janë firmosur nga NJP.

Në sistemin elektronik janë ftuar që të marrin pjesë pesë OE: T.- I., 6D – P., O., C., T.-D. Nga verifikimi i Ekstraktit Historik në QKB rezulton se operatorët e ftuar kanë objekt të aktivitetit të tyre punime në fushën e ndërtimit.

Njoftimi është publikuar në Buletinin e APP-së nr. 74 datë 21.09.2020.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2020" rezulton se AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e OE që ka ftuar të marrin pjesë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39, pika 4, "*Pavarësisht nga publikimi i njoftimit të kontratës, sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti kontraktor fton për të marrë pjesë dhe të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë*".

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39, pika 4.

Ndikimi: Mungesë profesionalizmi në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që janë ftuar të marrin pjesë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor për përzgjedhjen e OE që ftohen në procedurat e prokurimit.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që në rastin e zhvillimit të procedurave të llojit "Kërkesë për propozim" të argumentojë dhe dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Vlerësimi i ofertave

Titulli i gjetjes 18: *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave.* Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje e kanaleve kulluese-2020"*, me fond limit 1,647,500 lekë pa Tvsh, me fitues BOE "T-D & 6D P." Shpk me vlerë oferte 1,588,666 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **1,588,666 lekë pa Tvsh.**

Situata: Komisioni i Vlerësimit të ofertave është ngritur me urdhër nr. 107, datë 24.08.2020, me përbërje: znj. B.P, z. K.T dhe znj. E.L.

Të gjithë anëtarët e KVO-së kanë nënshkruar shtojcën nr. 2 "Formularin e deklarimit" më datë 29.09.2020. KVO ka mbajtur proces verbalin e hapjes së ofertave më datë 29.09.2020, ku konstatohet se për procedurën "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese" kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë:

1. OE "C." Shpk me ofertë ekonomike 1,640,966 lekë pa tvsh;
2. BOE "T.-D dhe 6D P." Shpk me ofertë ekonomike 1,588,666 lekë pa tvsh; Më datë

03.10.2020, KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të ofertave si më poshtë:

Është skualifikuar OE "C." Shpk me Nipt J.....K me ofertë ekonomike 1,640,966 lekëpa tvsh, sepse nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, përkatësisht pikën *2.3.3. b)* ***Stafi teknik mbështetës***. Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë gjithashtu, në stafin teknik mbështetës punonjës të çertifikuar:

- **i.** 1 Inxhinier të çertifikuar ''Për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë'' , për të cilin të paraqitet kontrata e punës, dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.
- **ii.** 1 Inxhinier të çertifikuar ''Për mbrojtjen dhe menaxhimin në mjedis''**,** për të cilin të paraqitet kontrata e punës dhe të figurojë në listëpagesë të shoqërisë.

Është kualifikuar BOE, T.-D dhe 6D P." Shpk me ofertë ekonomike 1,588,666 lekë pa tvsh.Raporti përmbledhës për procedurën "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, 2020", është miratuar më datë 14.10.2020. Fituesi është publikuar në buletinin e APP-së nr. 89 datë 19.10.2020.

Nga auditimi i dokumentave të OE fitues rezulton se:

- Sipas kërkesave të pikës 2.3.5 kërkohet që, *OE duhet të disponojë punonjës të çertifikuar me dëshmi të sigurimit teknik lëshuar nga DPA ose Trupa çertifikuese ekuivalente: 5 punonjës karpentier vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme.* OE ka paraqitur çertifikatat e kualifikimit dhe kontratat e punës, ku **për punonjësit I.T dhe A.H kontrata e punës ka përfunduar më datë 03.06.2020**.
- Sipas kërkesave të pikës 2.3.9 dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion me vinç	Pronësi ose qira	Copë 1
2	Eskavator me goma (me leje qarkullimi,kolaudim,siguracion)	Pronësi ose qira	Copë1
3	Miniekskavator	Pronësi ose qira	Copë1
4	**Motosharrë**	**Pronësi ose qira**	**Copë 2**

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit:b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit,

(i vlefshëm); Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b)çertifikatë e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm); Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. ***Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.***

Rezulton se BOE nuk kanë paraqitur asnjë dokument lidhur me faktin që disponon motosharrat e kërkuara për të përmbushur kontratën.

Lidhja e kontratës

Me OE fitues është lidhur kontrata nr. 1551 Prot, datë 27.10.2020. Vlera e kontratës është 1,588,666 lekë pa Tvsh. Data e fillimit të punimeve është 27.10.2020. Afati për kryerjen e punimeve është 30 ditë sikurse është parashikuar në grafikun e punimeve të hartuar nga studio projektuese "M.A.K Studio" Shpk.

(Sa më sipër është trajtuar më gjerësisht në Akt konstatimin nr.6 datë 22.10.2021).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së znj. B.P, z. K.T dhe znj. E.L.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni, 53, pika 5, germa c dhe neni 55.

Ndikimi: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 1,588,666 lekë pa Tvsh.

Shkaku: Bashkimi Operatorëve Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Libohovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 1,588,666 lekë pa Tvsh.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/19, datë 02.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. B.P. me detyrë specialiste në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

1.kontratat e dy punonjësve që duhet të jenë edhe të certifikuar si karpentier, kanë përfunduar në datë 03.09.2020 ,ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar në datën 29.09.2020. Pavarësisht kontratave të përfunduara të dy punonjësit rezultojne në listpagesën e shoqërisë.

2.mbi paraqitjen e dokumentacionit lidhur me faktin që disponon motosharrat e kërkuara për të përmbushur kontratën gjendet bashkelidhur observacionit.

<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

1. Kontratat e dy punonjësve Ilir Tocka dhe Altin Haxhi kanë përfunduar më datë 03.06.2020 dhe listëpagesa e paraqitur nga subjekti është e muajit korrik 2020, e cila nuk vërteton se punonjësit janë pjesë e operatorit ekonomik në muajin shtator 2020. Për sa më sipër pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë.
2. Pretendimet e subjektit merren në konsideratë dhe pasqyrohen në Raportin e Auditimit pasi nga ana e subjektit u paraqit fatura tatimore e blerjes.

3) Për prokurimin me objekt "**Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë**", viti 2019, procedura "E Hapur", FL 30,916,666.7 lekë, shpallur fitues 2T sh.p.k me ofertën 30,260,737.5 lekë pa TVSH dhe 36,312,885 lekë me TVSH.

<table>
<tr><td colspan="3">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi
Nr. 40, datë 05.08.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
"Procedurë e hapur"</td><td>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit
Urdhër Nr. 33 dt. 26.02.2019
1. J.R (Kryetar)
2. K.K (Anëtar)
3. I.K (Anëtar)</td><td>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër Nr. 32 dt. 26.02.2019
1. B.P (Kryetare)
2. F.M (Anetar)
3. E.L (Anetare)</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa tvsh)
30,916,666.7 lekë</td><td>6.Oferta fituese (pa tvsh)
30,260,737.5 lekë</td><td>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
655,929.2 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
10/09/2019 09:00</td><td>9.Burimi Financimit
MBZHR-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</td><td>10.Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE
1. 2T shpk
2. M. shpk
3. Sh. shpk
b) S'kualifikuar 1 OE Sh. shpk
c) Kualifikuar 2 OE 2T shpk, M. shpk</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime
AK-ka Shkresa nr.1448 datë 25.09 2019</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr.1448/2 datë 30.09.2019</td><td>14. Kontrata
Nr.1630 prot, datë 21.10.2019</td></tr>
</table>

a. Mbi programimin e nevojave

Titulli i gjetjes 19: Mbi mungesën e programimit të nevojave

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, ka mangësi të theksuara bashkëpunimi dhe bashkërendimi, midis strukturave përkatëse, për kryerjen e procedurave dhe ndjekjen e hapave për planifikimin e fondeve referuar nevojave. Nuk ka patur bashkëpunim si brenda Bashkisë Libohovë, po ashtu edhe me Njësitë Administrative, përsa i përket mbledhjes së kërkesave reale nga strukturat, sektorët përkatës edhe të NJA mbi domosdoshmërinë dhe nevojën e këtij investimi dhe përpunimin e tyre në nivel institucional, me qëllim planifikimin e burimeve të financimit, nëpërmjet planifikimit të tyre në PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së PBA-së, të njësive të vetëqeverisjes vendore", në pikën 26 Përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore, dhe pika 43 Përgjegjësitë e Nëpunësit zbatues të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i hapave të nevojshëm në planifikimin e nevojave dhe mbulimin e tyre me financim, sjell planifikim jo real të fondeve buxhetore dhe rrezikun e mos përfshirjes të gjithë nevojave dhe për rrjedhojë rritjen e mundësisë së mos arritjes së objektivave.

Shkaku: Njohje e përciptë e legjislacionit, mos angazhim i stafit, mungesë e funksionimit të MFK, GMS, si dhe e Titullarit në cilësinë edhe të NA, si personi i cili duhet të drejtojë dhe monitorojë këtë proces.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Libohovë në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, me qëllim përmirësimin e procedurave dhe procesit të planifikimit të buxhetit, si atë afatmesëm dhe buxheteve vjetore, duhet të marrë masa që në të ardhmen të nxjerrë urdhra/udhëzime të brendshme,

për përcaktimin e hartimin e PBA dhe planeve vjetore të buxhetit, duke nisur me përllogaritjen sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse të nevojave, për çdo veprimtari të njësive të vetëqeverisjes vendore, në nivel programi dhe për çdo zë të shpenzimeve buxhetore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. ***Znj. L.M. me detyrë, Kryetare e Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues.***
2. ***Znj. E.Ç. me detyrë, Përgjegjëse e zyrës së financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.***

b. Mbi regjistrat e prokurimeve publike

Titulli i gjetjes 20: Parregullsi proceduriale mbi regjistrat e prokurimeve publike.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, Regjistri i Parashikimeve të prokurimeve publike të Bashkisë Libohovë për vitin 2020 është hartuar dhe dërguar në Degën e Thesarit Gjirokastër me shkresën përcjellëse nr. 403, datë 09.03.2020, por në tejkalim të afateve zyrtare. Buxheti i vitin 2020 është miratuar me VKB nr.120, datë 23.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohove 2020", konfirmuar nga prefekti Gjirokastër me shkresën nr.1814/1 prot datë 09.01.2020. Gjatë auditimit u evidentua se nuk ka evidencë në zyrën e Protokoll Arkivës së Bashkisë Libohovë mbi dërgimin e Regjistrit të Parashikimeve të prokurimeve për vitin 2019 si dhe nuk ka evidencë mbi dërgimin e regjistrit të realizimeve të prokurimeve për vitet 2019 dhe 2020. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, nuk ka evidencë të jetë bërë brenda afateve të përcaktuara në LLP dhe VKM në zbatim të saj.

Kriteri: VKM 914, neni 4 "Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik", pika 1, neni 7 "Realizimi i procedurave të prokurimit", pika 2 dhe pika 4, neni 4, pika 3.

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i hapave të nevojshëm procedurial në institucionet eprore për zhvillimin e procedurave të prokurimit, ul transparencën e procesit dhe për rrjedhojë rrit mundësisë së mos arritjes së objektivave.

Shkaku: Njohje e përciptë e legjislacionit, mos angazhim i stafit, mungesë e funksionimit të MFK, GMS.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: NZ dhe personi përgjegjës për prokurimin publik në Bashkinë Libohovë të ndjekim me rigorozitet afatat ligjore të përgatitjes dhe dërgimit të informacionit mbi regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) ***Z. J.R. me detyrë, Jurist i prokurimeve në cilësinë e personit përgjegjës për Njësinë e Prokurimit.***
2) ***Znj. E.Ç. me detyrë, Përgjegjëse e zyrës së financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/18, datë 02.12.2021 me shkresë përcjellëse nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. E.Ç me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

Lidhur me këtë gjetje, sipas të cilës nuk janë dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik Regjistrat e Parashikimeve dhe të Realizimeve të Prokurimeve Publike për vitet 2019 dhe 2020, sqaroj se në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, dhe të VKM nr. 14, date 29.12.2016 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar Udhëzimin nr. 01, date 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik", ku, sipas Kreut I, pikës 3 të këtij Udhëzimi, "...Çdo autoritet kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP do të bëhet brenda tre ditëve nga dita e nesërme punë të dërgimit të tij për publikim në sistem. Sjellim në vëmendje se, autoriteti kontraktor nuk duhet të dërgojë në APP, në formë të shkruar apo me CD, regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik."
Gjithashtu, në Kreun II, pikën 1 të këtij Udhëzimi, për Regjistrin e Realizimeve të Prokurimeve publike shprehet "Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik krijohet automatikisht nga sistemi i prokurimit elektronik për ato procedura që zhvillohen elektronikisht."
Sa më sipër, nga ana e personit përgjegjës për prokurimet është krijuar Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike në sistemin e prokurimit publik, një kopje e të cilit, pas publikiit nga APP, është përcjellë në Degën e Thesarit Gjirokastër.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Pretendimi juaj merret në konsideratë përsa i përket dërgimit të Regjistrit në APP. Por në zyrën e Protokoll Arkivës së Bashkisë Libohovë nuk gjendet dokumentacion justifikues mbi dërgimin e Regjistrit të Parashikimeve të prokurimeve për vitin 2019 si dhe nuk ka evidencë mbi dërgimin e regjistrit të realizimeve të prokurimeve për vitet 2019 dhe 2020. Pjesa e sqaruar prej jush do të reflektohet në Raportin e Auditimit, tek i cili qëndron i pandryshuar dërgimi i regjistrave të realizimit të prokurimeve për vitet 2019 dhe 2020 si dhe regjistri i parashikimit

c. Mbi verifikimin e shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit për investime publike për vitin 2019 dhe 2020, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Programi buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe 2019-2021;
- Plani Buxhetit dhe fakti i buxhetit për vitin 2019 dhe 2020;
- Regjistri i Parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 2019-2020;

Tabela nr. C/1 "Projektet dhe burimi i financimit"

Nr.	Emërtimi	Viti 2019			
		Parashikim	Burimet e financimit		
			PBA 2018-2020	Buxheti i shtetit 2019	Të ardhurat e veta
1	Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë	-	-	17,000,000	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë

Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë
Burimi i financimit është nga të ardhurat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fond i shpërndarë nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit" të alokuara në buxhetin e vitit 2019 me shkresën nr.4179/1, datë 11.06.2019 në shumën 17,000,000 lekë për vitin 2019 me vlerë totale investimi 30,916,666.7 i cili nuk ka kaluar në Këshillin Bashkiak për miratimin në parim të fondit për investim.
Urdhër prokurimi nr.40, datë 05.08.2019.
Fillimi (nxjerrja e urdhër prokurimeve) dhe kryerja e procedurave të prokurimit publik, është realizuar pas miratimit dhe angazhimit të fondeve publike, për financimin e projekteve për punë publike, të zhvilluara gjatë vitit 2019, me burim financimi nga të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

d. Mbi rregullshmërinë e angazhimit të fondeve.

Titulli i gjetjes 21: Mbi rregullshmërinë e angazhimit të fondeve buxhetore për vitin 2019-2020
Situata: Me qëllim disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe eliminimin e rasteve të fillimit të procedurave të prokurimit publik, pa patur fonde në dispozicion është kërkuar që Njësia e Prokurimit, duhet të posedojë përpara fillimit të procedurës së prokurimit "Kërkesën për marrje angazhimi". Nga auditimi rezultoi se në asnjë nga procedurat objekt auditimi nuk ndodhej në dosjet përkatëse "Kërkesa për marrje angazhimi" dhe konfirmimi i saj nga NA dhe NZ.
Kriteri: Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" pika 153-155; Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" me ndryshime "Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike" pika 154, pika 7
Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i disiplinës buxhetore sjell fillimin e procedurave dhe marrjen e angazhimeve buxhetore, pa patur në dispozicion fondet buxhetore për financimin e shpenzimeve. Kjo situatë shkakton vështirësi financiare dhe rritjen e detyrimeve të Bashkisë Dropull kundrejt Operatorëve ekonomik.
Shkaku: Mos njohje e legjislacionit, mungesë stafi.
Rëndësia: E ulët
Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, NJP dhe Nëpunësi Zbatues me qëllim eliminimin e mundësive, për marrje angazhimesh pa fonde në dispozicion, të marrin masa të menjëhershme ku NJP, fillimin e çdo procedure prokurimi, duhet së pari ta mbështesë në Kërkesën për marrje angazhimi, nga struktura përkatëse dhe konfirmimin e saj nga NZ dhe NA. NJP, duhet të përcjellë në çdo rast Urdhër Prokurimin tek Nëpunësi Zbatues me qëllim që ky i fundit të kryejë depozitimin e tij Degën e Thesarit, përpara fillimit të procedurës, për të konfirmuar disponibilitetin e fondeve në Degën e Thesarit, për çdo objekt investimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. **Z. F.M. me detyrë, shef i sektorit të shërbimit urban në cilësinë e personit kërkues tëshpenzimit dhe sektorit përgjegjës për inventimin.**

- Nga AK janë depozituar në Degën e Thesarit, Urdhërat e Prokurimit, përpara hapjes sëprocedurës së prokurimit me qëllim, konfirmimin e Degës së Thesarit, për disponibilitetin e fondeve përkatëse për çdo procedurë prokurimi.

e. Mbi funksionimin e strukturës së prokurimeve

Tiulli i gjetjes 22: Paregullsi në përcatimin e personit përgjegjës për prokurimet publike.
Situata: Titullari i AK për procedurën e prokurimit ka nënshkruar një autorizim pa datë përkatëse dhe pa numër protokolli, tek e cila autorizon z.J.R. si Kryetar të NJP për procedurën me objekt

prokurimi "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë". Si e tillë Titullari i AK në fillim të çdo viti nuk ka përcaktuar "Personin përgjegjës për prokurimet publike" sipas akteve ligjore në fuqi. Nuk ka shkresë drejtuar APP-së për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimet. Nga auditimi ka rezultuar se administrimi i Dosjeve të prokurimit është bërë nga Juristi z.J.R.
Kriteri: VKM neni 57, pika 1.
Mosrespektim i hapave procedurial të legjislacionit të fushës me efekt në eficiencën e realizimit të procedurave të prokurimit në Bashkinë Libohovë.
Shkaku: Mos njohje e legjislacionit
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Titullari i Bashkisë Libohovë, në fillim të çdo viti të caktoj me urdhër të veçantë personin/ personat përgjegjës për prokurimin dhe ti dërgoj emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1 ***Znj. L.M. me detyrë, Kryetare e Bashkisë Libohovë, në cilësinë e Titullarit të AutoritetitKontraktual.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. LM. me detyrë Kryetare e Bashkisë Libohovë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:
Per sa i perket autorizimit i cili ndodhej ne dosjen e prokurimit ju sqarojme se eshte thjesht per iventarizimin dhe numerizimin e dosjes se prokurimit nga Juristi.
Bashkengjitur do te keni urdhrin per Caktimin e personit pergjegjes i cili eshte i ngritur ne fillim te cdo viti dhe emaili ne te cilin i eshte percjelle informacioni APP.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Urdhëri nr 34, datë 26.02.2019 "Për caktimin e personit përgjegjës për prokurimet publike", është një shkresë e cila nuk përmban elementët formal thelbësor të akteve që nxjerrë institucioni si numri i protokollit (gjurma shkresore) dhe data e dërgimit të shkresës tek personi përgjegjës, në mënyrë të tillë që të njihet me përmbajtjen dhe përgjegjësitë që i caktohen. Në observacionet e dërguara nga ju, nuk gjendet asnjë evidencë mbi përcjelljen me e-mail pranë APP të urdhërit të sipërcituar. Si e tillë pretendimi juaj nuk merrët në konsideratë.

f. Mbi administrimin e dosjeve nga NJP

Titulli i gjetjes 23: Administrimi i dosjes së prokurimit

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për procedurën e audituar, nga ku rezultoi se:
Në përgjithësi nga Juristi i prokurimeve, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t'u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE

fitues, ka shqyrtuar dhe ka reflektuar rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj.
Nga ana e Juristit të prokurimeve është administruar dhe inventarizuar dosja e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST, me përjashtim të kërkesës për angazhim të fondeve dhe kërkesës së strukturave dhe njësis mbi identifikimin e nevojave.
Mbi administrimin e procesverbaleve të hartimit të DST me mungesën e prezencës së 2 anëtarëve të tjerë, është mbajtur AV nr.1 datë 07.10.2021.

1. Për fillimin e procedurave të prokurimit për objekt prokurimin "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë, titullari i autoritetit kontraktor znj Luiza Mandi ka nxjerrë Urdhërin nr.33, datë 26.02.2019 "Për krijimin e njësisë së prokurimit" dhe më pas ka nxjerrë Urdhër Prokurimin nr.40, datë 05.08.219 për kryerjen e procedurave të prokurimit në llojin e procedurës "E Hapur" me fond limit 30,916,666.7 lekë, financuar nga MBZHR dhe për vitin 2019 në vlerën 14,166,666.7 lekë.
2. Për të vazhduar procedurën e prokurimit publik sipas Ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 56 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të gjithë anëtarët e NJP nënshkruajnë Formularin e Deklarimit mbi kushtet e konfliktit të interesit dhe procedohet duke hartuar kriteret e kualifikimit shoqëruar me dokumentat standarde të tenderit në përputhje me nenin 57 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Mirëpo gjatë shqyrtimit nga grupi i auditimit të dosjes fizike të objektit të prokurimit të sipërcituar, u evidentuan mangësi të cilat konsistojnë në:

Situata 1: Mos vënien në dijeni, në ndonjë nga format e përcaktuara në Ligj nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, për caktimin si anëtarë të NJP të z.I.K dhe z. K.K për procedurën me objekt prokurimi "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë";

Situata 2: Në kushtet e mësipërme të mos pasjes dijeni të dy anëtarët e NJP të sipërcituar nuk kanë nënshkruar Formularin e Deklarimit mbi kushtet e konfliktit të interesit dhe si e tillë në dosjen fizike gjendet vetëm Formulari i Deklarimit nënshkruar nga Kryetari i NJP z.J.R.

Situata 3: Procesverbali i datës 07.08.2019 mbi hartimin e dokumentave standarte të procedurës së prokurimit, është mbajtuar vetëm me pjesëmarrjen e një anëtari të NJP, konkretisht vetëm z.J.R në mungesë të pjesëmarrjes së dy anëtarëve të tjerë të NJP mbi përmbajtjen e këtij akti, ilustruar në aneksin nr.4.

Situata 4: Lejimin e vazhdimit të procedurës së prokurimit nga Titullari i AK edhe me mangësitë e sipërcituara në kundërshtim më Ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 56 e nenit 57 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Situata 5: Mos anullimi i kësaj procedure prokurimi publik nga titullari i AK në kushtet kur DST është përgatitur jo nga NJP por vetëm nga pergjegjësi i saj, ka/mund sjellë hartimin e kritereve kualifikuese preferenciale, që çojnë në shmangien e OE nga pjesëmarrja në konkurim dhe përbën kundravajtje administrative.

Kriteri: VKM nenin 57, "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit", pika 3; Ligj nr.10296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, Neni 10 Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut, Neni 12 Njoftimi i kontrartës, Neni 13 Dokumentimi dhe raportimi i urdhrave të

kundërshtuar pika2, Neni 18 Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, Neni 21 Menaxhimi i riskut, pika 2, Neni 22
Veprimtaritë e kontrollit, pika 4; Urdhër 108, datë 17.11.2016 Për miratimin e manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Ndikimi/Efekti: Ndjekje e procedurave në kundërshti me legjislacionin në fuqi, duke lejuar vazhdimin e procedurave të prokurimit në shkelje proceduriale.
Shkaku: Devijim i legjislacionit dhe mosveprim i titullarit për anullimin e procedurës së prokurimit.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: Titullari i AK të marrë të gjitha masat e nevojshme që në të ardhmen ngritja e Njësisë së Prokurimit të bëhet jo vetëm në përputhje me kuadrin rregullativ, por të jetë realisht funksionale në tërësinë e saj, duke shmangur praktika ku dokumentet e prokurimit të përpilohen vetëm nga Përgjegjës i NJP, të tillë që anashkalojnë kontributin e specialistëve të fushave përkatëse në rolin e anëtarëve të caktuar të NJP.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. ***Znj. L.M. me detyrë, Kryetare e Bashkisë Libohovë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktual, nëpunës autorizues;***
2. ***Z. J.R. me detyrë, Jurist, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga znj. L.M. me detyrë Kryetare e Bashkisë Libohovë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
1.Në lidhje me pretendimet e ngritura per mosmarjen ne dijeni per caktimin si anetare te Njesise se Prokurimit po ju vendosim ne dispozicion dokumentin e marjes se urdhrit (venies ne dijeni) me nr.33 date 26.02.2019 per krijimin e njesise se prokurimit per vitin 2019 me anetare: I.K, J.R, K.K. I cili eshte ndryshuar me urdhrin nr.22. date 02.02.2020 per krijimin e njesise se prokurimit per vitin 2020 me anetare: K.R, J.R, G.C. Nuk eshte I vertete pretendimi I ngritur nga ana e tyre per mospasje dijeni per keto procedura pasi urdheri i ngritur ne fillim te vitit me nr.33. date26.02.2019 ku I.K eshte Kryetar i Njesise se Prokurimit dhe ka pasur dijeni si dhe ka mare pjese ne te gjitha procedurat qe jane zhvilluar ne kete vit. Kjo eshte e vertetueshme dhe me faktin pasi personat e siperpermendur kane kryer veprime ne mbeshtetje te ketij urdheri perkatesisht ne dy objekte: Blerje automjet dhe pajisje zjarrfikese me nr.1 date 28.02.2019 Blerje karburant 2019 me nr.23 date.19.04.2019 ne te cilat kane firmosur deklaratat dhe gjithe dokumentacionin e procedures Une si Titullar i AK kam lejuar vazhdimin e procedures se prokurimit sepse nuk kampasur asnje informacion per parregullsi as nga N/kryetari qe me urdherin nr.8, date 07.01.2019 te cilin e kam urdheruar qe te kete competence ne zgjidhjen e ceshtjeve ne disa sektore te Bashkiseku perfshihet dhe Sektori Juridik, qe ishte dhe Kryetar i njesise se prokurimit dhe as nga antetarete tjere te njesise se prokurimit dhe me mirebesim kam vazhduar.

<u>Oëndrimi i Grupit të auditimit:</u>
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Pretendimi juaj mbi mohimin e mosmarrjes dijeni për caktimin si anëtarë të NJP të z.I.K dhe z. K.K, duke sjellë në vëmëndje prezencën e tyre në procedura të tjera në vazhdimësi, nuk është justifikim për procedurën specifike që grupi i auditimit ka audituar. Çdo procedurë është në mënyrë eksplicite e shkeputur njëra nga tjetra, evidencat mbështetëse të së cilave qëndrojnë veçmas në dosjet përkatëse të prokurimit. Urdhëri nr.33, datë 26.02.2019 që ju citoni, referuar bazës ligjore që përmendni në akt, është dokumentacion i cili lejon anëtarët e komisionit të jenë sipas specifikave që ju keni legjitimuar në tërësi për të gjithe periudhën kalendarike prej 1 viti. Por materiali i trajtuar në Raportin e Auditimit i referohet specifikisht mos marrjes dijeni për realizimin e procedurës së prokurimit "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë"dhe "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese 2019".
2. Lidhur me lejimin e vazhdimit të procedurës nga ana juaj në kushte mirëbesimi për mospasje informacioni për parrëgullsi, ju shpjegojmë se anëtarët e sipërcituar as nuk kanë dijeni që institucioni Bashkia Libohovë është duke zhvilluar 2 proceduar e cituara të prokurimit, sepse rolii tyre sipas Urdhërit nr.33 datë 26.02.2019 tregon se z.I.K dhe z.K.K duhet të hartonin individualisht sipas pozicioneve kriteret e kualifikimit për këto 2 procedura. Këto kritere kanë rëndësi maksimale mbi çdo element tjetër procedurial të prokurimit sepse kornizojnë elementët e sigurisë për fituesin. Ju si Titullare institucioni e ndodhur në kushtet e mosrealizimit të një nga hapat më të rëndësishmëm të prokurimit, si ai i hartimit të kritereve kualifikuese, nuk justifikoni neglizhencën në ushtrimin e detyrës funksionale me faktin e mospasjes së informacionit, sepse hartimi i DST vetëm nga një jurist eksperianca e të cilit nuk përkon më natyrën e objekteve të prokuruara, nuk është proces i rregullt. Si e tillë pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë për justifikim e situatave të evidentuara nga grupi i auditimit.

g. <u>Mbi auditimin mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).</u>

Titulli i gjetjes 24: Mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit)

Në lidhje me përllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt prokurimi "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtëu", konstatua se NJP ka hartuar Urdhërin e prokurimit për fondin limit 30,916,666.7 lekë, referuar preventivit të hartuar nga Shoqëria "H.&S. 11" shpk për shumën 30,916,666.7 lekë dhe 37,100,000 lekë me TVSH. Shoqëria "H.&S.11" shpk ka licencë në projektim të veprave të tilla me N.6703/8. Gjatë verifikimit të çmimeve për punimet e paraqitura në preventiv, u konstatua se përllogaritja e tyre është bërë sipas Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të Tyre miratuar me VKM nr. 629 datë 15.7.2015, ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018. Për të konstatuar përllogaritjen e FL përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit, grupi i auditimit shqyrtoj evidencat e siguruara nga Bashkia Libohovë në të cilën rezultoj se:

Situata: Projekti i Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" është realizuar dhe më pas dhuruar nga shoqeria "H.&S. 11" shpk për Bashkinë Libohovë nëpërmjet nënshkrimit të Akt-Marrëveshje Dhurimi ndërmjet Bashkisë Libohovë dhe shoqërisë "H.&S. 11" shpk me objekt dhurimi projektin e "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë". Në këtë Akt-Marrëveshje Dhurimi mungojnë elementët thelbësorë si numër protokolli, data e nënshkrimit si dhe vlera e shërbimit të kryer. Për marrjen e këtij studimi, titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktivit dhe inventarizimin e tij në kartelat e aktivit, si e tillë mungon akti i marrjes në dorëzim të mallit i cili duhet të shoqëronte ank-

dhurimin. Për këtë studim, mungojnë dokumentacioni shkresor i protokolluar mbi kërkesat e sektorit të fushës të cilët të kenë konstatuar problematikën teknike si dhe korespodencat shkresore të titullarit të institucionit Bashkia Libohovë, mbi nevojën apo domosdoshmërinë e studimit për t'u kryer nga palë të treta, për të cilat bashkia nuk ka mundësinë të paguaj. Ky studim rezulton i pa rregjistruar në Pasqyrat Financiare të Bilancit për vitet 2019 dhe 2020 si dhe i paevidentuar në kartelat e aseteve "analitike e llogarisë 202".

Kriteri: Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pikën 42 ,43 dhe 56.

Ndikimi/Efekti: parregullsi në evidentimin e saktë financiar dhe ligjor të aktiveve.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore dhe nënligjore, mungesë e theksuar profesionalizmi e strukturave të menaxhimit të aktiveve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë në cilësinë e NA si dhe NZ të verifikojnë dhe plotësojnë praktikën dokumentare për marrjen në dorëzim të Projektit të Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" të dhuruar nga shoqeria "H.&S. 11" shpk si dhe të procedojnë me rregjistrimin e tyre në librat kontabël.

Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit

Titulli i gjetjes 25 : Mbi përcaktimin dhe argumentimin e kritereve kualifikuese nga Njësia e Prokurimit.

Dokumentet e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" janë hartuar me procesverbalin mbi miratimin e DST, datë 07.08.2019.

Situata 1: NJHDT për procedurën e prokurimit me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" ka listuar kërkesat për plotësimin e kapacitetit ligjor/profesional të OE, për kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe për atë teknik ku ndër të tjera ka kërkuar: Për plotësmin e kapacitetit financiar OE duhet të ketë vërtetim lëshuar nga Bashkia Libohovë që nuk ka detyrime ndaj kësaj bashkie si dhe njësive administrative pjesë e Bashkisë Libohovë sipas ligjit Nr.9632 date 30.10.2006 "Për sistemimin e taksave vendore", i ndryshuar. Për vendosjen e këtij kriteri, NJHDT nuk ka faktuar në procesverbal argumenta teknike dhe ligjore mbi domosdoshmërinë e saj në përmbushje të objektit të prokurimit. Ky kriter është në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit financiar të OE Sigurimi paraprak nga ana e OE të një dokumentacioni të tillë, shmang konkurrencën dhe barazinë në tender duke i përjashtuar për të hyrë në tender ato OE që nuk kanë ushtruar aktivitet në Bashkinë Libohovë,

Kriteri: nenin 46, pika c), të Ligjit "Për prokurimin publik" Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, pika ç dhe d, nenin 20 Mosdiskriminimi të Ligjit "Për prokurimin publik" Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar VKM nr.914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 61, pika 2 Ky veprim është në kundërshtim me,

Situata 2: Për plotësmin e kapacitetit teknik OE duhet të ketë Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të kategorive dhe niveleve:

NP-5 A Punime nëntokësore,vepra arti

NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Vendosja e këtij kriteri është në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit teknik sepse për një kategori të tillë licence nuk ka punime në preventivin e punimeve të ndërtimit. Një kriter i tillë nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.

Kriteri: LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, pika ç dhe d,
Situata 3: Për plotësimin e kapacitetit teknik OE duhet të ketë pjesë të stafit teknik punonjës të specializuar si: Auditues mjedisi, për të cilën të paraqitet certifikata përkatëse e lëshuar nga Ministriae Mjedisit dhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë. Vendosja e këtij kriteri është në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit teknik sepse për një kërkesë specifike e cila nuk lidhet me domosdoshmërinë e realizimit të objektit të prokurimit si dhe nuk ka punime në preventivin e punimeve të ndërtimit. NJHDST në procesverbalin e hartimit të kritereve, nuk ka dhënë asnjë argument teknik dhe ligjor të dokumentuar mbi këtë përcaktim dhe domosdoshmëri. Për këtë shkak nuk mund të gjykohet nëse kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës.Një kriter i tillë nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.
Kriteri: nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2, LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, pika ç dhe d
Situata 4: Për plotësimin e kapacitetit teknik OE duhet të ketë vërtetim për fuqinë mesatare punëtore prej të paktën 100 punëtorësh të operatorit ekonomik gjatë periudhës Prill 2018 deri në Mars 2019, të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listëpagesat përkatëse. Duhet të ketë të certifikuar punonjës të shoqërisë, nga të cilët të jenë:

Specialist ndertimi	5
Manovratore	3
Shofer	6
Specialist per ndihmen e pare	3
Teknik ndertimi	3
Teknik gjeodet	1

Në proces verbalin për miratimin e dokumentave standarde të tenderit NJHDST nuk ka dhënë asnjë argument teknik dhe ligjor të dokumentuar mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve të OE si më sipër dhe pamundësinë e kryerjes së objektit të prokurimit me më tepër apo më pak punonjës/punonjës të certifikuar. Për këtë shkak grupi i auditimit gjykon se kjo kërkesë e pajustifikuar nuk është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës.
Kriteri: VKM nr.914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 61, pika 2.
Situata 5: Për plotësimin e kapacitetit teknik OE duhet të dorëzoj një vërtetim nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qëndror, vërtetim që nuk ka masë administrative në fuqi. Ky kriter është përcaktuar në tejkalim të kapacitetit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit teknik sepse një përcaktim i tillë nuk ofron siguri të mjaftueshme për AK mbi realizimin apo jo të objektit të prokurimit nga OE. Një kriter i tillë nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.
Kriteri: LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, pika ç dhe d, nenin 46 VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor, grupi i auditimit konstatoj se Procesverbali i hartimit të kritereve të kualifikimit si edhe të dokumenteve standarte të tenderit, është i nënshkruar vetëm nga 1 anëtar i saj konkretisht z.J. R.. Njëherësh edhe formati shtojca nr.1 e deklaratës sëkonfliktit të interesit të anëtarëve të NJP është i nënshkruar vetëm nga 1 anëtar i saj konkretisht z. J. R. Dy anëtarët e tjerë të NJP nuk kanë marrë dijeni shkresore për prezencën e tyre si anëtarë në NJP me objekt prokurimi "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë". Pavarësisht këtij fakti titullari i AK ka lejuar vazhdimin e procedurës

për ngritjen e grupit të vlerësimit të ofertave. Të ndodhur në këto kushte, grupi i auditimit ka mbajtur aktin e verifikimit nr.1 protokolluar në Bashkinë Libohovë nr.prot 1069/3 datë 07.10.2021. Ky veprim është i përcaktuar në në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, ku cilësohet:

Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Përcaktimi i kritereve jo të qarta, jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe kritereve të panevojshme, ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë, por dhe në mos përmbushjen e kritereve nga ana e tyre për shkak të pa qartësive.
Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore, nënligjore dhe DST nga ana e NJP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP), për çdo rast në përcaktimin e kritereve kualifikuese, duhet të:
- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim;
-nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. ***Znj. L.M. me detyrë, Kryetare e Bashkisë Libohovë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktual;***
2. ***Z. J.R. me detyrë, Jurist, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë 1069/20 prot datë 10.12.2021 dërguar me shkresë nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z. J.R. me detyrë Jurist dhe përson përgjegjës i prokurimeve, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
1. Kanalet ujitës janë egzistues që nuk kanë funksionuar gjatë 20-25 vjeteve të fundit. Ka punime prishje betoni. Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet në Vizatimet përkatëse të projektit. Çdo thellësi me e madhe e gërmuar nën nivelin e formacionit, brënda tolerancës së lejuar, duhet të bëhet mire me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij. Kujdes i veçante duhet të ushtrohet kur gërmohen seksione për të mos hequr material përtej vijes së specifikuar të seksionit dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmërinë strukturore të skarpatave duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjesëve të ngjeshura...
2. Theksojme se kemi te bejme me punime te cilat gjate zbatimit te tyre sjellin mbetje dhe materiale te cilat kosniderohen te rrezikshme per komunitetin perreth. Persa i perket mbetjeve inerte eshte vete investitori qe duhet te largoje nga sheshi i ndertimit mbetjet e ngurta qe do te krijohen. Ku ne kete raste eshte sipermarresi i punimeve qe do te largoje mbetjet inerte. Kerkesat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, ...

3. *Kriteri I fuqise punetore eshte vendosur ne perputhje te plote me volumet e punimeve objekt I kkesaj kontrate dhe afatin e realizimit te saj. Bejme me dije se kemi te bejme me nje objekt i cili ka nje volum te konsiderueshem te punimeve sic eshte percaktuar edhe ne preventivin dhe dosjen teknike te objektit si dhe kerkesa per perfundimin e tyre ne nje afat te shkurter. Referuar sa me siper bejme me dije se brenda ketij numri te kerkuar jane te perfshire i gjithe stafi teknik ne license, specialistet e kerkuar profesionale, manovratore e shofere, specialistet e certifikuar. Numri i percaktuar i punonjesve eshte i domosdoshem pasi volumi i punimeve eshte i konsiderueshem. Theksojme se nje numer i tille i siguron Autoritetit Kontraktor se punimet ne kete objekt do te kryhen ne kohe dhe me cilesi.*

<u>Oëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Vendosja e këtij kriteri është në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit teknik sepse për një kategori të tillë licence nuk ka punime në preventivin e punimeve të ndërtimit. Një kriter i tillë nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.
2. Vendosja e këtij kriteri është në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit teknik sepse për një kërkesë specifike e cila nuk lidhet me domosdoshmërinë e realizimit të objektit të prokurimit si dhe nuk ka punime në preventivin e punimeve të ndërtimit. NJHDST në procesverbalin e hartimit të kritereve, nuk ka dhënë asnjë argument teknik dhe ligjor të dokumentuar mbi këtë përcaktim dhe domosdoshmëri. Për këtë shkak nuk mund të gjykohet nëse kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës.Një kriter i tillë nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet.
3. Në proces verbalin për miratimin e dokumentave standarde të tenderit NJHDST nuk ka dhënë asnjë argument teknik dhe ligjor të dokumentuar mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve të OE si më sipër dhe pamundësinë e kryerjes së objektit të prokurimit me më tepër apo më pak punonjës/punonjës të certifikuar. Për këtë shkak grupi i auditimit gjykon se kjo kërkesë e pajustifikuar nuk është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës si dhe nuk ndjek llogaritjen e saktë të formulës se fuqisë punëtore për nr ditësh punësh.

Mbi vlerësimin e OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO)

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga KVO;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni i hedhur në SPE.

Mbi vlerësimin e ofertave

Procedura e prokurimit është hapur nga KVO me procesverbalin e datës 19.09.2019. Në të kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar në fazën e parë OE sa më poshtë vijon:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO-së		
			Brisilda Ponde	Esmeralda Lile	Foto Mangllara
1	BOE “M. ” shpk, ”B-I” shpk, “G. F.” shpk	24,053,925 lekë	S’Kualifikuar	S’Kualifikuar	Kualifikuar
2	OE “2T” shpk	30,260,737,5 lekë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
3	“SH.” shpk	0 lekë	S’Kualifikuar	S’Kualifikuar	S’kualifikuar

Arsyeja e s'kualifikimit OE G.F. sh.p.k i cili mban edhe përqindjen më të ulët në këtë bashkëpunim, nuk ka paraqitur kontratë pune me afat kohor që të perfshijë edhe këtë procedurë prokurimi për inxhinieren e mjedisit. Kontrata e punës e inxhinieres së mjedisit është dy vjecare duke filluar nga muaji maj 2017-maj 2019. Për mjetet e deklaruar nga ky OE përkatësisht AA796 TY dhe AA354 NV mungon leje transporti ashtu sic është kërkuar në DST

Ankimim për s'kualifikimin nga BOE "M."shpk, "B.-I" shpk, "G. F." shpk, e protokolluar në Bashkinë Libohovë nr.1448 datë 25.09.2019, i cili ankimohet për sa vijon:

- Sqarojmë se oferta jonë është paraqitur si bashkim operatoresh "M." sh.p.k & "B- I" sh.p.k & "G. F." sh.p.k, bashkim i cili është krijuar në respektim të nenit 74 te VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e prokurimit Publike" i ndryshuar sipaskontratës së bashkëpunimit nr.4047 rep.nr.827 kol datë 07.09.2019, ku është parashikuar ndarja e punimeve:
  Shoqeria "M." sh.p.k -58.7%
  Shoqeria "B-I" sh.p.k -39.5%
  Shoqeria "G. F." sh.p.k -1.8%
- Përkatësisht shoqeria "G. F." sh.p.k, ka marr përsipër punimet e parashikuara në preventivin e objektit te prokurimit si vijon:
  3.2 Prerje e pastrim nga ferrat ne kanalin ekzistues
  3.4 Prerje e sistemim pemësh diam 21-40 cm në kanal
  Shërbimet e espertizes profesionale lidhur me pyjet dhe kullotat
  Janë paraqitur 6 copë dokumentacion për kamioncina

Me urdhërin nr.104, datë 25.09.2019, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit dhe është ngritur me urdhërin nr.105 datë 25.09.2019 KSHA i përbërë nga G. C., F. Z. dhe E. T.. KSHA mbas shqyrtimit të ankesës, me shkresën nr. 1448/2, datë 30.09.2019, i përgjigjet OE M. shpk në cilësinë e OE përfaqësues se arsyetimet e ankimimit nuk qëndrojnë, si e tillë ankesa nuk pranohet.
Ankimimi në KPP nga OE është dërguar në Bashkinë Libohovë me shkresën nr.1567 datë 14.10.2019.
KPP me Vendimin nr.1597, datë 09.10.2019 ka vendosur të lejoj Bashkinë Libohovë tëpërfundoj procedimin administrativ për çështjen objekt prokurimi, për shkak të tërheqjes nga konkurrimi të OE "B-I" sh.p.k.
Nga ana e KVO në datën 15.10.2021 është hartuar Raporti Përfundimtar ku është shpallur fitues OE "2T". Për këtë procedurë nuk ka ankimim të mëtejshëm në KPP. Si e tillë është proceduar sipas LPP vazhdimi i procedurës.

4. Për prokurimin me objekt "**Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë"**, viti 2020, procedura "E Hapur", FL 264,733,113.6 lekë, shpallur fitues BOE "ED K." sh.p.k, "N." shpk, "F." shpk me ofertën 263,946,164 lekë pa TVSH dhe 316,735,397 lekë me TVSH.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë"		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 3, datë 07.03.2020	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave**

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur"	Urdhër Nr. 22 dt. 02.02.2020 1. J.R (Kryetar) 2. G.C (Anëtar) 3. K.R (Anëtar)	Urdhër Nr. 21 dt. 02.02.2020 1. B.P (Kryetare) 2. FM (Anetar) 3. E.L (Anetare)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 264,733,113.6 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 263,946,164 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 786,946 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.04.2020 09:00	**9.Burimi Financimit** MBZHR-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE 1. C. shpk 2. B. shpk 3. B 93 shpk 4. BOE ED K. **b)** S'kualifikuar 3OE **c)** Kualifikuar 1 OE BOE ED K. shpk
11.Ankimime **AK**-s'ka **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës AK-s'ka**	**14. Kontrata** Nr.626 prot, datë 11.05.2020

a. Mbi programimin e nevojave

Nga auditimi ka rezultuar se për këtë procedurë ka bashkëpunim midis strukturave përkatëse, për kryerjen e procedurave dhe ndjekjen e hapave për planifikimin e fondeve referuar nevojave. Si e tillë me shkresën "Kërkesë për investim në rrjetin e ujësjellësit" nr.185, datë 13.12.2018, Ujësjellës Kanalizime Libohovë sh.a drejtuar Bashkisë Libohovë ku evidentohet domsdoshmëria e ndërhyrjes për rehabilitimin e linjës së shpërndarjes së ujesjellësit në qytetin e Libohoves, për të vazhduar me përpunimin e të dhënave në nivel institucional, me qëllim planifikimin e burimeve të financimit, nëpërmjet planifikimit të tyre në PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit.
Ky veprim është kryer sipase kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së PBA-së, të njësive të vetëqeverisjes vendore", në pikën 26 Përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues të njësisë së vetëqeverisjes vendore,

b. Mbi verifikimin e shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Tabela nr. C/2 "Projektet dhe burimi i financimit"

Nr.	Emërtimi	Viti 2020			
		Parashikim	Burimet e financimit		
			PBA 2019-2021	Buxheti i shtetit 2020	Të ardhurat e veta
1	Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë	318,551,510	-	63,586,827	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Libohovë

2. Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë

Burimi i financimit është nga të ardhurat e Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, fond i shpërndarë nga programi "Furnizimi me ujë dhe kanalizime" të alokuara në buxhetin e vitit 2020 me shkresën nr.424, datë 11.02.2020 në shumën 318,551,510 lekë vlerë totale investimi nga të cilat 63,586,827 lekë është financuar për vitin 2020 me shkresën e MIE nr.493, datë 14.02.2020 cili nuk ka kaluar në Këshillin Bashkiak për miratimin në parim të fondit për investim.
Urdhër prokurimi nr.3, datë 07.03.2020.
Fillimi (nxjerrja e urdhër prokurimeve) dhe kryerja e procedurave të prokurimit publik, është realizuar pas miratimit dhe angazhimit të fondeve publike, për financimin e projekteve për punë publike, të zhvilluara gjatë vitit 2020, me burim financimi nga të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

c. Mbi auditimin mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

Mbi administrimin e dosjeve nga NJP

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për procedurën e audituar, nga ku rezultoi se:

Në përgjithësi nga Juristi i prokurimeve, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t'u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, Nga ana e Juristit të prokurimeve është administruar dhe inventarizuar dosja e prokurimit. Pjesë e dosjeve (me përjashtim të kërkesës për angazhim të fondeve) ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Sa më sipër, Juristi i prokurimeve ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit", pika 3.

Mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit)

Titulli i gjetjes 26: Mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit)

Në lidhje me përllogaritjen e vlerës limit të kontratës u konstatua se NJP ka hartuar Urdhërin e prokurimit për fondin limit 264,733,113.6lekë, referuar preventivit të hartuar nga Shoqëria"Z. &C." shpk për shumën 313,818,321 lekë dhe 376,581,985.2 lekë me TVSH. Shoqëria "Z.&C." shpk ka licencë në projektim të veprave të tilla me N.0433/18 dhe Ing.P.P me licencë në projektim E.0123/4. Gjatë verifikimit të çmimeve për punimet e paraqitura në preventiv, u konstatua se përllogaritja e tyre është bërë sipas Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të Tyre miratuar me VKM nr. 629 datë 15.7.2015, ndryshuarme VKM nr. 631, datë 26.10.2018. Përllogaritja e vlerës totale të FL ka pasaktësi njerëzore në mbledhjen e zerave të punimit. Si e tillë shuma totale e përllogaritur nga "Z.&C." shpk është 264,733,114 lekë dhe 317,679,736.80 lekë me TVSH. Për të konstatuar përllogaritjen e FL përparanxjerrjes së urdhërit të prokurimit, grupi i auditimit shqyrtoj evidencat e siguruara nga Bashkia Libohovë në të cilën rezultoj se:

Situata: Projekti i Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" është realizuar dhe më pas dhuruar nga shoqeria "Z.&C." shpk për Bashkinë Libohovë nëpërmjet nënshkrimit të Akt-Marrëveshje Dhurimi ndërmjet Bashkisë Libohovë dhe shoqërisë "Z.&C." shpk me objekt dhurimi projektin e "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë". Në këtë Akt-Marrëveshje Dhurimi mungojnë elementët thelbësorë si numër protokolli, data e nënshkrimit si dhe vlera e shërbimit tëkryer. Për marrjen e këtij studimi, titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktivit dhe inventarizimin e tij në kartelat e aktivit, si e tillë mungon akti i marrjes në dorëzim të mallit i cili duhet të shoqëronte ank-dhurimin. Për këtë studim, mungojnë dokumentacioni shkresor i protokolluar mbi kërkesat e sektorit të fushës të cilët të kenë konstatuar problematikën teknike si dhe korespodencat shkresore të titullarit të institucionit Bashkia Libohovë, mbi nevojën apo domosdoshmërinë e studimit për t'u kryer nga palë të treta, për të cilat bashkia nuk ka mundësinë të paguaj. Ky studim rezulton i pa rregjistruar në Pasqyrat Financiare të Bilancit për vitet 2020 dhe 2021 si dhe i paevidentuar në kartelat e aseteve "analitike e llogarisë 202".

Kriteri: Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pika 42 ,43 dhe 56 ku cilësohet:

Ndikimi/Efekti: parregullsi në evidentimin e saktë financiar dhe ligjor të aktiveve.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore dhe nënligjore, mungesë e theksuar profesionalizmi e strukturave të menaxhimit të aktiveve.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Lbohovë në cilësinë e NA si dhe NZ të verifikojnë dhe plotësojnë praktikën dokumentare për marrjen në dorëzim të Projektit të Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" të dhuruar nga shoqeria "Z.&C." shpk si dhe të procedojnë me regjistrimin e tyre në librat kontabël.

Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit

Titulli i gjetjes 27 : Mbi përcaktimin dhe argumentimin e kritereve kualifikuese nga Njësia e Prokurimit.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin mbi miratimin e DST, datë 07.03.2020.
Situata 1: NJHDT ka listuar kërkesat për plotësimin e kapacitetit ligjor/profesional të OE, për kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe për atë teknik ku ndër të tjera ka kërkuar:

- Për plotësmin e kapacitetit ekonomik dhe financiar Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Libohovë. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

Ky kriter është i përcaktuar në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit financiar të OE. Paraqitja nga OE i vërtetimit mbi shlyerjen e detyrimeve vendore në bashkinë ku do të zhvillohet procedura e prokurimit, paraprakisht shmang barazinë në tender dhe shmang anonimitetin e OE përpara aplikimit të tyre në SPE. Sigurimi paraprak nga ana e OE të një dokumentacioni të tillë, shmang konkurrencën dhe barazinë në tender duke i përjashtuar për të hyrë në tender. Për vendosjen e këtij kriteri, NJHDT nuk ka faktuar në procesverbal argumenta teknike dhe ligjore mbi domosdoshmërinë e saj në përmbushje të objektit të prokurimit.
Kriteri: Ligji "Për prokurimin publik" Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenin 46, pika c), neni 1, pika ç dhe d, nenin 20 Mosdiskriminimi VKM nr.914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 61, pika 2, ku cilësohet:
Situata 2: Për plotësmin e kapacitetit teknik OE duhet të ketë punë të ngjashme të realizuar në një kontrate të vetme në një vlerë jo më e vogel se 50 % e FL, të realizuar gjatë tri viteve (nga data e afatit të dorëzimit të ofertave deri në 3 vite para këetij afati) të fundit, ku zerat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.
Vendosja e këtij kriteri është në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit teknik sepse nuk ka sesi të jetë e kuptimtë që në një periudhë të mëparshme të jenë specifikisht zërat e punimeve sipas procedurës së prokurimit që do të zhvillohen në një periudhë të ardhme.
Kriteri: VKM nr.914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 26, pika 6,b, ku cilësohet:
Situata 3: Për plotësimin e kapacitetit teknik OE duhet që për të provuar se ka përvojën e duhur, të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 250 (dyqind e pesëdhjetë) punonjës me kohë të plotë, për periudhën Janar 2019–Janar 2020.
Në proces verbalin për miratimin e dokumentave standarde të tenderit NJHDSTnuk ka dhënë asnjë argument teknik dhe ligjor i dokumentuar mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve të OE si më sipër dhe pamundësinë e kryerjes së objektit të prokurimit me më tepër apo më pak punonjës/punonjës të. Për këtë shkak nuk mund të gjykohet nëse kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës.
Kriteri: VKM nr.914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 61, pika 2, neni 26, pika 5,

Situata 4: Për plotësimin e kritereve specifike ne kualifikim kërkohet :
Stafi i drejtuesve teknik i shoqerisë të ketë në përbërje:

Inxhinier Mjedisi 2 (dy) nga të cilët një të jetë me profil për trajtimin e ujerave dhe një të jetë i pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.

- Të ketë të punësuar staf mbështetës:
  1 inxhinier telekomunikacioni
  1 inxhinier mjedisi
  1 **ekspert të Auditimit të energjisë** që të paraqitet kontrata noteriale e punës dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH,të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit;
- Të ketë certifikata sigurie:
  a) ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor);
  b) ISO 39001 (Certifikate për sistemin e menagjimit të sigurisë në trafikun rrugor)
- Të ketë mjetet
  Rimorkiator per levizjen e mjeteve Në pronësi ose me qira Copë 2
  Pajisje hidrombjellje Në pronësiose me qira Copë 1
- Deklaratë nga administratroi i shoqërisë që merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakort që të paraqesi pranë AK mjetet dhe pajisjet e kërkuara më sipër, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit.
- OE duhet të paraqesë kontratë furnzimi për tubo HDPE dhe PVC, plastike sipas prevntivit, kontrata e tubove të jetë e shoqëruar me kontratë furnizimi, katalogun, ISO 9001-2008, të dhënat teknike, makineritë e prodhimit të tubove.

OE I cili merr pjese në këtë procedurë prokurimi nuk është prodhuesi i pjesëve të mësipërme, si i tillë sigurimi i certifikatave të tilla është në tejkalim të realizimit të punimeve objekt prokrimi.

- QKB,certifikata e cilësisë së provës,KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteveplastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes).
- QKB, certifikata e cilesisë së provës, KODI III.1.A (prodhimi i produkteve).
- Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012.
- Në perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:
  - Hekur;
  - Pompa;
  - Tuba;
  - Pajisjehidraulike;
  - Pasjisjeelektrike;
  - Matesa uji;
  - Bojra;

  Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Operatori ekonomik të paraqesë katalogjet perkatëse për secilin nga produktet/mallrat e mësipërme. Gjithashtu O.E. të paraqes deklaratë garancie jo më pak se 1 vit nga momenti i marrjes në dorëzim.

Kriteri: nenin 46, neni 1, pika ç dhe d, të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2, neni 26, pika 3 dhe pika 5

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor, grupi i auditimit konstatoj se Procesverbali i hartimit të kritereve të kualifikimit si edhe të dokumenteve standarte të tenderit, është i nënshkruar vetëm nga 2 anëtarë konkretisht, Kryetari i NJP z.J.R dhe anëtari i saj z.K.R. Njëherësh edhe formati shtojca nr.1 e deklaratës së konfliktit të interesit të anëtarëve të NJP është i nënshkruar vetëm ngakëta 2 anëtar të saj konkretisht z.J.R dhe z.K.R. Anëtari tjetër i NJP nuk kanë marrë dijeni shkresorepër prezencën e tij si anëtarë në NJP me objekt prokurimi "Rikonstruksioni i ujësjellësit të qytetittë Libohovës", si dhe nuk ka qenë prezent në momentin e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit. Panvarësisht këtij fakti titullari i AK ka lejuar vazhdimin e procedurës për ngritjen e grupit të vlerësimit të ofertave.

Ndikimi/Efekti: Përcaktimi i kritereve jo të qarta, jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe kritereve të panevojshme, ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë, por dhe në mos përmbushjen e kritereve nga ana e tyre për shkak të pa qartësive.
Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore, nënligjore dhe DST nga ana e NJP.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP), për çdo rast në përcaktimin e kritereve kualifikuese, duhet të:
- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim;
-nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Znj. L.M. me detyrë, Kryetare e Bashkisë Libohovë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktual;
2. Z. J.R. me detyrë, Jurist, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit;
3. Z. K.R., në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë 1069/20 prot datë 10.12.2021 dërguar me shkresë nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z. J.R me detyrë Jurist dhe përson përgjegjës i prokurimeve, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
1. Sqarojme se vendosja e ketij kriteri eshte e mbeshtetur ne "Ligjin Nr.9632 date 30.10.2006 Per sistemimin e taksave vendore i ndryshuar" ku percaktohet se "4. Pagesat e késteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti"
Nje vertetim i kerkuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit i sherben Autoritetit Kontraktor se operatoret ekonomike konkurues ne kete gare i kane shlyer te gjitha detyrimet e parashikuara ne "Ligjin Nr.9632 date 30.10.2006 Per sistemimin e taksave vendore i ndryshuar" ndaj Bashkise

Libohove. Persa I perket pretendimit te KLSH se kjo kerkese shmang barazine dhe anonimitetin nuk qendron pasi nje vertetim I tille I leshohet subjektit qe ne momentin e pageses se kestit te maturuar. Paraprakisht ne "Ligjin Nr.9632 date 30.10.2006 Per sistemimin e taksave vendore i ndryshuar" parashikohet se kestet e maturuara paguhen brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. Procedura ne fjale eshte zhvilluar ne Prill te vitit 2020. Pra Operatoret ekonomike mund te pajiseshin me vertetim te tille nga Janari deri ne Prill.

2. Kerkesa e tille eshte percaktuar nga Autoriteti Kontraktor per te mbeshtetur dhe garantuar zbatimin e plote te kontrates duke kerkuar qe punet e meparshme te plotesojne kriteret minimale te preventivit objekt prokurimi. Ne vendosjen e ketij kriteri nuk ka as diskriminim as pabarazi pasi nje pershkrim i tille i ketij kriteri i eshte referuar totalisht objektit te kesaj kontrate dhe dosjes teknike te objektit dhe eshte vendosur per te bere sqarim sa me te sakte te operatoreve qe punet e ngjashme duhet te jene sipas objektit te procedures ne fjale dhe preventivit te ketij objekti. Pra perkatesisht punet e ngjashme duhet te jene ne perputhje me preventivin e prokuruar si dhe ne mbeshtjetje te legjislacionit ne fuqi.

3. Bejme me dije se kemi te bejme me nje objekt i cili ka nje volum te konsiderueshem te punimeve sic eshte percaktuar edhe ne preventivin dhe dosjen teknike te objektit si dhe kerkesa per perfundimin e tyre ne nje afat te shkurter.

4.Theksojme se kemi te bejme me punime te cilat gjate zbatimit te tyre sjellin mbetje dhe materiale te cilat kosniderohen te rrezikshme per komunitetin perreth. Persa i perket mbetjeve inerte eshte vete investitori qe duhet te largoje nga sheshi i ndertimit mbetjet e ngurta qe do te krijohen. Ku ne kete raste eshte sipermarresi i punimeve qe do te largoje mbetjet inerte qe do te gjenrohen ne vendin qe do te pervaktoje Bashkia Libohove. Kerkesat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, perfshijne specifikimin e kushteve, normave e standarteve te detyrueshme per mbrojtjen e pastertise se ajrit urban , te ujerave siperfaqesore e nentokesore, te cilesise e vlerave te tokes, te territoreve urbane, rrugeve, trotuareve , zonave te gjelberuara. Drejtues te subjektit i cili do te vihet ne shfrytezim,do te marrin ne konsiderate te gjitha masat lehtesuese zbutese per ndikimet ne mjedis.

5. Ky kriter eshte kerkuar nga Autoriteti Kontraktor pasi ne preventivin e punimeve perfshihen zera qe perfshijne sistemin SCADA si dhe eshte I nevojshem ekspertiza profesionale e inxhinierit telekomunikacionit per rrjetin e fibrave optike qe ndodhen ne rrjetin e infrastruktures rrugore ku do te behen nderhyrje. Prania e Audituesit Energjetik gjate zbatimit te kontrates synon të rrisë standardet e performancës së auditimit të energjisë në ndërtesa dhe Impiante dhe përmirëson praktikën e menaxhimit të energjisë nëpërmjet aplikimit të metodologjive kombëtare dhe ndërkombëtare të llogaritjes së performancës energjetike dhe pajisjeve inovative në këtë sektor. Nje profil I tille pune ka për qëllim diagnostifikimin energjetik të ndërtesave, në grumbullimin dhe analizimin e parametrave relative ndaj konsumeve specifike dhe kushteve të komfortit termik të ndërtesës dhe impianteve të saj.

<u>Oëndrimi i Grupit të auditimit:</u>

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Për vendosjen e këtij kriteri, NJHDT nuk ka faktuar në procesverbal argumenta teknike dhe ligjore mbi domosdoshmërinë e saj në përmbushje të objektit të prokurimit. Ky kriter është i përcaktuar në tejkalim të përcaktimit ligjor mbi vërtetimin e kapacitetit financiar të OE sepse AK për një argument të tij mund të kërkonte vetëdeklarimin nga OE pjesëmarrës dhe në procesin e vlerësimit të ofertave të shyrtonte shlyerjen e tyre në databazën e vetë. Ju theksojmë se anonimati i pjesëmarrjes në tender me domosdoshmërinë e këtij vërtetimi paraprak shuhët, si dhe shmang ata OE që në aktivitetin e tyre të kënë vepruar në qarqe dhe bashki të tjera. Edhe argumenti se OE

mund të pajisej me vërtetim deri në 20 Prill është e pasaktë, sepse OE nuk ka dijeni paraprake se do të zhvillohej tenderi përkatës, si e tillë pretendimi juaj nuk qëndron.
2. Nuk ka sesi të jetë e kuptimtë që në një periudhë të mëparshme të jenë specifikisht zërat e punimeve sipas procedurës së prokurimit që do të zhvillohen në një periudhë të ardhme në kufijtë monetar që vendos AK, si e tillë pretendimi juaj nuk qëndron.
3. Në proces verbalin për miratimin e dokumentave standarde të tenderit NJHDST nuk ka asnjë të dhënë si argument teknik dhe ligjor i dokumentuar mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve të OE si më sipër dhe pamundësinë e kryerjes së objektit të prokurimit me më tepër apo më pak punonjës/punonjës të. Për këtë shkak nuk mund të gjykohet nëse kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës. Përllogaritja e numrit të punonjësve për realizimin e objektiti të prokurimit ndjek formulën përkatëse e cila nuk justifikohet me shifrën që ju si AK citoni. Pra nr i punonjësve është totalisht i pabazuar, si e tillë pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.
4.Vendosja e këtij kriteri i kalon kopetenct e realizimit në sasi dhe me cilësi të puimeve, sepse Drejtuesi si investitor, për volumin e punimeve që kërkojnë të realizojnë dhe eksperiencën që ju kërkoni, nuk legjitimohet të kënë ekstra edhe ing. e mjedisit për standartë të cilat ata tashmë i plotësojnë.
5.Këto argumenta tejkalojnë objektin e prokurimit duke qëne se vetë ligji për auditimin e energjisë ka një kohë të shkurtër tek i cili kanë dalë aktet normative. Mospasja e audituesi të energjisë nuk cënon objektin e prokurimit , sepse një auditues i tillë lidhet më objektet dhe jo me sistemet e ujësjellësave në ndërtim sic ju keni prokirimin. Si e tillë pretendimi nuk merrët në konsideratë.

Mbi vlerësimin e ofertave të OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO)
Procedura e prokurimit është hapur nga KVO me procesverbalin e datës 13.04.2020. Në të kanë marrë pjesë 4 OE. Në procesverbalin e hapjes së ofertave datë 18.04.2020 KVO ka vlerësuar në fazën e parë OE sa më poshtë vijon:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO-së		
			Brisilda Ponde	Esmeralda Lile	Foto Mangllara
1	"C."shpk	0 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
2	"B." shpk	0 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
3	"B 93" shpk	265,341,981 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'kualifikuar
4	BOE "ED. K." shpk, "N." shpk, "F." shpk	263,946,164 lekë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar

Arsyeja e s'kualifikimit OE "C." shpk dhe OE "B." shpk nuk kanë paraqitur dokumentacion për kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. OE "B. 93" shpk ka paraqitur ofertë ekonomike mbi vlerën e fondit limit.
Ankimime pranë AK apo KPP nuk ka.
Nga ana e KVO në datën 28.04.2020 është hartuar Raporti Përfundimtar ku është shpallur fitues BOE "ED K." shpk, "N." shpk, "F." shpk me ofertën ekonomike më të ulët 263,946,164 lekë.

5.Për prokurimin me objekt **"Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë"**, viti 2020, procedura "Kërkesë për propozim", Fond limit 3,429,847.5 lekë, shpallur fitues "Z.&C." sh.p.k me ofertën 2,983,337 lekë pa TVSH dhe 3,580,004.4 lekë me TVSH.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë"

1.Urdhër Prokurimi Nr. 5, datë 15.04..2020 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Kërkesë për propozim"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 22 dt. 02.02.2020 1. J.R (Kryetar) 2. G.C (Anëtar) 3. K.R (Anëtar)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 21 dt. 02.02.2020 1. B.P (Kryetare) 2. F.M (Anetar) 3. E.L (Anetare)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,429,847.5 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 2.983.337 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 446,510.5 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 28.04.2020 09:00	**9.Burimi Financimit** MBZHR-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender Numër 13OE **b)** S'kualifikuar 12OE **c)** Kualifikuar 1 OE "Z.&C." shpk
11.Ankimime **AK**-s'ka **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës AK-s'ka**	**14. Kontrata** Nr.734 prot, datë 27.05.2020

d. Mbi auditimin mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

Mbi administrimin e dosjeve nga NJP

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për procedurën e audituar, nga ku rezultoi se:

Në përgjithësi nga Juristi i prokurimeve, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t'u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, Nga ana e Juristit të prokurimeve është administruar dhe inventarizuar dosja e prokurimit. Pjesë e dosjeve (me përjashtim të kërkesës për angazhim të fondeve) ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Sa më sipër, Juristi i prokurimeve ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, "Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit", pika 3.

Mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit)

Titulli i gjetjes 28: Mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit)

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" u konstatua se dokumentacioni i analizes mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe procesverbali i mbajtur për këtë qëllim nuk janë në dosjen e NJP.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 57, pika 4 dhe neni 59, pika1

Ndikimi/Efekti: Mungesa e justifikimit ligjr të përllogaritjes së fondit limit, sjellë përdorim me efekt negativ të fondeve publike dhe mungesë menaxhimi me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të këtyre fondeve.

Shkaku: Mos përmbushje të detyrave funksionale të NJP

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Libohovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos dokumentimin dhe mungesën e përllogaritjes së vlerës së kontratës, nga NJP bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet referuar fondit limit të Urdhërit të prokurimit prej 3,429,847.5 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. K.R., në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit;
2. Z. J.R. me detyrë, Jurist, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit;

Mbi hartimin e Dokumenteve të Tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit

Titulli i gjetjes 29 : Mbi përcaktimin dhe argumentimin e kritereve kualifikuese nga Njësia e Prokurimit.

Dokumentet e tenderit janë hartuar me procesverbalin mbi miratimin e DST, datë 15.04.2020.
Situata: NJHDT ka listuar kërkesat për plotësimin e kapacitetit ligjor/profesional të OE, për kapacitetin ekonomik dhe financiar si dhe për atë teknik ku ndër të tjera ka kërkuar:

- Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar per kryerjen e sherbimit objekt i kesaj kontrate. Ai duhet te disponoje pikat e meposhtme te licenses per mbikeqyrje punimesh:
  NP 1 - Punime për prishjen e ndërtimeve.
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO
  Çertifikate per menaxhimin e mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme).

Ndërkohë në preventimin e punimeve nuk parashikohet një zë i tillë. Për vendosjen e këtij kriteri, NJHDT në hartimin e procesverbalit nuk ka faktuar asnjë argument teknike dhe ligjor mbi domosdoshmërinë e saj në përmbushje të objektit të prokurimit.
Kriteri: LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, pika ç dhe d, nenin 20 Mosdiskriminimi, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 2. neni 61, pika 2
Ndikimi/Efekti: Përcaktimi i kritereve jo në përputhje me aftësinë zbatuese, natyrën dhe objektin e kontratës si dhe kritereve të panevojshme, ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë, por dhe në mos përmbushjen e kritereve nga ana e tyre për shkak të pa qartësive.
Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore, nënligjore dhe DST nga ana e NJP.
Rëndësi: E lartë
Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP), për çdo rast në përcaktimin e kritereve kualifikuese, duhet të:
- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim;
-nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1 Z. J.R. me detyrë, Jurist, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit;
2 Z. K.R. me detyrë, specialist inxhinier ndërtimi në sëktorin e shërbimeve mjedisore, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë 1069/20 prot datë 10.12.2021 dërguar me shkresë nr. 1069/29 Prot, datë 10.12.2021, protokolluar në KLSH me nr.871/5, datë 13.12.2021 "Mbi Projektraportin e Auditimit" nga z. J.R. me detyrë Jurist dhe përson përgjegjës i prokurimeve, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

1. Sa I perket ISO 14001 – 2015 eshte argumentuar tek kerkesa per pranine e inxhinierit te mjedisit si dhe domosdoshmerine per zbatimin e punimeve ne mbeshtetje te plote te ndikimit ne mjedis.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Nuk jepni asnjë evidencë teknike dhe ligjore apo të dhënë shtesë mbi domosdodhmërinë e këtij kriteri, si e tillë pretendimi juaj nuk merrët në konsideratë.

Mbi vlerësimin e ofertave të OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO)
AK ka ftuar për të marrë pjesë 5 (pesë) operatorë ekonomikë me objekt aktiviteti mbikëqyrje punimesh. Procedura e prokurimit është hapur nga KVO me procesverbalin e datës 28.04.2020. Në të kanë marrë pjesë 13 OE. Në procesverbalin e hapjes së ofertave datë 18.04.2020 KVO ka vlerësuar në fazën e parë OE sa më poshtë vijon:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO-së		
			Brisilda Ponde	Esmeralda Lile	Foto Mangllara
1	"Z. & C." shpk	2.983.337 lekë	Kualifikuar	Kualifikuar	Kualifikuar
2	"6D P." shpk	3.018.930 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
3	"A. E." shpk	2.985.000 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'kualifikuar
4	"A. MK" shpk	2.983.337 lekë	Kualifikuar	Kualifikuar	S'Kualifikuar
5	"B. P." SHPK	2.982.921,6lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
6	"GB C. E." shpk	3.014.263,63 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
7	"GJ. & CO" shpk	3.001.116,5 lekë	Kualifikuar	Kualifikuar	S'Kualifikuar
8	"GR A." shpk	2.982.922,5 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
9	"I. D.- ALB"shpk	2.982.922,18 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
10	"M. S." shpk	3.014.300 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
11	"N. S." shpk	3.061.373,6 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
12	"SRP A. E." shpk	2.982.922,36 lekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar
13	"HMK-C."shpk	2.500.000 ekë	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar	S'Kualifikuar

Arsyeja e s'kualifikimit
- BOE GR A. dhe A. shpk nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrimevetë maturuara të energjisë në të cilën të jetë e përfshire edhe muaji Mars 2020. Gjithashtu të dyjavërtetimet për të dyja subjektet janë jashtë afatit 30 ditor në të cilën të jetë e përfshire edhe datae zhillimit së kësaj procedure, përkatësisht data 28.04.2020; OE GR A. shpk kaparaqitur deklaratat të cilat plotësohen nga OE të pa vulosura; BOE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrimeve tatimore; nuk plotëson kapacitetin teknik për shërbime të ngjashmeme 40% të vlerës së prokurimit.
- BN P. SHPK; Oferta Ekonomike është nën vlerën minimale të fondit limit minimal
- HMK C. SHPK; Oferta Eekonomike është nën vlerën minimale të fondit limit minimal
- SRP SHPK; Oferta Ekonomike është nën vlerën minimale të fondit limit minimal
- 6D P. SHPK; OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrimeve të maturuara të energjisë në të cilën të jetë përfshirë muaji Mars.Vërtetimi i paraqitur është jashtë afatit 30 ditor,datë në të cilën të jetë e perfshirë edhe dita e hapjes së kësaj procedure.Vërtetimi mban

datën 24.03.2020.;OE nuk ka paraqitur kontratë qeraje të noterizuar për pajisje GPS.;OE ka paraqitur dokumentacion të subjektit "T."shpk, subjekt ky për të cilën OE "6D P." shpk ,nuk ka realizuar bashkim operatoresh.O E nuk ka paraqitur kontratë pune për inxhinierin hidroteknik L.H.

- 6-ASH E. SHPK; OE nuk plotëson kapacitetin teknik përkatësisht shërbime të ngjashme me vlerë 40% të vlerës që prokurohet; OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrime të maturuara të energjisë në të cilën të jetë përfshirë muaji Mars vërtetimi është jashtëdatës së afatit të hapjes së procedurës,perkatësisht mban datën 23.03.2020.
- GB C.; OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrime të maturuara të energjisë nëtë cilën të jetë përfshirë muaji mars.vërtetimi është jashtë datës së afatit të hapjes së procedurës, përkatësisht mban datën 26.03.2020; OE nuk plotëson nr minimal të punonjësve tësiguruar për periudhën Janar 2019-Janar 2020 prej minimumi 10 punonjës.; Nr mesatar i të punësuareve për këtë periudhë është 9.
- I. D. SHPK ;Vlera e ofertuar është më e ulet se vlera minimale e fondit limit; OE nuk ka paraqitur Licencën përkatëse për procedurën e prokuruar; OE nuk ka paraqiturcertifikatat ISOO; Nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrimeve të maturuara të energjisë për muajin Mars 2020.Vërtetimi është jashtë afatit 30 ditor nga data e zhvillimit të kësaj procedure.
- N. SHPK; OE nuk disponon as në pronësi dhe as me kontratë qeraje pasijet GPS dhe TOTAL STATION
- M. S. SHPK; OE ka paraqitur deklaratën për paraqitje oferte të pavarur,përkatesishtëShtojsa 1/1 pika 6 të pa plotësuar.OE nuk ka perzgjedhur asnjë nga alternativat e përcaktuara në këtë deklaratë; OE nuk ka të përfshirë në vërtetimim e shlyerjeve të maturuara të energjisë muajin e fundit përkatësisht muajin Mars 2020.
- A. MK; Operatori Ekonomik duhet të ketë të përfshirë në licensën e shoqërisë : ing ndertimi (kontrata e firmës me inxhinierin e ndërtimit dhe diploma e tij).
- GJ. & CO; Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në licencen eshoqërisë : ing mekanik (mungojnë kontrata diploma licenca dhe cv).

Ankimime pranë AK apo KPP nuk ka.

Nga ana e KVO në datën 19.05.2020 është hartuar Raporti Përfundimtar ku është shpallur fitues "Z.&C."shpk me ofertën ekonomike më të ulët 2.983.337 lekë.

D. Të ndryshme të dala gjatë auditimit - Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Auditimi i fundit në Bashkinë Libohovë është kryer në vitin 2019 për periudhën 01.01.2017-30.06.2019, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën 369/9 datë 26.09.2019, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 806/38, datë 30.09.2019. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej: **19** masa organizative, **7** masa shpërblim dëmi me vlerë **4,615,166 lekë**, **4** masa disiplinore**,** dhe **1** Masë Administrative, që Kryetari i Bashkisë Libohovë t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrës, i janë rekomanduar APP **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) për 12 persona në raport me shkeljet e konstatuara, dhe me rekomandimin e autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 8 **persona,** për shpenzime në kundërshtim me **3 E-të është** rekomanduar që të analizohet vlera **128,995,868 lekë.**

1. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j "hartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit", Bashkia Libohovë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 369/9 datë 26.09.2019 ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 806/40 prot. datë 27.02.2020, pra jashtë afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Bashkia Libohovë ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe personat përgjegjës sippas llojit të rekomandimit.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2[21], rezulton se, nga Bashkia Libohovë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së me shkresën nr. 806/44 datë 17.03.2020**,** pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit.

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH

Sikurse është cituar më lart, Bashkia Libohovë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 806/44 datë 17.03.2020, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5[22].

4. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Libohovë

Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 31, pika 3, kryen auditimin e zbatimit të rekomandimeve në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit. Përkatësisht në zbatim të këtij detyrimi KLSH ka zhvilluar në Bashkinë Libohovë auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 610 Prot, datë 25.06.2020 dhe autorizimin nr. 610/4 Prot, datë 26.06.2019, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Libohovë 19 masa organizative, nga ku rezulton se janë zbatuar plotësisht 13 masë organizative, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative, respektivisht rekomandimi 1.1, 8.1 dhe 16.1.

1. Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" dhe llogaria 211 "Pyje, Kullota Plantacione" për vitin 2017 dhe 2018 kanë vlerën zero lekë në aktivin e pasqyrave financiare, duke mos u paraqitur vlera e vërtetë e pasurisë së institucionit. Në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", dhe në llogarinë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", nuk janë përfshirë asetet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat janë transferuar në pronësi të saj me VKM nr. 415, datë 11.07.2007

[21] "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

[22] Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5, "Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij".

"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës", VKM nr. 706, datë 12.10.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Zagorie, të Qarkut të Gjirokastrës", si dhe VKM nr. 272, datë 21.04.2010 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës", VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive". Këto asete nuk janë regjistruar në pronësi të Bashkisë Libohovë dhe në këto kushte llogaria 210 "Toka, troje, terrene" dhe llogaria 211 "Pyje, Kullota Plantacione", nuk paraqet vlerën reale të pasurisë së institucionit. Për pasuritë e dy llogarive të mësipërme nuk ka plan menaxhimi nga njësia vendore me qëllim rregjistrimin e tyre në ZVRPP.

1.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa për hartimin e një plani menaxhimi për pasuritë e mësipërme me qëllim evidentimin e statusit të tyre juridik, rregjistrimin në ZVRPP dhe pasqyrimin në kontabilitet të numrit dhe vlerës së këtyre aseteve.

8. Gjetje nga auditimi: Nga sektori i financës për vitin 2017 dhe 2018 nuk është mbajtur ditar i blerjeve, por vetëm ditar dhe libër magazine, duke mos rregjistruar dhe kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe progresive të gjithë veprimtarinë e blerjeve të institucionit, por vetëm atë veprimtari që lidhet me blerjen e mallrave (jo shërbimet dhe punimet). Për shërbimet dhe punimet janë mbajtur rregjistrime të përkohshme (por jo në forme kontabiliteti). Nuk është mbajtur libër i madh për rregjistrimet përmbledhëse mujore të kontabilitetit (tepricat debitore dhe kreditore sipas llogarive). Mos kryerja e këtyre veprimeve ka sjellë edhe anomalitë e konstatuara në pasqyrat financiare për të dy vitet.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", kapitulli II, rubrika 2.2 - Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik, pika 6, rubrika 2.3 - Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik, pika 7 dhe 8, kapitulli II, rubrika 3.2, pika 43.

8.1. Rekomandim: Nga sektori i financës për vitin 2019 të hapet ditar i blerjeve, në të cilin të regjistrohen dhe kontabilizohen të gjitha blerjet që kryen institucioni, sipas kronologjisë kohore të ndodhjes, të hapet libri i madh ku të regjistrohen tepricat mujore kreditore dhe debitorë të të gjitha llogarive.

16- Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë në hartimin e buxhetit vjetor në zëri shpenzime, nuk ka të programuar për detyrimet e prapambetura, në të cilin ka diferenca të dukshme ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Treguesit e buxhetit për këtë zë me gjitha ndryshimet në total janë realizuar në periudhën raportuese 2017 në masën 60%, ndërsa për periudhënraportuese 2018 në masën 85%. Në këto tregues zëri me nivelin më të ulët të realizimit janë "*Investimet*" respektivisht në masën 54% e 76%. Programimi zërave të shpenzimeve dhe investimeve, si dhe mos realizimi kanë shkak mos realizimi të ardhurave, duke sjell mos plotësimtë nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

-Nuk është hartuar PBA për vitin 2016. Në hartimin dhe zbatimin buxhetit vjetor të vitit 2017 nuk ka rakordim me PBA e hartuar për këtë periudhë, pasi buxheti i vitit 2017 nuk ka përputhje me vitin e parë të PBA së hartuar. Njësia publike Bashkia Libohovë më datën 31.12.2018 ka fatura të pa likuiduara në vlerën totale ***16,485,845 lekë***, në të cilën janë përfshira edhe detyrimet e pa likuiduara të mbartura nga (*ish/Komunat*) gjendje e pa ndryshuar në vlerën *10,798,473 lekë* dhe

pjesa tjetër shuma *5,687,372 lekë* janë detyrime të krijuara gjatë aktivitetit të Bashkisë për periudhën 2017-2018. Veprime në mospërputhje me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe neni 52 "*Kryerja e shpenzimeve*" të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, UMF nr.5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014, si dhe UMFE (*plotësues*) nr.02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pika (82) dhe (91) "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*".

16.1. Rekomandim:

***a*-**Me qëllim që të mos krijohen diferenca të theksuara ndërmjet programimit dhe realizimit të treguesve të buxhetit, njësia publike Bashkia Libohovë të marr masa për hartimin sa më real të treguesve të buxhetimit, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Njëkohësisht në çdo periudhë buxhetore të hartohet (PBA) dhe buxhetit vjetor të ndjek parashikimin e vitit të parë të PBA.

b*-**Titullari i njësisë vendore dhe Sektori Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marr masa të plota për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale ***16,485,845 lekë, në zbatim të UMF nr.5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014,si dhe UMFE (*plotësues*) nr.02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pika (82-91) "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkisë, informacion për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të mbartura dhe të hartojë grafik për shlyerje të tyre.

***c*-**Strukturat drejtuese të njësisë vendore, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe strukturat që mbulojnë programimin e monitorimin e treguesve të buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA dhe në programin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i programimit të treguesve të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike, si dhe përmirësimin, programimin e ekzekutimin e treguesve të buxhetit të periudhës koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim efiçent të burimeve financiare, për të ruajtur stabilitetin makroekonomik e fiskal.

***d*-**Nevojitet të evidentohen saktë e drejtë konsumi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (*kostove*) sipas aktiviteteve që "*shkaktojnë*" këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme për efekt buxhetor, duke synuar minimizimin e rishpërndarjes mes zërave buxhetor brenda periudhës raportuese ushtrimore. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të ndërmarr veprime të duhura korrigjuese për përmirësim të situatës dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet e ndryshohet.

Masa për shpërblim dëmi

1. Gjetje nga auditimi: Nga Titullari i Njësisë Publike të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **4,615,166 lekë** nuk është arkëtuar. Është në proces gjyqësor 1 rekomandim në vlerën **1,218,620 lekë**. Janë nisur njoftimet për 6 rekomandime me vlerë **3,396,546 lekë** por ende skanë filluar arkëtimet.

1.1 Rekomandim: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Libohovë ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat shpërblim dëmi, të konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

Masa administrative

Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Qendror (IMTQ)

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga ana e Kryetarit të Bashkisë Libohovë nuk është vepruar për ti kërkuar Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative** "**Dënimin me gjobë**", **për mbikëqyrësit:**

1. Z. T.S, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës "Kthesa e Laboves - Labovë e Kryqit", Bashkia Libohovë, me sipërmarrës punimesh BOE "G.P.G. C." SHPK & "A-S." SHPK, sipas kontratës pa Nr. Prot, Datë 17.10.2016 me vlerë 148,369,041 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,218,620 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Z. A.K, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë", Bashkia Libohovë, me sipërmarrës punimesh OE "A. K." SHPK, sipas kontratës pa Nr. Prot, datë 08.08.2017 me vlerë 134,989,797.68 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,148,247 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

3. Z. E.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)", Bashkia Libohovë, me sipërmarrës punimesh OE "M." SHPK, sipas kontratës pa Nr. Prot, Datë 03.03.2017 me vlerë 58,181,817 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,071,155 lekë pa Tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Rekomandim: Për sa më sipër, Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Libohovë t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative** "**Dënimin me gjobë**", **për mbikëqyrësit e sipërcituar.**

Masa disiplinore

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjell me shkresën nr. 610/23 prot datë 05.10.2020, nga ana e Kryetarit së Bashkisë Libohovë, **nuk janë dhënë masë disiplinore për 4 punonjës** nga "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj" deri më "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", si më poshtë:

1. Znj. E.Ç, me detyrë përgjegjëse e sektorit ekonomik.
2. Z. Xh.S, me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore.
3. Z. F.Z, me detyrë specialist i zyrës së bujqësisë.
4. z. A.I, me detyrë specialist në sektorin e taksave dhe tarifave vendore

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit në dhënien e masave disiplinore punonjësve të sipërcituar, mbështetur në nenin 15, shkronja "c" të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "Llojet e masave

disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë, që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore sa më sipër.

Titulli i gjetjes 30: Niveli i zbatimit të rekomandimeve për masa shpërblim dëmi.

Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa për të zbatuar rekomandimet e KLSH-së për shpërblimin e dëmit në vlerën **4,615,166** lekë, si dhe nuk ka dërguar shkresë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara ndaj mbikëqyrësit të punimeve z. E. B. në objektin, "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)".

Situata: Me shkresën nr. 610/63 Prot, datë 04.12.2020, KLSH ka dërguar në Bashkinë Libohovë Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi zbatimin e rekomandime dhe kërkesën për zbatimin e rekomandimeve të konstatuara të pa zbatuara ende.

Bashkia Libohovë me shkresën nr. 944/10 Prot, datë 23.12.2020 ka dërguar në KLSH relacionin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve së bashku me planin e veprimit të miratuar nga titullari.

Nga auditimi rezulton se:

- Titullari i Bashkisë Libohovë ka nxjerrë tre urdhra për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;
  - Urdhër nr. 137, datë 14.1.2020, "Për marrjen e masave nga administrata e bashkisë për zbatimin e rekomandimeve";
  - Urdhër nr. 138, datë 14.12.2020, "Për marrjen e masave nga Sektori Juridik për nxjerrjen e akteve administrative lidhur me paditë gjyqësore";
  - Urdhër nr. 139, datë 14.12.2020, "Për marrjen e masave nga Komisioni Disiplinor"
- Në zbatim të Urdhërit nr. 138, datë 14.12.2020 Sektori Juridik ka përgatitur:
  - Kërkesë padinë me nr. 944/17 Prot, datë 10.02.2021 ndaj BOE "T-D" Shpk, & "C."Shpk, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit në vlerën 133,500 lekë. Me shkresën nr. 944/22 Prot, datë 23.02.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.
  - Kërkesë padinë me nr. 944/15 Prot, datë 10.02.2021 ndaj BOE "A." Shpk & "B. Shpk", në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit në vlerën 184,480 lekë. Me shkresën nr. 944/18 Prot, datë 23.03.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.
  - Kërkesë padinë me nr. 944/14 Prot, datë 10.02.2021 ndaj OE "A. K.", në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit nëvlerën 1,148,247 lekë. Me shkresën nr. 944/21 Prot, datë 23.03.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.
  - Kërkesë padinë me nr. 944/12 Prot, datë 10.02.2021 ndaj BOE "E." Shpk & "E." Shpk & "R." Shpk, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit në vlerën 454,464 lekë. Me shkresën nr. 944/20 Prot, datë 23.03.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.

- Kërkesë padinë me nr. 944/11 Prot, datë 10.02.2021 ndaj OE "M." Shpk, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit në vlerën 1,071,155 lekë. Me shkresën nr. 944/19 Prot, datë 23.03.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.
- Kërkesë padinë me nr. 944/16 Prot, datë 10.02.2021 ndaj OE "N.-86" Shpk, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit në vlerën 404,700 lekë. Me shkresën nr. 944/24 Prot, datë 23.03.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.
- Kërkesë padinë me nr. 944/13 Prot, datë 10.02.2021 ndaj BOE "G.P.G. C." Shpk & "Ad-S." Shpk", në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me objekt – shlyerjen e detyrimit në vlerën 1,218,620 lekë.

Me shkresën nr. 944/23 Prot, datë 23.03.2021, Bashkia Libohovë i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër duke e njoftuar që ka hequr dorë nga gjykimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

- Lidhur me zbatimin e Urdhërit nr. 139, datë 14.12.2020:
  - Është dhënë masë disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë ritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet" për znj. E. C. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Fianciar dhe Nëpunësit Zbatues, me urdhërnr. 139/1, datë 14.12.2020.
  - Është dhënë masë disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë ritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet" për z. Xh. S. me detyrë Përgjegjësi Sektorit të Inspektimit të Territorit, me urdhër nr. 139/2, datë 14.12.2020.
  - Është dhënë masë disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë ritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet" për z. F. Z. me detyrë Specialist në Sektorin e Shërbimeve Bujqësore, me urdhër nr. 139/2, datë 14.12.2020.
  - Është dhënë masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim" për z. A. I. me detyrë nëpunës i vjeljes së taksave në Sektorin e Inspektimit të Territorit, me urdhër nr. 139/2, datë14.12.2020.

Rekomandimi rezulton i zbatuar.

- Lidhur me masat e marra në zbatim të Urdhërit nr. 137, datë 14.1.2020, rezulton se nuk është dokumentuar asnjë masë që mund të jetë marrë nga strukturat e bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të tjera të KLSH-së. Nuk i është dërguar shkresë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative "Dënimin me gjobë", ndaj mbikëqyrësit të punimeve z. E. B. në objektin, "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)", me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,071,155 lekë pa Tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Libohovë ka sjellë mungesë të ardhurash nga mos shpërblimi i dëmit në vlerën **4,615,166** lekë.

Shkaku: Bashkia Libohovë ka hequr dorë nga gjykimi për të shtatë kërkesë paditë që ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ndjekjen e gjitha procedurave ligjore, për zbatimin e masave shpërblim dëmi, me qëllim arkëtimin e vlerës **4,615,166 lekë** në buxhetin e bashkisë si dhe t'i dërgojë shkresë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara ndaj mbikëqyrësit të punimeve në objektin, "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, znj. L.M në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Libohovë, znj. E.P me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Fianciar dhe z. S.F me detyrë Jurist në Sektorin Juridik.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe 2020-2022 nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A faqe 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Libohovë dhe Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e të gjitha hapave dhe procedurave në hartimin e buxhetit afatmesëm të bashkisë si dhe të dokumentojë të gjithë procesin e ndjekur.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë për periudhën nën auditim 2019-2020, nuk ka hartuar raportet periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A faqe 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë të marrë masa për të dokumentuar procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, të hartojë raportet periodike të monitorimit dhe ti dërgojë ato në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që është deklaruar në MFE për vitin 2019 me vlerë 29,705,001 lekë dhe për vitin 2020 me vlerë 8,031,744 nuk përputhet me vlerën e detyrimeve referuar tabelave analitike që administron Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Libohovë të cilat janë 47,033,495 lekë për vitin 2019 dhe 28,264,769 lekë për vitin 2020
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A faqe 26-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Libohovë të ngrejë një grup pune me qëllim analizimin, dhe regjistrimin e vlerës së saktë të detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Libohovë, si dhe të hartojë dhe miratojë planin për likuidimin e tyre.

Menjëherë

4 Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 4, nuk ka ngritur strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, e cila ka përgjegjësi për kontrollin e territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A faqe 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë në shqyrtim të gjitha mundësitë për të ngritur strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorin në Bashkinë Libohovë me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

Në vazhdimësi

5 Gjetje nga auditimi: Për llogaritë e AAJM, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të detajohet me të dhëna në mënyrë analitike, si: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia. Mungesa e inventarizimit të të gjithë AAJM vë në pah mangësi në elementët e përmbajtjes së disa rregjistrave të aktiveve afatgjata jo materiale mbi përllogaritjen progresive të amortizimit individual për secilin aktiv të llogarisë 200 si llogaritë analitike 202, llog 212, llog 213, llog 214, llog 215 dhe llog 218".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B faqe 47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohove dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:
-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 "Toka, troje terrene", 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", 212 "Ndërtime e konstruksione" 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" dhe "215 "Mjete transporti", si dhe për ngritjen e komisioneve të posaçme për asgjësimin e aktiveve.

Menjëherë

6 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020 rezultoi se llogaria. 210 "Toka, Troje, Terrene" është në vlerën 0 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik. Llogaria 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet e pandryshuar prej 0 lekë dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme , për të cilën nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik. Llogaria e aktivit 212 "Ndërtesa dhe

konstruksione" cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë Libohovë, në fund të vitit 2019 rezulton me një kosto historike 296,753,545 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike 299,205,950 lekë, llogari këto për të cilat rregjistrimi në kontabilitet është bërë pa dokumentacion justifikes. Ky fenomen ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B faqe 49-51 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimit të aseteve të marr masa për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat "Toka, Troje, Terrene,Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021 dhe në vijimësi

7 Gjetje nga auditimi: Gjatë kontrollit të përllogaritjes së amortizimit të akumuluar vjetor evidentohet së ky zë duhet ta ketë në vlerën 203,990 lekë ndërsa sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivit paraqitet 216,350 lekë duke përdorur normë amortizimi 22% dhe jo 20%, pra janë ngarkuar padrejtësisht 12,360 lekë për vitin 2020 dhe për vitin 2019 janë ngarkuar padrejtësisht për shumën 8,045 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B faqe 52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryej sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 218 Inventari ekonomik, respektivisht në vlerën 12,360 lekë për vitin 2020 dhe 8,045 lekë për vitin 2019.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2021 dhe në vijimësi

8 Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Libohovë, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 11,116,761 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5 %, ose shumën 11,116,761 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Përfundimisht për vitin 2020 Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" është mbivlerësuar për 6,629,601 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B faqe 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Libohovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" për vlerën 6,629,601 lekë duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
- Nëse subjektet nuk janë të interesuar për tërheqjen e këtyre shumave, vlerat e mbetura të kalojnë si e ardhur Bashkisë Libohovë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9 Gjetje nga auditimi: Për llog 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqësore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 0 lekë. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Libohovë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2020, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019 si dhe të likuiduara në 2021 dhe mbartur nga viti 2020, e cila përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave janë pasqyruar më pak në vlerën 4,161,050 lekë dhe detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave janë pasqyruar më pak në vlerën 106,000 **lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.B faqe 57-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" detyrimet për faturat e likujduara 4,161,050 lekë për vitin 2019 dhe 106,000 lekë për vitin 2020. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019", rezulton se formulari i deklarimit të kushteve të konfliktit të interesit (*shtojca nr.1"Formular Deklarimi"*) është firmosur vetëm nga Kryetari i NJP dhe nuk është firmosur nga dy anëtarët e tjerë. Proces verbali për agrumentimin e kritereve për kualifikim për realizimin e prokurimit publik është mbajtur më datë 02.09.2019 nga anëtarët e NJP për hartimin e dokumentave të procedurës së tenderimit (shtojca nr.11). Proces verbali është firmosur vetëm nga 1 (një) anëtar i NJP, përkatësisht Kryetari i NJP dhe nuk është firmosur nga 2 (dy) anëtarët e tjerë. Dokumentat e Tenderit janë hartuar dhe janë firmosur vetëm nga 1 (një) anëtar i NJP, përkatësisht Kryetari i NJP dhe nuk janë firmosur nga 2 (dy) anëtarët e tjerë. Nga auditimii dosjes së prokurimit dhe nga komunikimi me anëtarët e Njësisë së Prokurimit, rezultoi se dy anëtarët e NJP nuk kanë marrë dijeni në ndonjë nga format e përcaktuara në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" lidhur me nxjerrjen e Urdhrit të Prokurimit nr. 41, datë 28.08.2019 për prokurimin e fondit limit me vlerë 2,079,333 lekë pa tvsh. Konstatohet se, Titullari i AK ka lejuar vazhdimin e procedurës së prokurimit edhe me mangësitë e sipërcituara (mos firmosje e formularit të deklarimit të kushteve të konfliktit të interesit, mos firmosje e Proces verbalit për agrumentimin e kritereve dhe mos firmosje e DT nga dy anëtarët e NJP.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 62-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.2 Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit publik me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë", gjatë shqyrtimit të dosjes fizike të objektit të prokurimit, u evidentuan mangësi të cilat konsistojnë në:
- Mos vënien në dijeni, në ndonjë nga format e përcaktuara në Ligj nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, për caktimin e dy anëtarëve të NJP për këtë procedurë prokurimi;
- Në kushtet e mos pasjes dijeni, të dy anëtarët të NJP nuk kanë nënshkruar Formularin e Deklarimit mbi kushtet e konfliktit të interesit;

- Procesverbali mbi hartimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, është mbajtur vetëm me pjesëmarrjen e një anëtari të NJP, konkretisht vetëm juristit në mungesë të pjesëmarrjes së dy anëtarëve të tjerë të NJP mbi përmbajtjen e këtij akti;
- Vazhdimi i kësaj procedure prokurimi publik nga titullari i AK në kushtet kur DST është përgatitur jo nga NJP por vetëm nga përgjegjësi i saj, ka/mund sjellë hartimin e kritereve kualifikuese preferenciale, që çojnë në shmangien e OE nga pjesëmarrja në konkurim dhe është në shkelje të rregullave të prokurimit publik.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 78-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.3 Rekomandimi: Titullari i AK të marrë të gjitha masat e nevojshme që në të ardhmen ngritja e Njësisë së Prokurimit të bëhet jo vetëm në përputhje me kuadrin rregullativ, por të jetë realisht funksionale në tërësinë e saj, duke shmangur praktika ku dokumentet e prokurimit të përpilohen vetëm nga Përgjegjës i NJP, të tillë që anashkalojnë kontributin e specialistëve të fushave përkatëse në rolin e anëtarë të caktuar të NJP.

Menjëherë dhe në vijimësi

11 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019 me FL 2,079,333 lekë pa tvsh dhe "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2020 me FL 1,647,500 lekë pa tvsh, rezulton se AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e OE që ka ftuar të marrin pjesë në këto procedura, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 39, pika 4.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 64/70-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa që në rastin e zhvillimit të procedurave të prokurimit të argumentojë dhe dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë të marrin pjesë në procedurën e prokurimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

12 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese-2020", me fond limit 1,647,500 lekë pa Tvsh, me fitues BOE "T-D & 6D P." Shpk me vlerë oferte 1,588,666 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesinnë kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 71-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Bashkia Libohovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT.

Menjëherë dhe në vijimësi

13 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, për procedurën e prokurimit publik me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" me FL 30,916,666.7 lekë pa tvsh, ka mangësi të theksuara bashkëpunimi dhe bashkërendimi, midis strukturave përkatëse, për kryerjen e procedurave dhe ndjekjen e hapave për planifikimin e fondeve referuar nevojave. Nuk ka pasur bashkëpunim si brenda Bashkisë Libohovë, po ashtu edhe me Njësitë Administrative, përsa i përket mbledhjes së kërkesave reale nga strukturat, sektorët përkatës edhe të NJA mbi domosdoshmërinë dhe nevojën e këtij investimi dhe përpunimin e tyre

në nivel institucional, me qëllim planifikimin e burimeve të financimit, nëpërmjet planifikimit të tyre në PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 73-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Libohovë në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, me qëllim përmirësimin e procedurave dhe procesit të planifikimit të buxhetit, si atë afatmesëm dhe buxheteve vjetore, duhet të marrë masa që në të ardhmen të nxjerrë urdhra/udhëzime të brendshme, për përcaktimin e hartimin e PBA dhe planeve vjetore të buxhetit, duke nisur me përllogaritjen sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse të nevojave, për çdo veprimtari të njësive të vetëqeverisjes vendore, në nivel programi dhe për çdo zë të shpenzimeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Regjistri i Parashikimeve të prokurimeve publike të Bashkisë Libohovë për vitin 2020 është hartuar dhe dërguar në Degën e Thesarit Gjirokastër me shkresën përcjellëse nr. 403, datë 09.03.2020, por në tejkalim të afateve zyrtare. Buxheti i vitin 2020 është miratuar me VKB nr.120, datë 23.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Libohove 2020", konfirmuar nga prefekti Gjirokastër me shkresën nr.1814/1 prot datë 09.01.2020. Gjatë auditimit u evidentua se nuk ka evidencë në zyrën e Protokoll Arkivës së Bashkisë Libohovë mbi dërgimin e Regjistrit të Parashikimeve në Degën e Thesarit Gjirokastër të prokurimeve për vitin 2019 si dhe nuk ka evidencë mbi dërgimin e regjistrit të realizimeve të prokurimeve për vitet 2019 dhe 2020.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 74-75 të Projekt Raportit të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: NZ dhe personi përgjegjës për prokurimin publik në Bashkinë Libohovë të ndjekim me rigorozitet afatet ligjore të përgatitjes dhe dërgimit të informacionit mbi regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15 Gjetje nga auditimi: Me qëllim disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe eliminimin e rasteve të fillimit të procedurave të prokurimit publik, pa pasur fonde në dispozicion është kërkuar që Njësia e Prokurimit, duhet të posedojë përpara fillimit të procedurës së prokurimit "Kërkesën për marrje angazhimi". Nga auditimi rezultoi se në asnjë nga procedurat objekt auditimi të zhvilluara nga Bashkia Libohovë për periudhën objekt auditimi, nuk ndodhej në dosjet përkatëse "Kërkesa për marrje angazhimi" dhe konfirmimi i saj nga NA dhe NZ.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 76-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, NJP dhe Nëpunësi Zbatues me qëllim eliminimin e mundësive, për marrje angazhimesh pa fonde në dispozicion, të marrin masa të menjëhershme ku NJP, fillimin e çdo procedure prokurimi, duhet së pari ta mbështesë në Kërkesën për marrje angazhimi, nga struktura përkatëse dhe konfirmimin e saj nga NZ dhe NA. NJP, duhet të përcjellë në çdo rast Urdhër Prokurimin tek Nëpunësi Zbatues me qëllim që ky i fundit të kryejë depozitimin e tij Degën e Thesarit, përpara fillimit të procedurës, për të konfirmuar disponibilitetin e fondeve në Degën e Thesarit, për çdo objekt investimi.

Në vijimësi

16 Gjetje nga auditimi: Titullari i AK për procedurën e prokurimit ka nënshkruar një autorizim pa datë përkatëse dhe pa numër protokolli, tek e cila autorizon si Kryetar të NJP për procedurën me objekt prokurimi "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë". Si e tillë Titullari i AK në fillim të çdo viti nuk ka përcaktuar "Personin përgjegjës për prokurimet publike" sipas akteve ligjore në fuqi. Nuk ka shkresë drejtuar APP-së për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimet. Nga auditimi ka rezultuar se administrimi i Dosjeve të prokurimit është bërë nga Juristi.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Libohovë, në fillim të çdo viti të caktojë me urdhër të veçantë personin/ personat përgjegjës për prokurimin dhe ti dërgoj emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

17 Gjetje nga auditimi: Projekti i Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" si dhe të projektit "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" është realizuar dhe më pas dhuruar respektivisht nga shoqeria "H.&S.11" shpk dhe shoqeria "Z.&C." shpk për Bashkinë Libohovë nëpërmjet nënshkrimit të Akt-Marrëveshje Dhurimi, në të cilën mungojnë elementët thelbësorë si numër protokolli, data e nënshkrimit si dhe vlera e shërbimit të kryer. Titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim të aktivit dhe inventarizimin e tij në kartelat e aktivit, i cili duhet të shoqëronte akt-dhurimin. Për këto studime, mungojnë dokumentacioni shkresor i protokolluar mbi kërkesat e sektorit të fushës të cilët të kenë konstatuarproblematikën teknike si dhe korespodencat shkresore të titullarit të institucionit Bashkia Libohovë, mbi nevojën apo domosdoshmërinë e studimit për t'u kryer nga palë të treta, për të cilat bashkia nuk ka mundësinë të paguaj. Ky studim rezulton i pa rregjistruar në Pasqyrat Financiare të Bilancit për vitet 2019 dhe 2020 si dhe i pa evidentuar në kartelat e aseteve "analitike e llogarisë202".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 80-81/87-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Lbohovë në cilësinë e NA si dhe NZ të verifikojnë dhe plotësojnë praktikën dokumentare për marrjen në dorëzim të Projektit të Studimit, sëbashku me përllogaritjen e fondit limit të projektit: "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë" të dhuruar nga shoqeria "H.&S.11" shpk; "Rikonstruksioni rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" të dhuruar nga shoqeria "Z.&C." shpk, si dhe të procedojnë me regjistrimin e tyre në librat kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

18 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përcaktimin dhe argumentimin e kritereve kualifikuese nga NJP dhe miratimin e DT, në procedurat e prokurimit "Rehabilitim i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë", "Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë", "Mirëmbajtje e kanaleve kulluese, Bashkia Libohovë, viti 2019" dhe "Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë", u konstatua se nga NJHDT janë vendosur kritere kualifikuese të paargumentuara, si kontrata të ngjashme, staf teknik, licenca, fuqia punëtore, certifikata etj.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 1, nenin 46, pika 3 dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014

"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pasi ka kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike e njëkohësisht ka ulur konkurrencën në procedurat e prokurimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 64-66, faqe 81-84, faqe 88-92, faqe 94-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Libohovë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit dhe të njësisë së prokurimit, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, ku të aplikojnë kritere në përputhje me natyrën e procedurës së zhvilluar, si dhe ti trajnojë ata në vijimësi lidhur me fushën e veprimtarisë së tyre.

Menjëherë

19 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mbikëqyrje punimesh për objektin Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të qytetit Libohovë" me FL 3,429,847.5 lekë pa tvsh u konstatua se dokumentacioni i analizës mbi përllogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe procesverbali i mbajtur për këtë qëllim nuk janë në dosjen e NJP.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.C faqe 93-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandim: Bashkia Libohovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos dokumentimin e përllogaritjes së vlerës së kontratës nga NJP bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet referuar fondit limit të Urdhërit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka marrë masa për të zbatuar rekomandimet e KLSH-së për shpërblimin e dëmit në vlerën 4,615,166 lekë, si dhe nuk ka dërguar shkresë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara ndaj mbikëqyrësit të punimeve z. E. B. në objektin, "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.D faqe 101-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Libohovë të marrë masa për ndjekjen e gjitha procedurave ligjore, për zbatimin e masave shpërblim dëmi, me qëllim arkëtimin e vlerës 4,615,166 lekë në buxhetin e bashkisë si dhe t'i dërgojë shkresë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror që të vlerësojë shkeljet e konstatuara ndaj mbikëqyrësit të punimeve në objektin, "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)".

Menjëherë

C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 8 subjekte të legalizuara me vlerë 269,996 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A faqe 30-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Sektori i Shërbimit Urban të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Inspektimit të Territorit mbi subjektet debitore për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për

legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për 8 subjekte të legalizuara me vlerë 269,996 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Detyrimi që subjektet fizik/juridik kanë ndaj Bashkisë Libohovë më 31.12.2020, është 6,138,150 lekë për 64 subjekte dhe 17, 065,243 lekë për 797 familje, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë në total 23,203,393 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.A faqe 33-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Sektori i Inspektimit të Territorit të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrave që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare apo vendosjen e barrës hipotekore për subjektet debitore, si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej 23,203,393 lekë nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

Në vijimësi

D. MASAT DISIPLINORE

I . Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.
Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Libohove, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Xh.S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Territorit dhe **F.M.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Urban, *për shkeljet si vijon:* për mos zbatimin e kërkesave të Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.
Ligji nr. 95/2018 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.
Ligji nr. 98/2020 " për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c".
VKM nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5, me pasojë mos paguarjen e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë 8 subjekte të legalizuara me vlerë 269,996 lekë, që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Libohovë.
2. J.R. me detyrë përgjegjës i sektorit juridik dhe Person përgjegjës i prokurimeve publike , për shkeljet e konstatuara në zbatim të Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Shënim: Për punonjësit që kanë bërë shkelje, mangësi apo të meta më të ulta se risku, nuk rekomandojnë masë disiplinore:
1. Znj. E.Ç. me detyrë Përgjegjëse e zyrës së financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare.
2. Znj. J.M. dhe **znj. B.P.** me detyrë specialistë në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar përprocedurat e hartimit të buxhetit dhe inventarizimit.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL
Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Tropojë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT